



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



RAPORT VJETOR

Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe
Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2015

Tiranë, 2016

PËRMBAJTJA

I. Fjala Hyrese.....	9
Petrit Ahmeti.....	14
Hyrje	15
Struktura organizative e ERE-s	15
Bordi i ERE-s.....	15
Organograma e ERE-s.....	17
1. PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike	18
1.1 Tregu i Energjisë Elektrike	19
1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike	22
1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike.....	22
1.2.2 Realizimi i treguesve të prodhimit dhe menaxhimi i rezervës hidrike.....	36
1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë	37
1.2.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike.....	38
1.2.5 Eficienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike	42
1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike	44
1.3.1 Veprimtaria e OST	44
1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit.....	45
1.3.3 Bilanci i energjisë elektrike të transmetuar nga OST sh.a.....	49
1.4 Gjendja e përgjithshme e sistemit të energjisë elektrike referuar Nenit 25 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.....	49
1.5 Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar (të planifikuar apo në fazë ndërtimi.)	58
Skenarët e Modelit të Bashkuar të Rrjetit	59
1.5.3 Mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.	62
1.6 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike	67
1.7 Konsumi i Energjisë Elektrike	71
1.7.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike	74
1.7.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	75
1.8 Blerje Energjisë Elektrike në Treg të parregulluar.....	77
1.9 Efektiviteti i Shitjes të Energjisë Elektrike	78
1.10 Licencimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.....	84
1.10.1 Licencimet dhe Kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2015.....	84
1.10.2 Licencimet në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	85

1.10.3 Licencimet ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike	87
1.10.4 Licencimet ne aktivitetin e furnizimit te energjise elektrike.....	88
1.11 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	90
1.11.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.....	90
1.11.2 Monitorimi i OSHEE sh.a	92
1.11.3 Monitorimi i OST sh.a.....	95
1.11.4 Monitorimi i KESH sh.a.....	102
2. PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror.....	104
2.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)	105
2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG.....	106
2.2.1 Vendimi i Përjashtimit të TAP AG-s.....	107
2.2.2 Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it (PCD).	109
2.2.4 Zgjatja e Periudhës së Përjashtimit.....	111
2.3 Zhvillime te tjera rreth projektit TAP	111
2.3.1 Rreth vendimeve të marra për projektin.	111
2.3.2 Vendimet e mara gjate vitit 2015 për gazin natyror	112
2.3.3 Metodologjia e Tarifave te Gazit Natyror per TAP AG	113
2.3.4 Problemet kryesore qe dalin për zgjidhje ne sektorin e Gazit Natyror	114
3. PJESA III:Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë	116
3.1 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë	117
3.1.1 Lenia ne fuqi përperiudhën 1 Janar 2016-30 Qershor 2016 te tarifave ekzistuese dhe çmimet me pakice te energjise elektrike	117
3.1.2 Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri ne 15 MW.....	120
3.1.3 Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2015	126
3.2 Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar, ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2015 dhe proceset gjyqesore te ndjekura nga ERE.....	128
3.3 Proceset gjyqesore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2016	130
3.3.1 ERE ne cilesine e pales se trete.....	130
3.3.2 ERE pale e paditur	131
3.4 Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.....	133
3.4.1 Ankesat për “Energji te pamatur“	135
3.4.2 Ankesat për “keq faturim“ te energjise elektrike.	136
3.4.3 Ankesat përmbi faturimin e energjise elektrike	136
3.4.4 Ankesat për “faturim aforfe“	137

3.4.5 Ankesat për “ndryshim ne tarifimin e çmimit” te energjisë elektrike.	137
3.4.6 Ankesat për “ndërprerjen” e energjisë elektrike.	138
3.4.7 Ankesa për “kolaudimin e matësave” të energjisë elektrike.	139
3.4.8 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.	139
3.4.9 Ankesat mbi “kontratat fiktive” dhe “faturimin fiktiv”.	139
3.4.10 Ankesat për “lidhje te re te kontratës se energjisë elektrike”.	140
3.4.11 Ankesa mbi “mos kreditimin e pagesave” te faturave te energjisë elektrike.	140
3.4.12 Trajtimi i ankesave te ardhura nga ERE, Avokati i Popullit, Kryeministria, MEI dhe Zyrat Qendrore nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a.	141
3.4.13 Ankesat e paraqitura ne OSHEE gjate vitit 2015.	142
3.5 Treguesit e vazhdueshmërisë dhe cilësisë së shërbimit te furnizimit me energji elektrike	144
3.5.1 Marrëdhëniet me Publikun, Median e Shkruar dhe Vizive.	146
3.5.2 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.	147
3.5.3 Seancat Dëgjimore.	147
3.5.4 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.	148
3.6 Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s.	149
3.6.1 Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë.	149
3.6.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI).	150
3.6.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritimit.	151
3.6.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës.	151
3.7 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.	152
3.7.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.	153
3.7.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.	154
3.7.3 Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare.	155
Kapitulli VI.	156
Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s.	156
1.Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s.	157
Shtojca1 Regjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2015.	170
Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “fatlum” sh.p.k. Nga hec “Përrollaj”, me fuqi 0.5 MW.	170
Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Euron Energy ” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.	176
Për licencimin e shoqërisë “Electral” sh.p.k në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.	177

Mbi fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.	177
Mbi fillimin e procedurave për kualifikim impianti prodhues si burim i rinovueshëm energjie të shoqërisë ”Gama Energy” sh.p.k., për HEC-et “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2a” përkatësisht me fuqi 1.95 MW; 2.3 MW dhe 0.25 MW (fuqi totale 4.5 MW).....	177
Mbi miratimin dhe zbatimin e programeve të transparencës së ERE parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit.	177
Për licencimin e shoqërisë “Kisi-Bio-Energj” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ”Kacni”, me fuqi totale 3.87 MW.....	177
Për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.	177
Për licencimin e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	178

TABELA E FIGURAVE

Figura 1: Organograma e ERE - 2015	17
Figura 2: Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut (Burimi: ERE VKM nr.338 datë 19.03.2008)	20
Figura 3: Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)	21
Figura 4: Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)	22
Figura 5: Prodhimi neto i të gjitha centraleve prodhuese gjatë vitit 2015 (MWh)	23
Figura 6: Prodhimi Neto Vendas për vitin 2015.....	25
Figura 7: Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2015(MWh).....	26
Figura 8: Prodhimi vendas për vitin 2015 krahasuar me periudhën 2007-2014	27
Figura 9: Prodhimi Neto vendas për periudhën 2007-2015	27
Figura 10: Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë për periudhën 1985 – 2015 (Burimi: KESH,OST).....	28
Figura 11: Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST)	29
Figura 12: Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2015 (Burimi: KESH,OST) .	30
Figura 13: Derdhjet nga Hec-et gjatë vitit 2015.....	30
Figura 14: Niveli (m) i Liqenit të HEC të Fierzës gjatë vitit 2015	31
Figura 15: Niveli i liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2015	32
Figura 16: Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2015	33
Figura 17: Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2015 krahasuar me mesataren historike	34
Figura 18: Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2015 (Burimi: OST)	35
Figura 19: Treguesit e centraleve	36
Figura 20: Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et Private/Koncesion për vitin 2015 (Burimi: KESH sha)	38
Figura 21: Prodhimi nga HEC –et private që kanë filluar prodhimin gjatë 2015	41
Figura 22: Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private (Burimi: ERE).....	41
Figura 23: Detyrimet e KESH. Sh.a ndaj subjekteve Private për Energjinë Elektrike (Burimi: KESH sh.a)	42
Figura 24: Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2015) (Burimi: OST sh.a)	43
Figura 25: Struktura e sistemit të transmetimit të Shqipërisë	46
Figura 26: Sistemi i transmetimit shqiptar	47
Figura 27: Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2015 (GWh)	49
Figura 28: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2016	57
Figura 29: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2017	57
Figura 30: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2018	57
Figura 31: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2019	58
Figura 32: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2020	58

Figura 33: Parashikimi i kërkesës për energji elektrike, prodhimit vendas dhe importit për 5 vite	61
Figura 34: Ndarja Administrative e Rrjetit të Shpërndarjes dhe Pेशha Specifike në Konsumin e Energjisë Elektrike (Burimi: OSHEE).....	68
Figura 35: Të dhënat mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (Burimi: OSSHE)	69
Figura 36: Të dhënat mbi rezultatet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2015	70
Figura 37: Konsumi i përgjithshëm në vite	71
Figura 38: Treguesit e sintetizuar nga të tre operatorët kryesore të sistemit energjetik në Shqipëri	72
Figura 39: Raportet e Faturimit sipas Kategorive të konsumatorëve	74
Figura 40: Konsumatorët Familjarë sipas fashave të konsumit të energjisë elektrike	74
Figura 41: Importi i Energjisë nga KESH dhe OSHEE gjatë vitit 2015	77
Figura 42: Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST)	78
Figura 43: Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2007-2015	79
Figura 44: Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2010-2015	79
Figura 45: Faturim – Arkëtimet 2015.....	80
Figura 46: Ecuria e Gjendjes Debitorë	80
Figura 47: Efektiviteti i shitjeve gjatë vitit 2015 (Burim: OSHEE)	82
Figura 48: Efektiviteti i shitjeve të OSSH 2009-2014 (Burim: OSSH).....	82
Figura 49: Humbjet Totale kundrejt Energjisë së Futur në sistemin Elektroenergjetik	83
Figura 50: Faturimi/Arkëtimi 2002-2014 (Burimi: OSHEE)	83
Figura 51: Licencimet e Miratuara nga Bordi i ERE-s, sipas Aktiviteve të Ndryshme gjatë 2015	85
Figura 52: Subjektet e licënuar, ne aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.....	86
Figura 53: Në proces licëncimi për prodhimin e energjisë elektrike gjatë 2016.....	86
Figura 54: Te licënuarit ne aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike gjatë vitit 2015	88
Figura 55: Subjektet e licënuar ne aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike të licënuar për vitin 2015.....	89
Figura 56: Subjektet e licënuar ne aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2015	90
Figura 57: Monitorime Tematike gjatë vitit 2015	92
Figura 58: Plani i investimeve të OSHEE sh.a për vitin 2015.....	93
Figura 59: Shtesat dhe ndryshimet ne planin e investimeve 2015 te datës 05/10/2015	93
Figura 60: Ankandi Vjetor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor të vitit 2015	97
Figura 61: Ankandëve Vjetor + Mujor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015	97
Figura 62: Disbalancat brenda dhe jashtë zonës ±2%	100
Figura 63: Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2015.....	101
Figura 64: World Energy Statistical Review 2014	105
Figura 65: Aksionerët aktualë TAP.....	106
Figura 66: Projekti TAP	108
Tabela 67: Te ardhurat 2015 KESH sh.a. (Burimi KESH sh.a, ERE)	119

Tabela 68: Te ardhurat 2015 OST sh.a (Burimi OST sh.a, ERE)	119
Tabela 69: Te ardhurat 2015 OSHEE sh.a(Burimi OSHEE sh.a, ERE)	119
Grafiku 70: Të ardhurat nga HEC-et e Vegjël dhe HEC Ashta (Burimi: KESH sh.a.).....	122
Grafiku 71: Ecuria e çmimeve për HEC-et private	123
Grafiku 72: Struktura e miratuar e kostove të KESH sh.a. si F.P.Sh. për vitin 2015 (Burimi i te dhënave ERE) ..	124
Tabela 73: Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE)	124
Grafiku 74: Struktura e çmimit mesatar të shitjes me pakicë e miratuar nga ERE 2015	125
Grafiku 75: Struktura e realizuar e çmimit mesatar të shitjes me pakicë për 2015	125
Grafiku 76: Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2015	126
Grafiku 77: Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE).....	126
Grafiku 78: Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit (Burimi: ERRRA) ..	127
Grafiku 79: Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit (Burimi: ERRRA)	127
Figura 80: Tabela për ankesat e trajtuara nga ERE gjate vitit 2015	134
Figura 81: Grafiku për ankesat e trajtuara nga ERE gjate vitit 2015	135
Figura 82: Ankesat e paraqitura gjate 2015.....	141
Tabela 83: Ankesat e zgjidhura gjate vitit 2015.....	142
Figura 84: Kërkesë/ankesat e depozituara ne OSHEE lidhur me faturimin e energjisë elektrike përgjatë vitit 2015	143
Figura 85: Kërkesë/ankesat e zgjidhura nga OSHEE lidhur me faturimin e energjisë elektrike përgjatë vitit 2015	143
Figura 86: Kërkesë/ankesat e depozituara ne OSHEE lidhur me shërbimet teknike përgjatë vitit 2015.....	144
Figura 87: Kërkesë/ankesat e zgjidhura nga OSHEE lidhur me shërbimet teknike përgjatë vitit 2015	144
Figura 88: Treguesit e cilësisë se shërbimit te furnizimit me energjisë elektrike për vitin 2015.....	144
Figura 89: Treguesit e vazhdueshmërisë se furnizimit me energji elektrike ne tension te mesëm gjate vitit 2015.	145
Figura 90: Treguesit e vazhdueshmërisë se furnizimit me energji elektrike ne tension te larte gjate vitit 2015	146

I. Fjala Hyrese

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputet,

Në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” është përgatitur Raporti Vjetor i Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Ky raport përmban një informacion të detajuar në lidhje me gjendjen e përgjithshme të sistemit të energjisë elektrike gjatë vitit 2015, përfshirë informacionin në lidhje me sigurinë operative të rrjetit, perspektivës të sigurisë së furnizimit parashikimin e investimeve që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Korporata e Elektroenergjetike Shqiptare që përfaqëson sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.

Po ashtu në këtë Raport informohet Kuvendi edhe për veprimtarinë e ERE për vitin 2015. Informacioni në këtë Raport pasqyron ndryshimet e ndodhura në legjislacionin që rregullon sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror në vendin tonë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” është punuar në drejtim të hartimit brenda afateve të caktuara në ligjet respektive të kuadrit rregullator të kërkuar. Për këtë qëllim janë përpunuar një numër draftesh (aktet nënligjore) të cilat janë konsultuar në çdo rast me Komunitetin e Energjisë me qendër në Vjenë, konsultime këto të zhvilluara me qëllim që kuadri rregullator në sektorin e energjisë ashtu sikurse Ligjet respektive

te gazit natyror dhe energjisë elektrike të reflektojnë kërkesat dhe përmbajtjen e Paketë se tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë.

Gjate vitit 2015 sikurse edhe më parë Prodhimi publik i energjisë elektrike është kryer nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore. Në analizë të historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2015 ka shënuar një prodhim të energjisë elektrike nga burimet vendase mbi nivelin mesatar. Po ashtu vlerësohet edhe shkalla e sigurisë nga pikëpamja hidrologjike. Në prodhimin e energjisë elektrike ka ndikuar edhe vënia në punë e 107 centraleve hidrike private / Koncesion, licencuar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të cilët kanë një fuqi të përgjithshme të instaluar prej rreth 342.2 MW, nga të cilat rreth 32 MW përbëjnë HEC që kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2015.

Edhe gjate vitit 2015 një nga sfidat më të rëndësishme të sistemit lidhet me përmirësimin e treguesve tekniko ekonomik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes duke pasur këtu parasysh gjendjen e rënde në treguesit tekniko ekonomike të trashëguar nga OSHEE pas privatizimit.

Vlen për t'u theksuar se nga të dhënat e raportuara për vitin 2015 shënohet ulje e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes të cilat për vitin 2015 regjistrohen në masën 31.34% kundrejt 37.81 % të një viti më parë.

Gjithashtu arkëtimet si një tregues thelbësor i performancës së kompanisë ndër vite ka vijuar të jetë në nivele të larta. Gjatë vitit 2015 OSHEE vijoi të ketë përmirësime në drejtim të këtij

treguesi ku për vitin 2015 arkëtimet nga OSHEE shënojnë 98.3 % kundrejt 91.9 % gjate vitit 2014.

Duke konsideruar im paktin në tregun e energjisë elektrike të tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” ERE zhvilloi një proces të kujdesshëm në kuadër të rishikimit të tarifave dhe çmimeve për vitin 2016. Me vendimin nr.156, 24.12.2015, ERE vendosi lënien në fuqi të tarifave të miratuara për vitin 2015. Ky vendim i ERE erdhi në reflektim të nevojës për plotësimin e kuadrit rregullator me aktet nënligjore të parashikuara në ligjin Nr.43/2015, akte këto me mjaft rëndësi, të cilat përcaktojnë funksionet dhe përgjegjësitë e secilit prej pjesëmarrësve të tregut në mënyrë të veçantë në lidhje me përgjegjësitë që burojnë nga detyrimet e shërbimit publik parashikuar në dispozitat e ligjit të ri të sektorit të energjisë elektrike. Natyrisht ky vendim reflektonte më së miri edhe periudhën tranzitore të parashikuar në ligj për qëllime të përpunimit të kuadrit rregullator dhe përcaktimit sipas të cilit palët në tregun e energjisë elektrike deri në miratimin e akteve nënligjore vijojnë të ruajnë të drejtat dhe detyrimet ekzistuese.

Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në kuadër të vendimmarrjeve të ERE përbejnë një dokument me mjaft rëndësi në kuadrin rregullator. Në ligjin nr. 43/2015 ndër të tjera në seksion të veçantë përcaktohen parimet e funksionimit të sistemit të transmetimit i cili referuar këtij ligji është një person juridik i licencuar nga ERE për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit dhe që zotëron dhe administron sistemin e transmetimit.

Në ligj përcaktohet se pronësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit duhet të jetë e ndarë nga çdo subjekt që ushtron kontroll direkt apo të tërthortë ndaj veprimtarive të prodhimit apo furnizimit.

Sipas nenit 58, ERE miraton një procedurë të hollësishme për kërkesat për aplikim dhe certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për të provuar pavarësinë në përputhje me nenin 54, të ligjit.

Në zbatim të sa më sipër kërkuar nga ligji 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe në konsultë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë u miratua Rregullorja për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike.

Përsa i përket sektorit të Gazit Natyror, një nga problemet kryesore për zgjidhje gjatë vitit 2015-te kishte të bënte me Certifikimin e TAP-AG nga Enti Rregullator i Energjisë. Në kushtet kur, nuk kishim Ligjin e Ri të gazit ku duhej të transpozohet “Paketa e Tretë e Energjisë” si dhe duhej të krijohet dhe të miratohet nga ERE” Rregullorja për Certifikimin e TAP-it”, pas miratimit të ligjit të ri të Gazit Natyror.

Për vendet kandidate për në Bashkimin Europian, ashtu si edhe Shqipëria, ishte një detyrim aplikimi i “Paketës së Tretë të Energjisë” në Janar 2015. Faktikisht kjo paketë detyronte vendet ku do të kalojë Projekti TAP, të bënin certifikimin në përputhje me Direktivën e Gazit Nr.2009/73/EC.

Gjatë vitit 2015-të , ERE mori vendimin paraprak për Certifikimin e Gazsjellësit Trans Adriatik AG (TAP-AG), si Operator i Sistemit të Transmetimit për Gaz Natyror.

Ky vendim është miratuar në datën 31 Tetor 2015 mbështetur në nenet 13, 37 dhe 38 të Ligjit për Gazin Natyror si dhe nenit 11 të Rregullores së ERE për Çertifikimin e Operatoreve të Sistemit të Transmetimit.

Vendimi paraprak është përgatitur në bashkëpunim me Autoritetet Rregullatorë të Italisë dhe Greqisë të cilat kanë nxjerrë vendime të ngjashme për çertifikimin e TAP-AG. Theksojmë se këto vendime janë në përputhje të plote me Nenin 10-te, të Direktivës 2009/73/EC si dhe të Nenit 3, të Rregullores(CE)Nr.715/2009.

Aplikimi i Certifikimit u bazua në modelin e pavarur të operatorit të transmetimit ku TAP-i duhet të plotësojë të gjitha kushtet e vendosura në Kapitullin IV të Direktivës së Gazit përveç nenit 22 të kësaj Direktive.

Gjate vitit 2015-te, Shqipëria filloj punimet përndërtimin e gazsjellësit TAP-AG, me 03 .Korrik 2015.

Aktualisht po bëhen punime ndihmese në trasenë ku do të kalojë tubacioni, në rrugët e reja, në riparimin e disa rrugëve ekzistueseve ashtu edhe në ndërtimin e urave e punimeve të tjera të nevojshme përkëtë projekt.

Njëkohësisht bëjmë me dije se ka filluar ardhja e tubacioneve në Portin e Durrësit, për të filluar në Maj të këtij viti ndërtimin dhe implementimin e projektit.

Vlerësoj se detyrimet ligjore që lidhen me aktivitetin dhe vendim-marrjen e ERE-es për zhvillimet në sektorin e gazit dhe energjisë elektrike janë të njëpërgjegjësie serioze. Përkëtë është e nevojshme që kapacitetet profesionale që trajtojnë dimensionin rregullator në implementimin e tregut të gazit dhe energjisë elektrike në vendin

tone të jeta në një nivel të lartë profesional. Përkëtë dua të theksoj dhe këtë vit nevojën e domosdoshme të vlerësimit të statusit të ERE-es si një institucion i pavarur në sektorin e energjisë në tërësi.

Në zhvillimet bashkëkohore të sektorit të energjisë elektrike dhe tregut të gazit natyror pavarësia e ERE-es behet një imperativ pasi autoriteti profesional dhe motivimi janë dy elemente të pazgjidhshëm në suksesin e punës së këtij institucioni.

Përgjegjësia e këtij institucioni në zhvillimin e suksesshëm të tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike është e madhe pasi është i vetmi që monitoron dhe vendos për zhvillimin e drejtë, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të tregut.

Gjithashtu me të drejtë dhe institucionet ndërkombëtare kanë theksuar dhe vazhdojnë të kushtojnë një rëndësi të veçantë pavarësisht se ERE-s, forcimit të strukturës dhe autoritetit profesional të saj.

Kjo është një kërkesë e patjetërsueshme dhe obligative e përmbajtjes së paketës së trete rregullatore për vendet anëtare të komunitetit të energjisë të cilën e ka miratuar dhe shteti shqiptar.

Në përmbajtjen e këtij raporti do të gjeni në mënyrë të detajuar zhvillimet dhe situatën në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në vendin tonë për vitin 2015.

Kryetari

Petrit Ahmeti

Hyrje

Struktura organizative e ERE-s

ERE ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, përmes organit vendimmarrës të Bordit të ERE-s, i cili ndihmohet në punën e tij nga një staf teknik, staf mbështetës dhe specialistë të jashtëm. Struktura dhe organo grama e ERE-s është miratuar me Vendim të Kuvendit Nr. 181, datë 05.05.2008 dhe Ligjit Nr.9584, datë 17.7.2006 “Për Pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”

Bordi i ERE-s

Bordi i ERE-s, në bazë të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i ERE-s përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Gjatë vitit 2015 kanë ushtruar detyrën si anëtarë të Bordit të ERE-s:

Z. Petrit Ahmeti..... Kryetar

Zj. Entela Shehaj.....Anëtare

Z. Adriatik Bego..... Anëtar

Z. Maksim Shuli.....Anëtar

Z. Abaz Aliko.....Anëtar

Për qëllime të vendimmarrjeve, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi Bordi i zhvillon mbledhje formale, takime konsultative, si dhe seanca dëgjimore publike. Gjatë vitit 2015, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 29 mbledhje formale, në të cilat janë marrë 165 vendime. Në shtojcat e këtij raporti janë paraqitur vendimet e marra gjatë vitit 2015 me përjashtim të vendimeve që lidhen me funksionimin e brendshëm të ERE-s.

Për sa përcahet në legjislacionin në fuqi në këtë raport Bordi edhe për vitin 2015 është mbështetur në punën e tij nga Këshilltari, Sekretari i Bordit dhe një personel teknik të organizuar në 4 drejtori si vijon:

- *Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut*, me 7 punonjës.
- *Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*, me 5 punonjës
- *Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike*, me 5 punonjës.
- *Drejtoria e Administrim Financës dhe Burimeve Njerëzore*, me 8 punonjës.

Gjatë vitit 2015 është synuar forcimi i kapaciteteve administrative të ERE-s përmes kualifikimeve të ndryshme të mbështetura nga rregullatori dhe nga organizmat ndërkombëtare të tillë si:

- **ERRA**– EnergyRegulators Regional Association
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
- **NARUC**– NationalAssociation of Regulatory Utilities
- **MEDREG**– MediterraneanEnergy Regulators
- **E-Control**– EnergyControl Austria
- **AEEG** – Autoritàpër l’Energia Elettrica, il Gas ed i Servizi idrici in Italia

Organograma e ERE-s

Funksionimi i ERE dhe bashkërendimi i strukturave përbërëse të saj bëhet konform organogramës së mëposhtme.




Figura 1: Organograma e ERE - 2015

1. PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike

1.1 Tregu i Energjisë Elektrike

Për vitin 2015, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.338, datë 19.03.2008, i cili ka miratuar Modelin Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike (MSHTEE). Veç të tjerash, ky model, ka përcaktuar pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg.

Me daljen e ligjit Nr. 43/2015 “ Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë detyrohet të reflektoje kërkesat e ligjit të ri, duke hartuar aktet rregullatore nënligjore në zbatim të tij.

Në nenin 98 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se është pikërisht Operatori i Sistemit të Transmetimit përgjegjës për t’i propozuar ERE Rregullat e Tregut të Energjisë elektrike të cilat duhet të jenë në harmoni me Modelin e Tregut të miratuar nga Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 97/3 të këtij ligji.

Në figurat në vijim paraqiten Struktura e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Skema e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.




Figura 2: Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut (Burimi: ERE VKM nr.338 datë 19.03.2008)

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figura 3: Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)

1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike prej shoqërive prodhuese realizohet si një aktivitet i liçensuar nga ERE , në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese në Shqipëri me kapital tërësisht shtetëror , e cila per vitin 2015 ka shfrytëzuar hidrocentralet ekzistuese te kaskades se lumit Drin.

Shoqëritë e tjera (Private/me Koncesion) prodhuese, me kapacitetin më të madh prodhues, janë të lidhura në sistemin e transmetimit. Këto subjekte të liçencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese, apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare dhe, një pjesë e vogël, shfrytëzojnë centrale deri në 2 MW, të privatizuar në kuadër të Ligjit nr.8527, datë 23/09/1999. Një numër i konsiderueshëm i shoqërive prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore.

Pas shkëputjes nga administrimi publik i HEC-eve Ulëz, Shkopet, Bistrica 1,2 dhe Lanabregas, përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në tabelë. Fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,350 MW dhe e TEC-it 98 MW.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HECFierzë	HECKoman	HEC.V.Dejës	TECVlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1448			

Figura 4: Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privat/koncesionar të energjisë elektrike prej 447 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar (e liçensuar) në vendin tonë rezulton **1 895 MW**.

Prodhimi neto publik i energjisë elektrike në vitin 2015 u realizua 100% nga hidrocentralet (HEC-et).

Prodhimi neto prej **5,865,670 MWh** u realizua:

- ✓ **4,451,978 MWh** nga centralet prodhuese hidro të KESH sh.a (prodhimi publik)
- ✓ **1,413,709 MWh** nga hidrocentralet e tjerë.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2015 është rreth **1687 MW** dhe prodhimi neto i tyre është **5 378 588 MWh**. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes (35,20,10,6 kV) gjatë vitit 2015 është rreth **208 MW** dhe prodhimi neto i tyre është **487 082 MWh**.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna të gjithë centraleve, shoqërive, kapacitetit të instalimit në licensim dhe prodhimit neto për vitin 2015 të marra nga të dhënat e KESH sha dhe OST sha.

Figura 5: Prodhimi neto i të gjitha centraleve prodhuese gjatë vitit 2015 (MWh)

PRODHIMI NETO I ENERGJISE ELEKTRIKE NE SHQIPERI GJATE VITIT 2015 NGA TE GJITHA CENTRALET PRODHUESE (MWh)				
SUBJEKTI	HECET DHE KAPACITETI	Kapaciteti Licencim	LIDHJA	2015
"KESH" sha	Hec "Fierze" me fuqi 500 MW	500,0	110 kV	1 636 522
"KESH" sha	Hec "Koman" me fuqi 600 MW	600,0	110 kV	1 882 721
"KESH" sha	Hec "V. Dejës" me fuqi 250 MW	250,0	110 kV	932 732
"Termocentrali Vlore" sha	TEC "Vlora" me fuqi 98 MW	98,0	110 kV	0
"Ujësjetës Kanalizime Tirane" sha	Hec "Lanabregas" me fuqi 5 MW	5,0	35 kV	31 242
"Kurum International" sh.a.	Hec "Ulëz"etj. me fuqi 76.7 MW	76,0	110 kV	352 934
"EMIKEL 2003" sh.p.k	Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0,40	10kV	2 651
"EMIKEL 2003" sh.p.k	Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0,20	10kV	800
"Albania Green Energy" sh.p.k	Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9,20	35 kV	32 081
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Dibër)	0,60	10kV	1 363
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Dibër)	0,33	10kV	400
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Dibër)	0,63	6kV	1 035
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Dibër)	4,80	20kV	15 648
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukës)	1,20	10kV	4 257
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1,40	10kV	4 970
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkodër)	0,64	10kV	2 414
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korçë)	0,20	10kV	479
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korçë)	0,10	10kV	268
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0,63	10kV	1 308
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korçë)	0,25	10kV	611

"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korçë)	0,70	10kV	1 704
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1,92	10kV	4 601
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0,20	10kV	753
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Kërpicë" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0,42	6kV	870
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0,63	10kV	1 484
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarandë)	0,25	6kV	955
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarandë)	0,38	10/6kV	462
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korçë)	1,20	10kV	3 076
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Dibër)	0,25	6kV	863
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1,02	10kV	2 383
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Dibër)	0,75	10kV	692
"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	Hec "Gjanç" me fuqi 2,96 MW	2,96	35 kV	8 247
"Wonder power" sha	Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2,50	35 kV	7 680
"Amal" sh.p.k	Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0,57	10kV	2 026
"Hidroinvest 1" sh.p.k	Hec "Stranik" me fuqi 4,6 MW	4,42	35kV	12 704
"Hidroinvest 1" sh.p.k	Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3,33	35kV	9 673
"Malido-Energji" sh.p.k	Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1,95	6kV	2 838
"Energji Ashta" sh.p.k	Hec "Ashta" me fuqi 48,2 MW	50,00	110kV	235 604
"HIDROALBANIA Energji" sh.p.k	Hec "Cernaleve" me fuqi 2,95 MW	6,73	35kV	15 263
"Power Elektria Slabinje" sh.p.k	Hec "Slabinje" me fuqi 13,8 MW	13,8	110	33 050
"HEC Bishnica 1,2" sh.p.k	Hec "Bishnica 2" me fuqi 2,5 MW	2,40	110 kV	11 257
"C & S Construction Energy" sh.p.k	Hec "Rapuni 1" me fuqi 4 MW	4,00	110kV	31 189
"HydroEnergy" sh.p.k	Hec "Murdar 1" me fuqi 2,68 MW	2,88	10kV	11 654
"HydroEnergy" sh.p.k	Hec "Murdar 2" me fuqi 1 MW	1,44	10kV	6 780
"Wenerg" sh.p.k	Hec "Dardhe" me fuqi 5,8 MW	6,16	110 kV	12 173
"Dishnica Energy" sh.p.k	Hec "Dishnice" me fuqi 0,2 MW	0,20	10kV	608
"Elektro Lubonje" sh.p.k	hec "Lubonje" me fuqi 0,3 Mw	0,30	10kV	329
"Koka & Ergi Energy Peshk" sh.p.k	Hec "Peshke" me fuqi 3,43 MW	3,43	35kV	12 238
"Ansara Koncension" sh.p.k	Hec "Labinot-Mal" me fuqi 0,25 MW	0,08	6kV	260
"Energy Plus" sh.p.k	Hec "Pobreg" me fuqi 2 MW	2,00	35kV	36 373
"Hec Vlushë" sh.p.k	Hec "Vlushë" me fuqi 14,2 MW	14,20	35kV	17 478
"Energy partners AI" sh.p.k	Hec "Shkalle" me fuqi 1,3 MW;	12,60	110kV	15 352
"Korkis 2009" sh.p.k	Hec "Belesova 1" me fuqi 0,150 MW	0,15	6kV	43
"HP OSTROVICA" sh.p.k	Hec "Faqekuq 1" me fuqi 3 MW;	6,72	35kV	15 574
"Erald Energjitik" sh.p.k	Hec "Mgulle" me fuqi 0,28 MW	0,40	10kV	1 334
"Bekim Energjitik" sh.p.k	Hec "Kryezi 1" me fuqi 0,6 Mw	1,20	10kV	2 981
"Selishte" sh.p.k	Hec "Selishte" me fuqi 2 MW	2,00	35kV	5 727
"ERMA MP" sh.p.k	Hec "Carshove" me fuqi 1,5 Mw	1,60	10kV	3 650
"DITEKO" sh.p.k	Hec "Lubalesh 1" me fuqi 4,6 Mw	11,60	110kV	9 709
"Idro Energia Pulita" sh.p.k	Hec "Langaica 3" me fuqi 2,2 MW	2,20	110kV	1 481
"Idro Energia Pulita" sh.p.k	Hec "Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1,19	10kV	6 531
"Dosku Energy" sh.p.k	Hec "Gizavesh" me fuqi 0,5 MW	0,50	10kV	2 508
"Snow Energy" sh.p.k	Hec "Koka 1" me fuqi 2,1 MW	2,10	35kV	5 215
"Stravaj Energji" sh.p.k	Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3,96	35kV	7 641
"Peshku Picar 1" sh.p.k	Hec "Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0,27	6kV	519
"Albanian Power" sh.p.k	Hec "Martanesh" me fuqi 10,5 MW	6,00	35kV	21 929
"Hydro power Plant Of Korca" sh.p.k	Hec "Verba 1" me fuqi 2,1 MW	5,10	35kV	11 451
"Hidro Borshi" sh.p.k	Hec "Fterra" me fuqi 1,08 MW	3,08	35kV	10 603
"Lu & Co Eco Energy" sh.p.k	Hec "Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0,40	10kV	790
"Gjo.Spa.POWER" shpk	Hec "Llapaj" me fuqi 13,62 MW	13,60	110 kV	40 769
"Erdat Lura" sh.p.k	Hec "Lura 1" me fuqi 6,54 MW	16,12	110kV	39 961
"E.T.H.H." sh.p.k	Hec "Kozel" me fuqi 0,5 MW	0,55	10kV	960
"E.T.H.H." sh.p.k	Hec "Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0,80	10kV	1 110
"E.T.H.H." sh.p.k	Hec "Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0,50	10kV	382
"Caushi Energji" sh.p.k	Hec "Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0,40	10kV	1 842
"SA.GLE.Kompani" sh.p.k	Hec "Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1,98	10kV	1 264
"Energji Xhaci" sh.p.k	Hec "Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0,32	10kV	953
"Tucep" sh.p.k	Hec "Tucep" me fuqi 0,4 MW	0,40	10kV	982
"Hec-Treske" shpk	Hec "Treska4" me fuqi 3,6 MW	4,32	35kV	2 576
"Hidro Energy Sotire" shpk	Hec "Sotire1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2,29	35kV	5 937
"Shutina energji" shpk	Hec "Shutine" me fuqi 2,4 MW	1,78	10kV	841

"Zall Herr Energji 2011"shpk	Hec"Cekrez 1" me fuqi 0,23 MW;	0,68	6kV	4 283
"Hec Qarr & Kaltanj"shpk	Hec"Qarr" me fuqi 1 MW	1,76	35kV	5 024
"Gjoka Konstruksion Energji" sh.p.k	Hec"Shales" me fuqi 1,08 MW	2,08	35kV	1 570
"Gjoka Konstruksion Energji" sh.p.k	Hec"Strelce" me fuqi 1,174 MW	4,16	35kV	5 887
"Sarolli" sh.p.k	Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0,46	10kV	1 267
"Projeksion Energji" sh.a.	Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0,45	10kV	81
"EN-KU" sh.p.k	Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	0,16	10kV	51
"Maksi Elektrik" sh.p.k	Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	0,17	10kV	707
"Juana" sh.p.k	Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0,08	10kV	1 115
"WTS Energji" sh.p.k	Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0,15	10kV	745
"Marjakaj" sh.p.k	Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	0,26	6kV	1 176
"Favina 1" sh.p.k	Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2,12	35/10kV	10 891
"Selca Energji" sh.p.k	Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	0,40	10kV	2 242
"DN & NAT Energy"shpk	Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0,63	6kV	1 398
"Energo – Sas" sh.p.k	Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8,60	35kV	25 000
"Hec i Tervolit" sh.p.k	Hec "Tervol" me fuqi 12 MW	12,00	35kV	30 938
"MTC Energy" sh.p.k	Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2,93	10kV	7 636
"Gurshpat Energy" sh.p.k	Hec"Gurshpat 1"me fuqi 0,84 MW,	1,35	10kV	6 302
"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	Hec"Bistrica 3"me fuqi 1,57 MW,	1,50	6kV	531
"Komp Energji" sh.p.k	Hec"Hurdhas 1"me fuqi 1,71MW,	1,44	6kV	2 822
"UKKO"sha (Ujsjell.Kanal.Korce)	Central Fotovoltaik (pa sistemuar ne bilanc)	1,0		
"Fatlum" sh.p.k	Hec"Perrolla" me fuqi 0,5 MW	0,55	10kV	214
"Ayen As Energji"sha	Hec"Peshqesh"	27,9	110kV	28 711
"Euron Energy" sh.p.k	Hec"Bele 1"me fuqi 5 MW ;	30,70	110kV	114 423
"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	4,50	20kV	1 694
"Strelca Energy" sh.p.k	HEC Strelcë 1 1.504 MW	2,18	35kV	338
Mesopotam Energy sh.p.k	HEC Driza me fuqi 3.408 Mw	2,20	35kV	306
		1 895		5 865 670

"UKKO"sha (Ujsjell.Kanal.Korce)	Central Fotovoltaik (pa sistemuar ne bilanc)	1,0		1 396
---------------------------------	--	-----	--	-------

Ne figuren me poshte paraqitet prodhimi neto vendas per vitin 2015 duke evidentuar kontributin ne prodhim te KESH –GEN si prodhuesi i vetem publik si dhe kontributet e prodhuesve te tjere Privat/me Koncesion. Sic shihet prodhimi publik vazhdon te kete peshen kryesore ne prodhimin vendas.




Figura 6: Prodhimi Neto Vendas për vitin 2015

Figura me poshte detajon prodhimin neto vendas gjate vitit 2015 duke paraqitur edhe nivelin e kontributit te te gjithe prodhuesve.




Figura 7: Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2015(MWh)

Ne Figurat ne vijim krahesohet prodhimi gjate vitit 2015 me rezultatet e prodhimit te periudhes 2007-2014.




Figura 8: Prodhimi vendas për vitin 2015 krahasuar me periudhën 2007-2014




Figura 9: Prodhimi Neto vendas për periudhën 2007-2015

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2015 ka shënuar një prodhim të energjisë elektrike nga burimet vendase mbi nivelin mesatar. Po ashtu vlerësohet edhe shkalla e sigurisë nga pikëpamja hidrologjike. Prodhimi maksimal mujor për vitin 2015, është shënuar në muajin mars me 717 226 MWh. Ky prodhim i lartë është realizuar kryesisht nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. Prodhimi mujor minimal gjatë vitit 2015 është realizuar në muajin tetor me 237 419 MWh.

Në grafikun e Figurës së mëposhtme vihet re se prodhimi për vitin 2015 është **5,866 GWh** pra një prodhim mbi mesataren shumë vjeçare 1985-2015 me rreth 1,243 GWh .

HISTORIKU I PRODIMIT VENDAS 1985-2015 (GWh)




Figura 10: Prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë për periudhën 1985 – 2015 (Burimi: KESH,OST)

Prodhimi nga hidrocentralet e kaskades se lumit Drin ka peshen kryesore ne prodhimin vendas dhe me poshte paraqiten rezultatet historike te prodhimit nga tre hidrocentralet kryesore ne administrim te KESH sha.




Figura 11: Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST)

Diferencat ndërmjet prodhimeve maksimale e minimale rezultojnë rreth 2.7 herë, duke shprehur në mënyrë të dukshme shkallën e lartë të riskut hidrogjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet Elektroenergjetike të mbështetur vetëm në HEC-e.

Me poshte po detajojme prodhimin mujor te energjise elektrike nga hidrocentralet e kaskades se lumit Drin.




Figura 12: Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2015 (Burimi: KESH,OST)

Në punën e hidrocentraleve evidentohet gatishmëri e lartë e të gjithë agregateve të hidrocentraleve. Është me rëndësi të theksohet se në sajë të kësaj gatishmërie është bërë e mundur që të shfrytëzohet rezerva hidroenergjitike ne menyre eficiente dhe te shkarkohen vetëm sasi të vogla uji nga portat e hidrocentraleve, pa iu marrë më parë energjia. Këto shkarkime rezultojnë të kenë qenë të paevitueshme dhe janë kryer për ruajtjen e parametrave të sigurisë së digave.

Figura me poshte tregon shkarkimet nga hidrocentralet gjate vitit 2015.

DERDHJET E UJIT NGA H/C-ET E KASKADES SE DRINIT GJATE VITIT 2015 (million m³)													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2015
Fierzë	0	50	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	50
Koman	0	127	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	127
Vau Dejës	0	184	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	184

*Shenim : Me vendimin N3 dt 27.04.2015 te Komisionit te Posacem percaktohet niveli maksimal i lejuar i liqenit te Firzes nga 296 m miratohet ne **296.5 m***

Figura 13: Derdhjet nga Hec-et gjatë vitit 2015

Baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike, çka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në shfrytëzimin e Kaskadës mbi lumin Drin (HEC-eve të Komanit, të Vaut të Dejës dhe të Ashtës), të cilët furnizohen kryesisht me ujë nga prurjet e rregulluara të HEC-it të Fierzës.

Me poshte jepet niveli në metra i Liqenit të Fierzës për vitin 2015.




Figura 14: Niveli (m) i Liqenit të HEC të Fierzës gjatë vitit 2015

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2015 paraqiten me poshte duke evidentuar kuotat minimale e maksimale.

	NIVELI I FIERZES 1991-2015											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	289.4	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9

Figura 15: Niveli i liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2015

Me poshte paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2015, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore 1991– 2015.




Figura 16: Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2015

Në Figurën në vijim paraqiten prurjet për vitin 2015 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike).




Figura 17: Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2015 krahasuar me mesataren historike

Sic shihet edhe gjate vitit 2015 prurjet ne liqenin e Fierzes kane ndjekur aferisht te njejtin profil krahasuar me mesataren historike.

Në grafikun Figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2015.




Figura 18: Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2015 (Burimi: OST)

Kriteret e shfrytëzimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge edhe në vitet paraardhëse. Ato janë mbështetur në tre parimet themelore të Rregullores së Shfrytëzimit të Digave, të cilat konsistojnë në:

1. Respektimin e kushteve të sigurisë së digave.
2. Shfrytëzimin optimal të rezervës hidroenergjetike.
3. Minimizimin e efekteve të përmytjes

1.2.2 Realizimi i treguesve të prodhimit dhe menaxhimi i rezervës hidrike.

Gjendja e rezervës energjetike në fillim të vitit 2015 rezultoi rreth **976,000** MWh, respektivisht në nivelin **288.7** m në Fierzë. Ky nivel vlerësohet në kushte mbi mesataren historike.

Për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve tariforë KESH sha, përshtati prodhimin në regjim shfrytëzimi tekniko-ekonomik të optimizuar.

Bazuar në gjendjen hidrike dhe nivelin e kërkesës për energji, gjatë periudhës shkurt-maj prodhimi u mbajt në nivele të larta duke e rritur me rreth 150,000 MWh, krahasuar me Janarin e më pas (qershor-shtator) u reduktua me rreth 40,000 MWh. Tetori ishte muaji me prodhimin më të vogël (139,379 MWh). Periudha nëntor-dhjetor shënon rritje graduale deri në 274,953 MWh në dhjetor.

Është ndjekur regjimi i punës për të maksimizuar efikasitetin e potencialit energjetik në kushtet ku regjimet diktohen nga nevoja për plotësimin e kërkesës të konsumatorëve tariforë, kur profili ditor i kërkesës luhet në kufijtë 400 MW deri mbi 1500 MW në pik.

Gjatë vitit 2015, prurjet mesatare në Fierzë rezultuan rreth 170 m³/sek. Niveli në fund të vitit rezultoi 275.9 m dhe rezerva energjetike rreth 727 GWh me ulje rreth 150 GWh nga fillimi i vitit, gjendje që në fund të vitit nuk vlerësohet optimale. Niveli mesatar i shfrytëzimit në HEC Fierzë rezultoi 288.68 m, në HEC Koman 173.16 m dhe prodhimi bruto i energjisë nga KESH Gen 4 696 GWh.

Treguesit e punës së hidrocentraleve më të mëdhenj të Kaskadës së lumit Drin jepen në tabelën e mëposhtme.

TREGUESIT E PUNES (gjate vitit 2015)	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC Vau Dejës
Niveli mesatar i shfrytëzimit (m)	288.68	173.16	74.04
Rënia mesatare e shfrytëzimit (m)	115.27	98.95	50.87
Koeficienti mesatar i ngarkimit të aggregateve (%)	90	82	84
Prodhimi vjetor (MWh)	1,637,192	1,919,875	939,224
Fuqia mesatare e centralit (MW)	187	219.2	107.2
Faktori kapacitetit	0.37	0.48	0.43

Figura 19: Treguesit e centraleve

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë

Edhe gjatë vitit 2015 nuk është prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve ende nuk është mundësuar vënia në punë e TEC-Vlora.

KESH sh.a dhe kontraktori i ndërtimit të TEC-it janë në proces gjyqesor për zgjidhjen e kundërshtive lidhur me defektin në sistemin e ftohjes dhe mbylljen e njëanshme të kontratës nga TCM(nga kompania e kontraktuar) që në vitin 2012.

Pritet që një kompani e specializuar konsulence të përfundojë projektin e riparimit të defektit në sistemin e ftohjes në TEC Vlora. Mendohet nga KESH që të përgatitet një studim pre-fisibiliteti ku do të analizohet në mënyrë krahasuese kosto e përdorimit të gazit natyror në prodhimin e energjisë elektrike nga TEC Vlora.

1.2.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Prodhimi dhe kapacitetet e HEC-eve Private dhe me Koncesion janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në figurën 20.

Figura 20: Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et Private/Koncesion për vitin 2015 (Burimi: KESH sha)

PRODHIMI I H/C-eve PRIVATE/KONCESION GJATE VITIT 2015 (MWh)			
SUBJEKTI	HECET DHE KAPACITETI	Kapaciteti ne Licensim	2015
"Ujësjetllës Kanalizime Tirane" sha	Hec "Lanabregas" me fuqi 5 MW	5,0	31 242
"Kurum International" sh.a.	Hec "Ulëz", Shkopet, Bistrica 1, Bistrica 2 me fuqi 76.7 MW	76,0	352 934
"EMIKEL 2003" sh.p.k	Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0,40	2 651
"EMIKEL 2003" sh.p.k	Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0,20	800
"Albania Green Energy" sh.p.k	Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9,20	32 081
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Dibër)	0,60	1 363
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Dibër)	0,33	400
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Dibër)	0,63	1 035
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Dibër)	4,80	15 648
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukës)	1,20	4 257
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1,40	4 970
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkodër)	0,64	2 414
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korçë)	0,20	479
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korçë)	0,10	268
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0,63	1 308
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korçë)	0,25	611
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korçë)	0,70	1 704
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1,92	4 601
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0,20	753
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0,42	870
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0,63	1 484
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)	0,25	955
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)	0,38	462
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korçë)	1,20	3 076
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Dibër)	0,25	863
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1,02	2 383
"Balkan Green Energy" sh.p.k	Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Dibër)	0,75	692
"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	Hec "Gjanç" me fuqi 2.96 MW	2,96	8 247
"Wonder power" sha	Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2,50	7 680
"Amal" sh.p.k	Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0,57	2 026
"Hidroinvest 1" sh.p.k	Hec "Stranik" me fuqi 4.6 MW	4,42	12 704
"Hidroinvest 1" sh.p.k	Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3,33	9 673
"Malido-Energji" sh.p.k	Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1,95	2 838
"Energji Ashta" sh.p.k	Hec "Ashta" me fuqi 48,2 MW	50,00	235 618
"HIDROALBANIA Energji" sh.p.k	Hec "Cernaleve" me fuqi 2.95 MW	6,73	15 263
"Power Elektrik Slabinje" sh.p.k	Hec "Slabinje" me fuqi 13,8 MW	13,8	33 050
"HEC Bishnica 1,2" sh.p.k	Hec "Bishnica 2" me fuqi 2.5 MW	2,40	11 257
"C & S Construction Energy" sh.p.k	Hec "Rapuni 1" me fuqi 4 MW	4,00	31 189
"HydroEnergy" sh.p.k	Hec "Murdhar 1" me fuqi 2.68 MW	2,88	11 654
"HydroEnergy" sh.p.k	Hec "Murdhar 2" me fuqi 1 MW	1,44	6 780
"Wenerg" sh.p.k	Hec "Dardhe" me fuqi 5.8 MW	6,16	12 173
"Dishnica Energy" sh.p.k	Hec "Dishnice" me fuqi 0.2 MW	0,20	608
"Elektro Lubonje" sh.p.k	hec "Lubonje" me fuqi 0.3 Mw	0,30	329

"Koka & Ergi Energy Peshk" sh.p.k	Hec "Peshke" me fuqi 3.43 MW	3,43	12 238
"Ansara Koncension" sh.p.k	Hec "Labinot -Mal" me fuqi 0.25 MW	0,08	260
"Energy Plus" sh.p.k	Hec "Pobreg" me fuqi 2 MW	2,00	36 373
"Hec Vluse " sh.p.k	Hec "Vlushe" me fuqi 14.2 MW	14,20	17 478
"Energy partners Al" sh.p.k	Hec "Shkalle" me fuqi 1.3 MW;	12,60	15 352
"Korkis 2009" sh.p.k	Hec "Belesova 1" me fuqi 0.150 MW	0,15	43
"HP OSTROVICA" sh.p.k	Hec "Faqekuq 1" me fuqi 3 MW;	6,72	15 574
"Erald Energjitik" sh.p.k	Hec "Mgulle" me fuqi 0.28 MW	0,40	1 334
"Bekim Energjitik" sh.p.k	Hec "Kryezi 1" me fuqi 0.6 Mw	1,20	2 981
"Selishte" sh.p.k	Hec "Selishte" me fuqi 2 MW	2,00	5 727
"ERMA MP" sh.p.k	Hec "Carshove" me fuqi 1.5 Mw	1,60	3 650
"DITEKO" sh.p.k	Hec "Lubalesh 1" me fuqi 4,6 Mw	11,60	9 709
"Idro Energia Pulita" sh.p.k	Hec "Langarica 3" me fuqi 2,2 MW	2,20	1 481
"Idro Energia Pulita" sh.p.k	Hec "Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1,19	6 531
"Dosku Energy" sh.p.k	Hec "Gizavesh" me fuqi 0.5 MW	0,50	2 508
"Snow Energy" sh.p.k	Hec "Koka 1" me fuqi 2.1 MW	2,10	5 215
"Stravaj Energji" sh.p.k	Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3,96	7 641
"Peshku Picar 1" sh.p.k	Hec "Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0,27	519
"Albanian Power" sh.p.k	Hec "Martanesh" me fuqi 10,5 MW	6,00	21 929
"Hydro power Plant Of Korca" sh.p.k	Hec "Verba 1" me fuqi 2,1 MW	5,10	11 451
"Hidro Borshi" sh.p.k	Hec "Fterra" me fuqi 1,08 MW	3,08	10 603
"Lu & Co Eco Energy" sh.p.k	Hec "Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0,40	790
"Gjo.Spa.POWER" shpk	Hec "Llapaj" me fuqi 13,62 MW	13,60	40 769
"Erdat Lura" sh.p.k	Hec "Lura 1" me fuqi 6,54 MW	16,12	39 961
"E.T.H.H. "sh.p.k	Hec "Kozel" me fuqi 0,5 MW	0,55	960
"E.T.H.H. "sh.p.k	Hec "Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0,80	1 110
"E.T.H.H. "sh.p.k	Hec "Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0,50	382
"Caushi Energji" sh.p.k	Hec "Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0,40	1 842
"SA.GLE.Kompani "sh.p.k	Hec "Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1,98	1 264
"Energji Xhaci" sh.p.k	Hec "Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0,32	953
"Tucep" sh.p.k	Hec "Tucep" me fuqi 0,4 MW	0,40	982
"Hec-Treske" shpk	Hec "Treska4" me fuqi 3,6 MW	4,32	2 576
"Hidro Energy Sotire" shpk	Hec "Sotire1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2,29	5 937
"Shutina energji" shpk	Hec "Shutine" me fuqi 2,4 MW	1,78	841
"Zall Herr Energji 2011" shpk	Hec "Cekrez 1" me fuqi 0,23 MW;	0,68	4 283
"Hec Qarr & Kaltanj" shpk	Hec "Qarr" me fuqi 1 MW	1,76	5 024
"Gjoka Konstruksion Energji" sh.p.k	Hec "Shales" me fuqi 1,08 MW	2,08	1 570
"Gjoka Konstruksion Energji" sh.p.k	Hec "Strelce" me fuqi 1,174 MW	4,16	5 887
"Sarolli" sh.p.k	Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0,46	1 267
"Projeksion Energji" sh.a.	Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0,45	81
"EN-KU" sh.p.k	Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	0,16	51
"Maksi Elektrik" sh.p.k	Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	0,17	707
"Juana" sh.p.k	Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0,08	1 115
"WTS Energji" sh.p.k	Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0,15	745
"Marjakaj" sh.p.k	Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	0,26	1 176
"Favina 1" sh.p.k	Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2,12	10 891
"Selca Energji" sh.p.k	Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	0,40	2 242
"DN & NAT Energy" shpk	Hec "Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0,63	1 398
"Energjo - Sas" sh.p.k	Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8,60	25 000
"Hec i Tervolit" sh.p.k	Hec "Tervol" me fuqi 12 MW	12,00	30 938
"MTC Energy" sh.p.k	Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2,93	7 636
"Gurshpat Energy" sh.p.k	Hec "Gurshpat 1" me fuqi 0,84 MW,	1,35	6 302
"Bistrica 3 Energy" sh.p.k	Hec "Bistrica 3" me fuqi 1,57 MW,	1,50	531
"Komp Energji" sh.p.k	Hec "Hurdhas 1" me fuqi 1,71MW,	1,44	2 822
"UKKO"sha (Ujssjell.Kanal.Korce)	Central Fotovoltaik (pa sistemuar ne bilanc)	1,0	0
"Fatlum" sh.p.k	Hec "Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0,55	214

"Ayen As Energji"sha	Hec"Peshqesh"	27,9	28 711
"Euron Energy" sh.p.k	Hec"Bele 1"me fuqi 5 MW ;	30,70	114 423
"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	4,50	1 694
"Strelca Energy" sh.p.k	HEC Strelcë 1 1.504 MW	2,18	338
Mesopotam Energy sh.p.k	HEC Driza me fuqi 3.408 Mw	2,20	306
		447	1 413 709

Shoqerite qe operojne 101 HEC-et qe kanë pasur kontrate shitje me KESH/FPSH kanë një fuqi të përgjithshme të instaluar prej rreth 342.2 MW, nga të cilat rreth 32 MW përbëjnë HEC qe kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2015.

Prodhimi i përgjithshëm neto për vitin 2015 nga gjeneruesit privatë/koncesion ishte 1 413 709 MWh ose **24.1 %** e prodhimit të përgjithshëm neto vendas të vitit 2015.

- Katër HEC- et e Kurum sha: Ulëz, Shkopet, Bistrica1 dhe Bistrica 2 qe nuk kanë pasur kontratë me KESH, kanë një fuqi të instaluar prej 76 MW dhe kanë prodhuar rreth 353 GWh.
- Një central HEC Peshqesh nuk ka pasur kontratë me KESH (FPSH) ka një fuqi te instaluar 29.7 MW dhe ka prodhuar 28 711 MWh.
- Një central Fotovoltaik i UKKO sha me kapacitet rreth 1 MW nuk ka pasur kontratë me KESH (FPSH) ka prodhuar për nevojat e saj rreth 1 396 MWh dhe ka pasur një kontratë bilaterale me OSHEE sha. Prodhimi i këtij centrali nuk është përfshirë në bilancin energjitik të OSHEE sha pasi nuk janë kryer rakordimet e nevojshme sipas kontratës ndërmjet tyre. Të dhënat e këtij centrali i kemi paraqitur veçmas dhe pritet qe sistemimi në sistem i këtyre llojeve të centraleve të kryhet me procedurastandarde të miratuara.

PRODHIMI I H/C-eve QE KANE HYRE NE PRODHIM GJATE 2015 (MWh)																
SUBJEKTI	HECET DHE KAPACITETI	Kapaciteti ne Licensim	LIDHJA	2015												2015
				JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	
"Komp Energji" shpk	Hec"Hurdhas 1" me fuqi 1,71MW,	1,44	6kV	380	477	479	349	211	53	0	0	0	324	305	243	2 822
"Stravaj Energji" shpk	Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3,96	35kV			977	1 953	1 052	361	78	73	214	867	1 091	974	7 641
"Shutina energji"shpk	Hec"Shutine" me fuqi 2,4 MW	1,78	10kV			25	206	0	0	0	0	0	235	211	164	841
"Fatlum" shpk	Hec"Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0,55	10kV			136	0	79	0	0	0	0	0	0	0	214
"E.T.H.H. "shpk	Hec"Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0,80	10kV				369	206	102	0	35	0	85	175	138	1 110
"E.T.H.H. "shpk	Hec"Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0,50	10kV				111	56	23	0	6	0	28	84	74	382
"Ayen As Energji"sha	Hec"Peshqesh"	27,9	110kv				46	5 428	2 533	1 181	743	1 338	5 834	6 907	4 702	28 711
"Kisi-Bio-Energji" shpk	Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	4,50	20kV					561	254	102	30	0	396	236	115	1 694
"Hec-Treske"shpk	Hec"Treska4" me fuqi 3,6 MW	4,32	35kV						215	272	0	198	606	615	670	2 576
"DITEKO" shpk	Hec"Lubalesh 1" me fuqi 4,6 Mw	11,60	110kV							709	599	692	2 672	2 496	2 540	9 709
"Idro Energia Pulita" shpk	Hec"Langarica 3" me fuqi 2,2 MW	2,20	110KV											26	1 456	1 481
"Projeksion Energji" sh.a.	Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0,45	10kV												81	81
"Bistrica 3 Energy" shpk	Hec"Bistrica 3" me fuqi 1,57 MW,	1,50	6kV												531	531
"Strelca Energy" sh.p.k	HEC Strelcë 1 1.504 MW	2,18	35kV												338	338
Mesopotam Energy shpk	HEC Driza me fuqi 3.408 Mw	2,20	35kV												306	306
		65,87 MW														58 438

Figura 21: Prodhimi nga HEC –et private që kanë filluar prodhimin gjatë 2015

Në tabelën 22, është paraqitur prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike i HEC-eve që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2015.




Figura 22: Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private (Burimi: ERE)

Në grafikun e Figurës 22 është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjël privatë ose të dhënë me konçension (deri 15 MW), si dhe nga HEC Ashta gjatë periudhës 2006 – 2015. Duke marrë parasysh që prodhimi maksimal i vitit 2010 përveç rritjes së kapaciteteve të instaluar në një masë të madhe u ndikua nga kushtet shumë të favorshme hidrike, nga grafiku vëhet re ritmi i lartë i rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me konçension, veçanërisht gjatë periudhës 2008-2014. Një rritje e konsiderueshme u vërejt gjatë vitit 2013 ku prodhimi nga këto HEC-e ishte 2.5 herë më i madh në krahasim me vitin e mëparshëm. Kontribut të rëndësishëm në këtë rritje të prodhimit ka HEC Ashta, i cili gjatë vitit 2013 prodhoi 211 GWh ose 28% të totalit të prodhimit nga këto HEC-e.

Në grafikun e figurës 23 janë paraqitur detyrimet e KESH/FPSH ndaj subjekteve private për energjinë elektrike të shitur tek KESH/FPSH, e cila që në vitin 2012 arriti mbi 2.5 Miliard lekë, për vitin 2013 në 6.6 Miliard lekë, në vitin 2014 ka arritur rreth 8.1 Miliard lekë dhe në vitin 2015 ishte 8.026 Miliard lekë.




Figura 23: Detyrimet e KESH. Sh.a ndaj subjekteve Private për Energjinë Elektrike (Burimi: KESH sh.a)

1.2.5 Efienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Sikurse evidentuar edhe në vitet e tjera, efienca e prodhimit të energjisë elektrike të sistemit tonë Elektroenergjetik vlerësohet nga analiza e treguesve kryesorë në vijim:

- Aftësia e akumulimit të energjisë elektrike në formë rezerve potenciale hidroenergjetike;
- Aftësia për rregullimin e prurjeve në mënyre vjetore;
- Optimizimi i kombinimit të prodhimit me importin e energjisë elektrike;
- Fleksibiliteti i lartë ndaj ngarkesës, ç'ka i lejon të mbulojë lehtësisht pikun e ngarkesës;
- Varësia e theksuar e prodhimit të energjisë elektrike nga kushtet hidrologjike të motit;
- Shkarkimet e ujit nga rezervuarët;
- Investime për ndërtimin e tyre dhe koha për përfundimin dhe futjen e objektit në shfrytëzim në krahasim me TEC-et;
- Shpenzime për shfrytëzim dhe mirëmbajtje

Shkarkimet e ujit pa kaluar në turbina nga basenet e Kaskadës së Drinit për disa vite paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Gjatë vitit 2015 vërehen shkarkime të vogla të ujërave të realizuara për sigurinë e digave në kushtet e rritjes së nivelit të liqeneve.

Në figurën 24, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskadës së lumit Drin, për secilin vit të periudhës 2002-2015.




Figura 24: Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2015) (Burimi: OST sh.a)

1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike

1.3.1 Veprimtaria e OST

Veprimtaria e transmetimit të energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST është krijuar në vitin 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht që kryente funksionet e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

“Sistemi i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, qëpërfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, papërfshirë furnizimin.

OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispecerimit dhe Operatorit të Tregut.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- (i) furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- (ii) transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- (iii) si dhe për tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër ai zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje. OST dispeceron sistemin Elektroenergjetik nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

Një rol i rëndësishëm është dhe ai i Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin dhe konsolidimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në rajon. Gjatë vitit 2015 Operatori i Tregut ka zhvilluar rregullisht ankandin vjetor, mujor dhe ditor të kapaciteteve të interkonjeksionit. Në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike ka kryer procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjellta për pjesëmarrësit e tregut.

1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të energjisëelektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkoneksionit ndërkombëtar.

Gjatësitë e linjavetësisistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë:

- Linjat e transmetimit 400 kV 293.6 km
- Linjat e transmetimit 220 kV 1150.30 km
- Linjat e transmetimit 150 kV 34.4 km
- Linjat e transmetimit 110 kV 1582.5 km

Nëpërbërjet e linjavetësisistemit të transmetimit përfshihen dhe linjat e interkoneksionit me vendet fqinje:

- Linja e interkoneksionit 220 kV Fierze (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkoneksionit 220 kV Koplak (Shqipëri) – Podgorice (Mali i Zi)
- Linja e interkoneksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardha (Greqi)
- Linja e interkoneksionit 400 kV Tirane (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Gjithashtu një linjë me tension 150 kV funksionon midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Kapaciteti i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë.




Figura 25: Struktura e sistemit të transmetimit të Shqipërisë




Figura 26: Sistemi i transmetimit shqiptar

Fuqia transformuese e nënstacioneve te sistemit të transmetimit sipas nivelit të tensionit		
Emërtimi	Njësia	Fuqia
Transformatorë 400/220 kV	MVA	1,200
Transformatorë 400/110 kV	MVA	300
Transformatorë 220/110/20 kV	MVA	240
Transformatorë 220/110/TM kV	MVA	2,120
Transformatorë 220/20 kV	MVA	126
Transformatorë 150/110 kV	MVA	40

Gjatësia e LinjavedheKabllovetetransmetimit (OST)		
Voltazhi (kV)	Gjatësia (km)	
	Linja Ajrore	Kabull
400	293.6	
220	1150.3	
154	34.4	
110	1576.15	6.3
Total	3054.4	6.3

Kapaciteti i Transformatorëve (MVA) (OST)					
Emri i Nënstationit	Numri Transform.	Fuqia	Voltazhi		
		TL(MVA)	TL(kV)	TM(kV)	TU(kV)
FIERZA	1	30.0	242.0	121.0	10.5
FIERZA	2	30.0	242.0	121.0	10.5
VAU DEJA	1	120.0	230.0	121.0	10.5
VAU DEJA	2	120.0	230.0	121.0	10.5
KOPLIKU	1	90.0	220.0	115.0	38.5
BURRELI	1	60.0	230.0	115.0	11.0
BURRELI	2	60.0	230.0	121.0	11.0
TIRANA1	1	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	2	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	3	120.0	220.0	115.0	37.6
TIRANA1	4	63.0	220.0		21.6
TIRANA1	5	63.0	220.0		21.6
TIRANA2	1	300.0	400.0	230.0	20.0
TIRANA2	2	300.0	400.0	230.0	20.0
TIRANA2	3	120.0	220.0	115.0	20.8
TIRANA2	4	120.0	220.0	115.0	20.8
RRASHBULL	1	100.0	220.0	115.0	20.0
RRASHBULL	2	100.0	220.0	115.0	20.0
SHARRE	1	100.0	225.0	130.0	15.0
SHARRE	2	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	1	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	2	90.0	220.0	115.0	38.5
ELBASAN1	3	120.0	220.0	115.0	37.6
ELBASAN2	1	300.0	410.0	220.0	30.0
ELBASAN2	2	300.0	410.0	220.0	30.0
FIERI	1	120.0	220.0	115.0	37.6
FIERI	2	120.0	220.0	115.0	37.6
FIERI	3	120.0	220.0	115.0	37.6
BABICA	1	100.0	220.0	115.0	37.0
BABICA	2	100.0	220.0	115.0	37.0
ZEMBLAK	1	150.0	400.0	115.0	20.0
ZEMBLAK	2	150.0	400.0	115.0	20.0
BISTRICA	1	40.0	170.0	115.0	6.0
TOTAL		4026.0			

1.3.3 Bilanci i energjisë elektrike të transmetuar nga OST sh.a.

Në tabelën e mëposhtme jepet bilanci energjetik i OST sh.a i parashikuar për vitin 2015 dhe ai faktik për vitin 2015 (GWh).

Figura 27: Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2015 (GWh)

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	FAKT	PARASHIKIM	Fakt
		2014	2015	2015
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7.699	7,751	7,830
1	- Prodhimi vendas	4.343	4,320	5,475
2	- Energji në marrje	3.355	3,431	2,355
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7.538	7,664	7,672
1	- Energji në dhënie	2.88		956
2	- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	6,552	6,851	6,106
3	- Energji e transmetuar për klientët në HV "kualifikuar"	697	965	610
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+NV	160	180	159
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+NV (%)	2.09%	2.30%	2.03

1.4 Gjendja e përgjithshme e sistemit të energjisë elektrike referuar Nenit 25 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Siguria operative e rrjetit.

Një nga detyrat kryesore të OST-se është sigurimi i aftësisë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase Sistemin e Transmetimit, duke kontribuar njëkohësisht në sigurinë e furnizimit nëpërmjet sigurisë së Sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit.

Duhet theksuar se me vënien në punë të linjës 400 kV Elbasan2 – Tërana2 – Podgorica2, dhe n/st 400/220/110 kV Tërana2, siguria e operimit të rrjetit transmetues është rritur së tepërmi. Pas këtij investimi të rëndësishëm dhe sidomos me vënien në punë të sistemit të kontroll monitorimit SCADA/EMS, OST siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Transmetimit, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve

të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe shkëmbim të sigurt dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

Sigurine Operative te Rrjetit, OST e garanton nëpërmjet zbatimit të kodit të operimit, pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, i cili përcakton kërkesa të qarta dhe objektive për sigurinë e punës së sistemit në kohë reale, dhe arritjen e qëllimit kryesor për të mbajtur në operim të vazhdueshëm Sistemin Transmetues Shqiptar të ndërlidhur me Sistemin Evropian të Transmetimit (zona sinkrone e Evropës Kontinentale) në mënyrë që të kontribuojë për një kuadër të harmonizuar për zbatimin e Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe për të siguruar mos-diskriminim, konkurrencën efektive dhe funksionimin efikas të tregut. Rregullat për Sigurinë e Operimit paraqesin principet e sigurisë operative në aspektin e nevojave teknike, duke konsideruar operimin e tregut në pajtueshmëri dhe në mbështetje me sigurinë e furnizimit. Këto parime të sigurisë operative janë thelbësore për OST-në për të menaxhuar përgjegjësitë e saj për funksionimin e Sistemit në interkoneksion, me një nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe stabilitetit. Një objektivi kyç i OST-së është arritja e një kuadri teknik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë zbatimin e të gjitha proceseve të nevojshme të kërkuara për sigurinë e operimit, duke marrë parasysh sfidat aktuale dhe të pritura, përfshirë rritjen e shpejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe ndikimin e tyre në operimin e Sistemit.

1. Gjendjet e Sistemit

Monitorimi i vazhdueshëm i situatës së Sistemit, bazuar në sistemin SCADA, me vlerat e matura në kohë reale të parametrave operacionale, me informacione permanente online të gjendjes së ndërsjellët të Sistemit midis TSO-ve fqinje, bën të mundur vlerësimin efektiv të situatës së Sistemit, dhe gjithashtu mundëson përgatitjen e veprimeve përmirësuese, në mënyrë që të mbahet Sistemi në një gjendje normale apo të kthehet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur në raste të avarive. Monitorimi i gjendjes së Sistemit kontribuon për një sjellje koherente dhe të koordinuar të Sistemeve të ndërlidhura të Transmetimit, si në zonën e përgjegjësisë të OST-se ashtu edhe ndërmjet zonave të përgjegjësisë.

Qendra e kontrollit të Sistemit në OST është e pajisur me një sistem kompleks kompjuterik që siguron grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga objektet (nënstacionet dhe centralet). Disponueshmëria e tyre mbështetet në redundancën e komponentëve të hardware-it dhe software-it, si dhe bazat e tyre të të dhënave. Pra, qendra e kontrollit në QDS është e pajisur me një sistem kontrolli kompjuterik (SCADA/EMS) që kryen këto funksione kryesore:

- Grumbullimin, përpunimin, shfaqjen (në ekran) dhe arkivimin e të dhënave të marra në distancë;
- Analizën sistematike të sigurisë operative në kohë reale dhe në mënyrë të studimit (study mode);
- Kontrollin fuqi-frekuencë;
- Kontrollin e tensionit.

Gjithashtu janë të përfshira sisteme të tjera kompjuterike, të tilla si:

- Mjetet e specializuara (softe) për analiza të Sigurisë Operative;
- Bordi imitator (mimic-board) për të siguruar shfaqjen e nyjeve të rrjetit sipas lidhjes së tyre, nivelin e tensionit dhe mbingarkesës, rrjedhën e fluksit në linja dhe transformatorë.

Këto mjete e lejojnë Operatorin e Sistemit të monitorojë situatën e Sistemit dhe gjendjen e elementëve të sistemit të transmetimit, të shfaqë statusin e një nënstacioni apo të një zonë (topologjinë, flukset dhe tensionet), dhe për të kontrolluar në distancë pajisjet.

2. Rrjeti i sigurisë së telekomunikacionit

Rrjeti i telekomunikacionit është një rrjet i sigurtë i telekomunikacion-transmetimit që është i dedikuar për përdorim ekskluziv të funksionimit të rrjetit të energjisë. Infrastruktura e tij bazohet në fibrën optike të instaluar pothuajse në të gjitha linjat e sistemit të transmetimit. Rrjeti i telekomunikacionit i mundëson personelit operativ veprimin në nivele të ndryshme të kontrollit, përfshirë komunikimin me TSO-të fqinje, për të shkëmbyer komandat dhe informacionet. Ai siguron bartjen e sinjaleve të destinuara për funksionimin e sistemeve të mbrojtjes në rrjetat dhe objektet elektrike ose për kryerjen e veprimeve në distancë nga pajisjet automatike të kontrollit lokal. Funksionimi normal i rrjetit të telekomunikacionit është jetike për funksionimin e Sistemit dhe sigurinë operationale dhe nënkupton redundancën e kanaleve të transmetimit në rrjetin e telekomunikacionit, dhe dublimin e pajisjevelidhëse (ruterave).

3. Sistemi i Telekontrollit

Pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë së rrjetit përbëjnë të ashtuquajturin sistem telekontrolli. Ky sistem shërben për:

- Garantimin e vrojtimit të Sistemit të Transmisionit, duke i siguruar Operatorit regjistrimin e të dhënave, në çdo kohë, për flukset e energjisë, topologjinë e

rrjetit dhe vlerën e madhësive elektrike (frekuenca dhe tensioni) karakteristikë e operimit të Sistemit. Ky observim përfshin gjithashtu të dhënat nga OST-të fqinje, informacion që shërben për të menaxhuar kompleksitetin e shkëmbimeve në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar njëkohësisht besueshmërinë e operimit të Sistemit të Interkonjeksionit;

- Garantimin e kontrollit të Sistemit të Transmetimit, duke i ofruar Operatorit dhe pajisjeve automatike të kontrollit mundësinë e operimit nëpërmjet telekontrollit të çelësave, dhe nëpërmjet kontrollit automatik të centralizuar të frekuencës;
- Furnizimin me informacion të besueshëm për funksionet komplekse të analizës së sigurisë operative, të cilat i mundësojnë Operatorit:
 - të parashikojë pasojat e ngjarjeve të tilla si stakim të objekteve gjeneruese apo të elementeve të sistemit të transmetimit,
 - përgatitjen e veprimeve përmirësuese.

Sistemi i telekontrollit është me rëndësi jetike për besueshmërinë dhe sigurinë e Sistemit, dhe për këtë arsye merren të gjitha masat për të siguruar vazhdimësinë e të gjitha karakteristikave relevante të tij:

- Rrjeti i telekomunikacionit është i dedikuar për operimin e sigurtë të Sistemit, dhe për këtë arsye OST ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë dhe e pajisur me pajisje të kontrollit;
- Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme;
- Së fundi, furnizimi i pandërprerë me energji elektrike i pajisjeve të telekontrollit dhe pajisjeve të telekomunikacionit në QDS sigurohet nga burime mikse dhe të pavarura të jashtme dhe burime të brendshme.

4. Menaxhimi i kontrollit të frekuencës

Qëllimi i menaxhimit të kontrollit të frekuencës është mbajtja e një ekuilibri të vazhdueshëm ndërmjet prodhimit dhe konsumit, duke siguruar cilësi të frekuencës dhe stabilitet të Zonës Sinkrone. Për këtë qëllim, OST siguron (aktualisht nëpërmjet një kontrate bilaterale me KESH) rezerva adekuate (në rritje dhe ulje) të fuqisë aktive. Në Kodin e Transmetimit janë vendosur kriteret për dimensionimin dhe krijimin e këtyre rezervave.

5. Kontrolli i Tensionit dhe Menaxhimi i Fuqisë Reaktive.

Kushtet e tensionit në Sistemin e Transmetimit janë të lidhura direkt me situatën e energjisë reaktive në nyjet e sistemit. OST siguron gjithashtu një ekuilibër të vazhdueshëm dhe lokalisht të mjaftueshëm të fuqisë reaktive, që të jetë në gjendje për të ruajtur nivelet e duhura të tensionit. Në këtë kontekst, qëllimi i kontrollit të tensionit dhe të menaxhimit të energjisë reaktive është për të siguruar që:

- Nivelet e tensionit, flukset e energjisë reaktive dhe burimet e energjisë reaktive monitorohen, kontrollohen dhe mbahen në kohë reale brenda kufijve të Sigurisë Operative, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve të Sistemit të Transmetimit dhe sigurimin e stabilitetit të tensionit,
- Rezerva e pershtatshme e menjëhershme e fuqisë reaktive është në dispozicion në gjeneratorët në punë, në reaktorët dhe kapacitoret, në mënyrë që të sigurojë funksionimin teknik të të gjithë sistemit energjetik, dhe të jetë në gjendje për të rivendosur gjendje normale pas avarive.

Për këtë qëllim, në Kodin e Rrjetit përsigurinë operative të ENTSO-E është vendosur të bëhet monitorim permanent online dhe shkëmbimi i informacionit që realizohet nga TSO-të në zonat përkatëse të observimit.

6. Menaxhimi i rrymës së lidhjes së shkurtër

Menaxhimi i rrymës së qarkut të shkurtër është i nevojshëm për të parandaluar nga dëmtimi të gjitha llojet e objekteve të gjenerimit, elementet e Sistemit të Transmetimit dhe pajisjeve të lidhura me të, dhe për të ruajtur sigurinë e personave; nëpërmjet shkyçjes së shpejtë dhe selektive të pjesës në qark të shkurtër. Pra objektivi i menaxhimit të rrymës së qarkut të shkurtër është mbajta e ndikimit të rrymave të lidhjes së shkurtër në një nivel që siguron funksionimin e sigurtë të sistemit të transmetimit, me anë të sistemit përkatës të mbrojtjes.

Kjo nënkupton:

- Llogaritjen e saktë të rrymave të lidhjes së shkurtër nga ana e specialisteve të planifikimit të OST-se duke ndjekur parimet e standardizuara dhe sigurimin e të dhënave nga TSO-të fqinje, OSSH dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit;
- Monitorimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe marrjen e masave përmirësuese, parandaluese dhe kuruese në qoftë se kufijtë e sigurisë operative janë, ose kanë tendencë për t'u shkelur;
- Sigurimin e informacionit dhe të komunikimit me TSO-të fqinje, OSSH dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, të afektuar, në mënyrë që të jenë në

gjendje të marrin në konsideratë efektin e sistemeve të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes.

7. Menaxhimi i fluksit të energjisë

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetërimit të parakohshëm të pajisjes. Pra, menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operationale për të mbajtur rrjedhën e energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të qenë në gjendje për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operationale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjendjen e Sistemit dhe gjithashtu të vlerësimit të gjendjes së Sistemit. Për këtë, OST kontrollon parametrat operationale brenda zonës së vet të përgjegjesisë dhe, në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit që përfshin pjesë të TSO-ve fqinje. Kjo nënkupton të dhëna strukturore dhe në kohë reale të shkëmbimit të informacionit ndërmjet TSO-ve në zonat e ndërthurura të observimit, dhe ndërmjet OST dhe OSSH në zonën e përgjegjesisë të OST-së. Për të qenë në gjendje për të përballuar avaritë në Sistem, nga ana e OST-së përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara, dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e situatave alerte ose në emergjencë.

8. Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

Me qëllim mbajtjen e sigurisë së operimit të Sistemit, bëhet analiza e kontigjencës (e ndodhjes së ngjarjeve të pa-parashikuara) që do të thotë kryerja e simulimit të stakimit të elementeve të Sistemit. Kjo analizë kryhet për zonën e observimit të OST-së, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës.

Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, të cilat gjithashtu përshkruajnë qëllimet e përgjithshme dhe objektivat e analizës së kontigjencës në kohë reale dhe në fazën e planifikimit operativ janë:

- Sigurimi i parandalimit dhe/ose kurimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në Sistemin e Transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në Sistem dhe në Interkoneksion.
- Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal, dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST-se, OSSh-së dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.
- Suportimi i përpunimit të dispozitave të standardeve pan-Evropiane për analizat e kontigjencave për të ruajtur sigurinë e operimit duke maksimizuar përdorimin e Sistemit.

9. Mbrojtja

Pajisja e mbrojtjes është përdorur për të mbrojtur asetet e Sistemit të Transmetimit nga dëmtimet. Skemat e sistemit të mbrojtjes janë përdorur për të zbuluar kushtet anormale të sistemit dhe ndërmarrin veprime korrigjuese të paracaktuara, për të ruajtur integritetin e sistemit, me një performancë të pranueshme të sistemit, në mënyrë të koordinuar. Funkcionet për mbrojtjen e Sistemit analizohen duke u mbështetur në llogaritjet e rrjetit, duke konsideruar funksionimin korrekt dhe jo korrekt. Nëse parashikohen pasoja të papranueshme, funksionaliteti dhe redundanca e Skemës së Mbrojtjes së Sistemit përshtaten në përputhje me rrethanat për të përmbushur kërkesat e sigurisë operationale. Funksionaliteti dhe statusi i gjendjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

10. Menaxhimi i Stabilitetit Dinamik.

Qëllimi i Vlerësimit të Stabilitetit Dinamik (VSD) është për të siguruar ndërgjegjësimin e operatorit të OST-se në lidhje me gjendjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së Sistemit në lidhje me stabilitetin, në situatën (N) dhe në atë të mundshme (N-1). Përveç kësaj, VSD mbështet vendimet ndaj veprimeve më efektive dhe efikase përmirësuese, për parandalimin e incidenteve ose korrigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

Përdorimi i gjerë i VSD lejon aplikime të ndryshme, jo vetëm në kohë reale, por edhe në fazat e planifikimit operacional. Një theks është vënë në trajnimin e stafit operativ të OST duke bërë përdorimin e VSD, si dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të modeleve dhe të simulatorit përkatës.

11. Trajnimi Operativ dhe Certifikimi

Në përputhje me Udhëzimet e Praktikës së Mirë për Sigurinë Operacionale, trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që të garantojë se Operatorët e Sistemit dhe personeli tjetër operativ janë të aftë, të mirë trajnuar, dhe se punonjësit që operojnë Sistemin në kohë reale janë të certifikuar për të vepruar në mënyrë të sigurtë gjatë të gjitha situatave operacionale.

Në këtë kontekst, OST ka filluar zbatimin e një trajnimi dhe procesi të gjerë certifikimi, i cili do të mundësojë njohjen dhe reagimin ndaj kushteve operative jonormale në afatet kohore përkatëse dhe, kur është e përshtatshme, në mënyrë të koordinuar me TSO-të e tjera. Për më tepër, zbatimi i standardeve operative mund të sigurohet nga zhvillimi i programeve që përfshijnë trajnimin fillestar, zhvillimin e vazhdueshëm të personelit dhe ri-vlerësimin e rregullt të certifikimit.

Kodi i Operimit vendos detyrimin për OST-në që të ketë të aktivizuar programet e vazhdueshme zhvillimore për stafin e saj në dhomën e kontrollit dhe të bashkërendojë e bashkëpunojë në trajnimet ndër-sistimore për çështje të transmetimit rajonal. Stafi i trajnuar OST-së do të jetë në gjendje të veprojë në mënyrë efikase në balancimin e Sistemit dhe në maksimizimin e mundësisë për transfertat ndërkufitare të cilat të dyja ofrojnë përfitime reale ekonomike për konsumatorët, mjaft më sinjifikative se sa rritja e kostos së investuar më shumë në trajnimin e stafit të OST-së në dhomën e kontrollit. Për më tepër, duke investuar në trajnimin e stafit operativ të OST-së, do të zvogëlohet probabiliteti i avarive të mëdha me përhapje të gjerë të shoqëruara me ndërprerjen e furnizimit, të cilat nëse ndodhin mund të zgjasin për shumë orë apo edhe ditë, dhe për të cilat ka një kosto shumë të madhe ekonomiko sociale.

- Balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare,
- Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektiva e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare nga data e raportit.

Mbi bazën e deklarimeve të pjesëmarrësve të tregut, bazën e të dhënave historike të OST-së, dhe duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST, të jetë e rendit 1.5-2%, dhe mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrevë kryesore energjetike dhe sigurimi i balancës së Sistemit për pesë vjeçarin, siç jepet në tabelat e mëposhtme:

Figura 28: Parashikimi i parametrevë kryesore energjetike 2016

Viti 2016		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	613	527	503	410	413	414	484	500	458	498	502	593	5915
Konsumi per KK	GWh	47	53	67	63	73	68	73	63	73	83	78	69	810
Humbje + N.V.	GWh	17	16	17	15	15	13	14	15	12	13	15	18	180
Kerkesa totale	GWh	677	596	587	488	501	495	571	578	543	594	595	680	6,905
Prodhimi	GWh	474	407	421	329	336	299	367	375	347	391	399	475	4620
KESH	GWh	369	307	302	208	220	205	311	318	286	323	326	385	3560
PPE	GWh	105	100	119	121	116	94	56	57	61	68	73	90	1060
Importi	GWh	203	189	166	159	165	196	204	203	196	203	196	205	2285
OSHEE (+KESH)	GWh	163	144	106	99	105	136	144	148	136	133	126	145	1585
FK → KK	GWh	40	45	60	60	60	60	60	55	60	70	70	60	700

Figura 29: Parashikimi i parametrevë kryesore energjetike 2017

Viti 2017		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	553	467	443	350	353	354	425	440	398	438	442	534	5197
Konsumi per KK	GWh	116	122	137	132	142	137	141	132	142	153	148	140	1642
Humbje + N.V.	GWh	16	15	15	14	13	13	14	15	12	13	14	17	171
Kerkesa totale	GWh	685	604	595	496	508	504	580	587	552	604	604	691	7,010
Prodhimi	GWh	484	417	431	339	346	309	377	385	357	401	409	485	4740
KESH	GWh	369	307	302	208	220	205	311	318	286	323	326	385	3560
PPE	GWh	115	110	129	131	126	104	66	67	71	78	83	100	1180
Importi	GWh	201	187	164	157	162	195	203	202	195	203	195	206	2270
OSHEE (+KESH)	GWh	163	144	106	99	105	136	144	148	136	133	126	145	1585
FK → KK	GWh	38	43	58	58	57	59	59	54	59	70	69	61	685

Figura 30: Parashikimi i parametrevë kryesore energjetike 2018

Viti 2018		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	478	392	368	275	278	279	350	365	323	363	367	459	4302
Konsumi per KK	GWh	198	204	219	214	224	219	223	214	224	235	230	222	2623
Humbje + N.V.	GWh	15	14	15	14	13	13	14	15	12	13	14	17	169
Kerkesa totale	GWh	691	610	602	503	515	511	587	594	559	611	611	698	7,094
Prodhimi	GWh	490	423	443	348	355	316	384	390	361	408	416	492	4826
KESH	GWh	369	307	302	208	220	205	311	318	286	323	326	385	3560
PPE	GWh	121	116	141	140	135	111	73	72	75	85	90	107	1266
Importi	GWh	201	187	160	155	160	195	203	204	198	203	195	207	2268
OSHEE (+KESH)	GWh	163	144	106	99	105	136	144	148	136	133	126	145	1585
FK → KK	GWh	38	43	54	56	55	59	59	56	62	70	69	62	683

Figura 31: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2019

Viti 2019		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	449	363	339	246	249	250	321	336	294	334	338	430	3951
Konsumi per KK	GWh	239	245	260	255	265	260	264	255	265	276	271	263	3119
Humbje + N.V.	GWh	15	14	15	14	13	13	14	15	12	13	14	16	168
Kerkesa totale	GWh	703	622	614	515	527	523	599	606	571	623	623	709	7,238
Prodhimi	GWh	502	435	454	361	367	328	396	402	373	420	431	502	4973
KESH	GWh	369	307	302	208	220	205	311	318	286	323	326	385	3560
PPE	GWh	133	128	153	152	147	123	85	84	87	97	105	117	1413
Importi	GWh	201	187	160	155	160	195	203	204	198	203	192	207	2265
OSHEE (+KESH)	GWh	163	144	106	99	105	136	144	148	136	133	126	145	1585
FK → KK	GWh	38	43	54	56	55	59	59	56	62	70	66	62	680

Figura 32: Parashikimi i parametrave kryesorë energjetikë 2020

Viti 2020		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Konsumi per OSHEE	GWh	435	349	325	232	235	236	307	322	280	320	324	416	3781
Konsumi per KK	GWh	263	269	284	279	289	284	288	279	289	300	295	287	3401
Humbje + N.V.	GWh	15	14	15	13	13	13	14	15	12	13	13	16	166
Kerkesa totale	GWh	713	632	624	524	537	533	609	616	581	633	632	719	7,348
Prodhimi	GWh	512	445	474	379	376	338	406	412	383	430	439	512	5103
KESH	GWh	369	307	302	208	220	205	311	318	286	323	326	385	3560
PPE	GWh	143	137	172	171	157	133	95	94	97	107	114	127	1543
Importi	GWh	201	187	150	145	160	195	203	204	198	203	192	207	2245
OSHEE (+KESH)	GWh	163	144	106	99	105	136	144	148	136	133	126	145	1585
FK → KK	GWh	38	43	44	46	55	59	59	56	62	70	66	62	660

1.5 Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar (të planifikuar apo në fazë ndërtimi.)

Për këtë çështje OST ka informacion vetëm për ato centrale të cilat janë parashikuar të lidhen në rrjetin e transmetimit (janë në fazë ndërtimi apo kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit), si më poshtë:

1. Kaskada e Lumit Devoll, 171 MW
2. HEC Kalivaç, 100 MW
3. HEC Fang, 72 MW
4. HEC Gostime, 21.5 MW
5. HEC Qarrishtë, 37 MW
6. HEC Terrnove, 9.35 MW
7. HEC Rapun 3-4, 9 MW

Skenarët e Modelit të Bashkuar të Rrjetit

Te gjitha OST-te e Rajonit te Evropes Jug-Lindore emetojnë një skenar baze për çdo periudhe kohore të përcaktimit të kapacitetit, i cili krijohet në Modelin e Bashkuar të Rrjetit.

Në rast të nevojës së përcaktimit të skenarëve shtese për periudha kohore, OST-et fqinje duhet të bien dakord rreth periudhave karakteristike shtese, duke konsideruar programin e mirëmbajtjes (remonteve) dhe angazhimin e gjeneratorëve, të cilët mund të ndikojnë në përcaktimin e vlerës së NTC-se.

Kufizimet e Sigurisë Operacionale

Gjate procesit të përcaktimit të kapaciteteve, OST do të respektoje se paku Kufizimet e Sigurisë Operative të mëposhtme, gjate kontigjencave të ndryshme të përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operacionale:

- (a) Limitet termike të elementeve kritike të rrjetit;
- (b) Limitet e Tensioneve, duke vendosur diapazone të tensioneve të lejueshme të nënstacioneve;
- (c) Limitet e Gjenerimit, duke siguruar disponueshmërinë e rezervës së gjenerimit në mënyrë që të arrihen kërkesat e përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operative.

Elementet kritike të rrjetit, që janë si ato të Rrjetit Rajonal ashtu edhe ato të Rrjetit të Brendshëm, përcaktohen nga modeli i bashkuar rajonal, dhe definohen si elemente me koeficient të ndjeshmërisë mbi 10%, pra dalja nga puna e një elementi kritik shkakton në të paktën një element tjetër të rrjetit të brendshëm ose të jashtëm, një ndryshim ngarkese prej 10% ose më shumë. Lista e elementeve kritike azhurnohet vazhdimisht me ndryshimin e kushteve të punës së çdo Sistemi, dhe i behet disponibel grupit të punës të menaxhimit të konxhestioneve të RG SEE.

Përcaktimi i Marzhit të Sigurisë (TRM)

Përcaktimi i madhësisë së Marzhit të Sigurisë bazohet në përjasje statistikore, duke marrë parasysh evidencat historike dhe parashikimet në të ardhmen. Marzhi i Sigurisë përfshin pa-siguritë e mëposhtme:

- (a) Devijimet e paqëllimshme të flukseve fizike gjatë operimit, për shkak të funksionimit fizik të rregullimit fuqi-frekuence,
- (b) Shkëmbimet emergjente midis OST-ve për tu përballur në kohe reale me situata të disbalancave të papritura,
- (c) Pasaktësitë, p.sh në mbledhjen e të dhënave dhe matjeve,
- (d) Pasaktësitë në rastin bazë të përdorur për llogaritje, si parashikimet e gjenerimit, konsumit, shkëmbimeve dhe topologjisë së rrjetit, etj.

Aktualisht, në Marrëveshjet Bilaterale, është pranuar që madhësia e marzhit TRM të jete 100 MW në kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë respektivisht, 50 MW në kufirin me Kosovën.

Harmonizimi i Rezultateve të Përcaktimit të Kapacitetit NTC

Vlera vjetore e NTC përçdo kufi dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vlerën minimale mujore që është përdorur, shfrytëzuar, në tre vitet e fundit, dhe rakordohet me OST-te fqinje respektive brenda muajit Nëntor të çdo viti.

Vlerat mujore të NTC, llogariten dhe harmonizohen me OST-te fqinje përçdo kufi veçmas, brenda datës 7 të çdo muaji, për muajin e ardhshëm. Përkëtë ndiqet procedura e mëposhtme:

- a) 10 dite para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjat e nivelit 220/400 kV, ndërmjet OST-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementet jashtë pune) përperiudhën e konsideruar,
- b) 5 dite para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC, që kryhen me anë të analizatorit të rrjetit (softit TNA) me të cilin janë të pajisur të gjitha OST-te e rajonit,
- c) 2 dite para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC përçdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëratjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Ne rast te ndryshimeve sinjifikative te situatës se Sistemit ne krahasim me situatën e parashikuar, kur janë llogaritur kapacitetet ndërkufitare, OST-te fqinje, pas shkëmbimit te tedhënave relevante te situatës se re, bëjnë ri-kalkulimin e kapacitetit ndërkufitar, dhe përcaktojnë bashkërisht vlerat e reja te NTC e respektivisht ato te ATC.

Alokimi i kapacitetit ndërkufitar përpjesëmarrësit e tregut ne rajonin tone behet nga Zyra e Ankandit te Koordinuar SEE CAO ne Podgorice.

Përdorimi i këtyre kapaciteteve transmetuese është pjese e tregut te energjisë, e nëse pjesëtarët e tregut janë te motivuar për t'i përdorur te dy drejtimet e fluksit ndërkufitar, atëherë kjo do te lehtësonte qarkullimin e fluksit ndërkufitar duke kontribuar ne rritjen e nivelit te sigurisë operationale te punës se Sistemit Elektroenergjetik.

Si rregull, shuma e kapacitetit te shkëmbimit për te gjitha kufijtë, shumëzohet me koeficientin 0.75, për te përcaktuar importin/eksportin total te një zone kontrolli, dhe qe merret ne konsiderate ne procesin e skedulimit te gjenerimit përditën ne avance.

Lidhur me modelet e pritshme te prodhimit, furnizimit, shkëmbimevendërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës.

Siç edhe është dhënë edhe me sipër, bazuar ne te dhënat e OST dhe realizimin real për vitin 2014 dhe 2015, është kryer parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pese vitet e ardhshme. Te gjitha këto jepen te grupuara ne tabelën e mëposhtme:

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Kërkesa për energji elektrike (GWh)	6905	7010	7094	7238	7348
Prodhimi Vendas (GWh)	4620	4740	4826	4973	5103
Importi (GWh)	2285	2270	2268	2265	2245

Figura 33: Parashikimi i kërkesës për energji elektrike, prodhimit vendas dhe importit për 5 vite

- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.
- Përcaktimi i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet

Në tabelën në vijim paraqiten të gjitha monitorimet tematike të kryera gjatë vitit 2015 nga ERE.

Monitorime Tematike ne subjekte gjatë vitit 2015			
Urdhër i Monitorimit	Objekti i Monitorimit	Periodha e monitorimit	Kompania e monitoruar
Nr. 5, datë 29.01.15	Analizimi i rezultateve të vitit 2014 dhe muajit Janar 2015, procesi i planifikimit, vendosjes së objektivave, si dhe gjendja e sistemit të faturimit	06.02.2015-17.02.2015	OSHEE sh.a
Nr. 6, datë 29.01.15	Analizimi i rezultateve të vitit 2014 dhe muajit Janar 2015, transaksionet e energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit të energjisë elektrike për vitin 2014 dhe Janar 2015, situata hidroenergetike dhe menaxhimi I rezervave hidrike	06.02.2015-17.02.2015	KESH sh.a
Nr. 7, datë 29.01.15	Analizimi i rezultateve të vitit 2014 dhe të muajit Janar 2015, zbatimin e detyrimeve për lidhjet e reja në sistemin e transmetimit për vitin 2014 dhe muajin Janar 2015, disbalancat e energjisë elektrike dhe ankesat e kapaciteteve, funksionimin e sistemit SCADA	06.02.2015-17.02.2015	OST sh.a
Nr. 22, date 03.04.2015	Trajtimin dhe statusin e ankesave përperiudhën Janar - Mars 2015; Ankesat e trajtuara lidhur me keq faturimet e muajit Janar 2015; ankesat e dërguara nga ERE për tu trajtuar në periudhën Nëntor - Dhjetor 2014; procedura e ndjekur nga Qendra e Kujdesit ndaj Klientit, për trajtimin e ankesave të konsumatorëve	07.04.2015-13.04.2015	OSHEE sh.a
Nr. 27, date 18.05.2015	Kundërshtimin e faturimit të energjisë elektrike të bere nga shoqëria OSHEE sh.a	19.05.2015, ora 10.00	Komuna Propshtit
Nr. 28, date 18.05.2015	Problemet e përsëritura me linjën dhe nënstacionin 35 kV të Maliqit	20.05.2015, ora 12.30	Hydro Power Plant of Korca
Nr. 32, date 12.06.2015	Mbylljen e kontratave të furnizimit me energji elektrike për disa objekte që nuk ekzistojnë	16.06.2015	OSHEE sh.a (komuna Cakran, Fier)
Nr. 34, date 17.06.2015	Analizimi i treguesve tekniko-ekonomik përperiudhën Janar - Maj 2015, procedurat e prokurimit të energjisë elektrike përperiudhën Janar - Maj 2015, procedurat e operimit të sistemit të faturimit, ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për vitin 2015, analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow përperiudhën Janar - Maj 2015	18.06.2015- 03.07.2015	OSHEE sh.a
Nr. 35, date 17.06.2015	Analizimi i rezultateve tekniko-ekonomike përperiudhën Janar - Maj 2015, transaksionet e energjisë elektrike dhe procedurat e prokurimit përperiudhën Janar - Maj 2015, situata hidroenergetike dhe menaxhimi I rezervave hidrike, shërbimet ndihmese për muajin Janar - Maj 2015, ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për vitin 2015, analizën e shpenzimeve dhe Cash Flow përperiudhën Janar - Maj 2015	18.06.2015- 03.07.2015	KESH sh.a

Nr. 36, date 17.06.2015	Analizimi i rezultateve tekniko-ekonomike përperiudhën Janar - Maj 2015, zbatim i detyrimeve për Lidhjet e Reja në sistemin e transmetimit përperiudhën Janar - Maj 2015, disbalancat e energjisëelektrike, ankandët e kapaciteteve të energjisë elektrike, shërbimet ndihmese përperiudhën Janar - Maj 2015, ecurinë e zbatimit të planit të investimeve për vitin 2015, analiza e shpenzimeve dhe Cash Flow përperiudhën Janar - Maj 2015	18.06.2015- 03.07.2015	OST sh.a
Nr. 57, date 23.10.2015	Realizimi i plani të Investimeve për 9-mujorin e vitit 2015	28.10.2015 - 04.11.2015	OST sh.a
Nr.58, date 23.10.2015	Realizimi i plani të Investimeve për 9-mujorin e vitit 2015	28.10.2015 - 04.11.2015	KESH sh.a
Nr. 59, date 23.10.2015	Realizimi i plani të Investimeve për 9-mujorin e vitit 2015	28.10.2015 - 04.11.2015	OSHEE sh.a

Figura 57: Monitorime Tematike gjatë vitit 2015

1.11.2 Monitorimi i OSHEE sh.a

Gjatë vitit 2015 monitorimet tematike janë realizuar në zbatim të urdhrave të Kryetarit të ERE-s, ndërsa monitorimet periodike janë kryer në zbatim të planit të miratuar vjetor.

Nga monitorimi i kryer lidhur me realizimin e procedurës së importit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes u konstatua se nuk ka pasur shkelje të rregullave në fuqi. Procedurat e prokurimit për energjinë elektrike janë kryer në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat Standarde të Prokurimit të Energjisë Elektrike nga OSHEE”, miratuar me Vendimin Nr. 42, datë 25.05.2009 nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s.

Në lidhje me analizimin e shpenzimeve dhe Cash Flow u konstatua se gjendja ekonomiko financiare e shoqërisë OSHEE sh.a është përmirësuar. Ky përmirësim vjen kryesisht si rezultat i aksionit për arkëtimin e faturave korente dhe detyrimeve të prapambetura.

Trendi i pagesave të kryera ndaj palëve të treta (kryesisht KESH sh.a dhe OST sh.a) ka ardhur rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014 si pasojë e rritjes së arkëtimeve nga ana e shoqërisë.

Në lidhje me transparencën të OSHEE për vitin 2015 vërehet se në faqen e internetit të OSHEE sh.a nuk janë publikuar kerkesat e meposhtme si më poshtë:

- Rezultatet e përpunuara të treguesve të cilësisë së vazhdueshmërisë së Furnizimit me energji elektrike për çdo zonë shpërndarje të klasifikuar brenda 31 marsit të vitit pasardhës, sipas nenit 17, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

- Informacionet dhe të dhënat për shërbimet e kryera në vitin paraardhës, subjekte të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, sipas nenit 36, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

ERE ka kërkuar nga shoqëria OSHEE sh.a zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për rritjen e transparencës në Tregun e Energjisë Elektrike.

Me ane të Vendimit Nr. 138, date 26.12.2014, Enti Rregullator i Energjisë miratoi Planin e Investimeve të OSHEE sh.a për vitin 2015 në vlerën 5,567,468,923 Leke në total.

Në tabelën në vijim jepet njëpërmbledhje e Planit të Investimeve të OSHEE sh.a për vitin 2015 miratuar nga ERE:

Nr.	EMERTIMI I INVESTIMIT	VLERA E PARASHIKUAR (LEKE)
I	Nënstacione	610 601 764
II	Investime Prioritare (rrjet 20 kV, rrjet TU)	3 604 020 159
III	Investime në Matje	742 000 000
IV	Investime në Sistemin e Billingut	610 847 000
TOTALI		5 567 468 923

Figura 58: Plani i investimeve të OSHEE sh.a për vitin 2015

Në datat e mëposhtme Këshilli Mbikëqyrës i kompanisë OSHEE sh.a për shkak të prioriteteve në investime dhe emergjencave ka rishikuar 4 herë Planin e Investimeve të miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 138, date 26.12.2014.

- Plani i miratuar në këshillin mbikëqyrës datë 06.02.2015
- Plani i miratuar në këshillin mbikëqyrës datë 06.05.2015
- Plani i miratuar në këshillin mbikëqyrës datë 15.07.2015
- Plani i miratuar në këshillin mbikëqyrës datë 05.10.2015

Figura 59: Shtesat dhe ndryshimet në planin e investimeve 2015 të datës 05/10/2015

Nga monitorimi i realizimit të investimeve për periudhën Janar-Shtator 2015 rezultoi:

- Projekte të hequra nga Plani Investimeve apo të shtyra në kohë 29 investime 1,883,237,463 leke
- Projekte të njëjta që kanë qene në planin fillestar të investimeve 2015 janë 81 por kanë ndryshim në vlerë nga ajo e parashikuar. Vlera e parashikuar përkëto projekte ka qene 3,056,217,227 leke dhe vlera përfundimtare është me vlerë totale 2,800,703,820 leke.

- Projekte te shtuara janë 280 me vlere totale 8,538,760,242 leke e ndare kjo ne dy vite sipas pritshmërisë se realizimit te tyre. Mjaft prej këtyre projekteve do te nisin ne vitin 2015 por efektin me te madh financiar (pagesat e situacioneve) do e kenë ne vitin 2016.
- Gjithashtu vërehej parashikimi për :
- Investime ne sistemin e teknologjisë se Informacionit me 16 projekte qe kapin shumen prej 610 847 000 leke
- Investim ndërtimor për zyrat qendrore te OSHEE qe kap shumen 473 807 671 leke

Nga monitorimi i periudhës 9-mujore 2015 rezultoi:

Ne miratimin e Planeve te Investimeve nga ERE për vitin 2015, kërkohet nga OSHEE te paraqiste brenda Prillit 2015 Planin e saktësuar te Investimeve kryesisht për investimet ne matje dhe sistemin e Billingut gjë e cila nuk është realizuar nga OSHEE.

Per ndryshimet nuk i eshte kërkuar miratim ERE-s sipas Rregullores. Megjithëse plani i investimeve është ndryshuar 4 here gjate vitit, realizimi i tyre nuk shpresohet qe te realizohet ne përqindje te konsiderueshme aq me pak te kapitalizohet gjate 2015. Niveli i pagesave te kryera për investimet është ne masën rreth 26 %.

Ne muajin mars 2016 nga ana e OSHEE sha u derguan te dhenat operative lidhur me realizimin e investimeve per vitin 2015.

Me poshte po paraqesim te dhena lidhur me realizimin e investimeve per vitin 2015 .				
Rezultate te Investimeve per vitin 2015 (Deklaruar nga OSHEE mars 2016)				
		(Declaruar nga OSHEE mars 2016)		Leke
Nr	EMERTIMI I GRUPIMEVE TE INVESTIMEVE	Te mbartura nga viti 2014	Plani 2015 sipas OSHEE	Realizuar deri ne 31.12.2015
I	Ndertim/rikonstruksion elektrik per Nenstacionet	416,496,969	574,863,897	299,971,427
II	Ndertim/Rikonstruksion linjash te TL	-	30,000,000	-
III	Rikonstruksion ndertimor per N/stacione	-	86,781,945	5,623,356
IV	Blerje Paisje makineri per N/Stacione dhe likujdim avarish	-	686,058,195	346,646,000
V	Ndertim Rrjeti TM	89,112,558	1,079,630,175	146,835,481
VI	Ndertim/Rikonstruksion Rrjeti TM /TU	-	2,434,256,099	1,172,843,796
VII	Ndertim/Rikonstruksion kabinash elektrike	-	107,148,801	45,779,364
VIII	INVESTIMET PRIORITARE (Rrjet TU - ABC lines)	-	893,227,069	161,618,711
IX	Teknologji Monitorimi	-	623,778,492	248,640,000
X	INVESTIME NE MATJE	-	776,968,000	561,185,000
XI	Emergjencia	-	197,347,403	11,582,059
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim	-	20,000,000	14,008,127
XIV	Studime me te trete per marrjen e lejeve te ndertimit	-	5,000,000	42,703,713
XV	Sistem per menaxhimin e Burimeve Njerezore	-	25,000,000	-
	Ndertim dhe Rikonstruksion Objekti Zyra Qendrorete OSHEE	-	169,364,036	18,500,000
	Investime te paplanifikuara	-	-	51,222,473
		505,609,527	7,709,424,112	3,127,159,508
		%	100	41
		Vlera e kapitalizuar 2015 (shtesa)		1,626,099,000

1.11.3 Monitorimi i OST sh.a

Gjatë vitit 2015, ERE ka kryer monitorime për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e licenses dhe Rregullat e Tregut dhe akte të tjera ligjore në fuqi. Realizimi i investimeve ka qenë një nga objektet e monitorimit.

Plani i Investimeve për vitin 2015 u miratua nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me Vendimin Nr.137 dt. 26.12.2014 dhe me Vendimin Nr.46 datë 07.04.2015, Bordi miratoi rishikimin e planit të investimeve të OST sh.a. me disa ndryshime të kërkuara nga shoqëria.

Gjate monitorimit per 9-mujorin 2015, një përqindje e konsiderueshme e investimeve të miratuara për vitin 2015 nuk ishin realizuar.

- Nga 30 zëra investimesh 5-jane realizuar, 9-ne proces e 16 nuk janë prokuruar
- Prokuruar rreth 76 % të fondeve të parashikuara (përfshirë ndryshimet)
- Rreth 28 % të fondeve të prokuruarjanë realizuar deri në shtator 2015
- Rreth 72 % të fondeve të prokuruarjanë në proces deri në shtator 2015
- Gati 40% e zërave të projekteve ka të ngjarë që të mos prokurohen deri në fund të vitit dhe kjo mund të konsiderohet si defekt në planifikimin e investimeve pavarësisht problematikave apo emergjencave që mund të shfaqen gjatë vitit.

- Ecuria e zërave të investimeve me fonde të huaja është e mire
- Nisur nga rezultatet, ku mosrealizimi i investimeve të parashikuara është ngjarje e sigurve, kërkohet vëmendja e kompanisë për me tepër përgjegjshmëri në planifikimin e Investimeve.
- Në muajin mars 2016 nga ana e OST' sha u derguan të dhënat operative lidhur me realizimin e investimeve për vitin 2015.

Me poshte po paraqesim te dhena lidhur me realizimin e investimeve per vitin 2015 .			
Rezultate operative mbi realizimi i investimeve per vitin 2015 nga OST sha (Deklaruar nga OST mars 2016) Leke			
	Te mbartura nga viti 2014	Plani 2015	Realizuar ne total deri ne 31.12.2015
Keto te dhena konsiderohen operative nga ERE, deri ne raportimin sipas rregullores se miratuar nga ERE dhe miratimin e bilancit te OST sha per vitin 2015	362,027,682	2,834,220,048	1,859,891,919
	%	100	66
	Vlera e kapitalizuar 2015 (shitesa)		1,859,891,919

Shenim: Ne listen e investimeve te realizuara verehen ndryshime ne emertimin dhe vleren e projekteve krahesuar me investimet e miratuara nga ERE.

Alokimi i kapaciteteve ne interkonjeksione

Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione, për vitin 2015 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendim nr. 140 date 22/11/2013 “Rregullore mbi alokimin e kapacitetit në interkonjeksione” dhe Rregullores të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për europën juglindore (SEE CAO)” miratuar me Vendimin Nr. 156 dt.01.12.2014. Në përputhje me vendimet e ERE-s, janë zhvilluar ankandet Vjetor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015 për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë si dhe ankandet Mujore dhe Ditore për kufirin me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë.

Në përputhje me vendimet e ERE-s, janë zhvilluar ankandet Vjetor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015 për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë si dhe ankandet Mujore dhe Ditore për kufirin me Malin e Zi, Kosovën dhe Greqinë.

Në tabelen 60 janë përmbledhur disa nga të dhënat e ankandit Vjetor, për periudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor të vitit 2015

		Ankand Vjetor (1 Janar -31 Dhjetor) 2015								
		AL-ME		AL-RS		AL-GR		TOTAL OST		
		imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
Vlera e Ofertave të Pjesëmarrësve	Euro	9,567,146	141,036			134,728	8,831,131	9,701,874	8,972,167	18,674,041
Vlera e Ofertave Fituese	Euro	4,029,600	35,040			19,710	3,291,570	4,049,310	3,326,610	7,375,920
Çmimi Mes i Ofertave Fituese	Eur/MWh	4.60	4.00			0.03	5.01	2.64	2.17	2.41
Numri Ofertave të Pjesëmarrësve	Nr.	48	25			19	41	67	66	133

Numri Ofertave Fituese	Nr.	10	16			11	12	21	28	49
------------------------	-----	----	----	--	--	----	----	----	----	----

Figura 60: Ankandi Vjetor, përperiudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor te vitit 2015

- Ne ankandin vjetor, paraqiten ofertat e tyre 7 subjekte.
- Ne ankandin vjetor janë paraqitur dhe vlerësuar gjithsej 133 oferta, me një total prej 8'795'040 MWh, dhe vlere totale te ofertave 18'674'041 Euro.
- Kane rezultuar fituese ne ankand 49 oferta, me një total prej 3'066'000 MWh, me një vlere totale prej 7'735'920 Euro.
- Evidentojmë se kërkesa e pjesëmarrësve ka qene e shprehur pergjithesisht e njejte për drejtimin import (53.4%) dhe eksport (46.6%).
- Ne përfundim te procedurës se ankandit vjetor nuk ka pasur asnjë ankese te shprehur te pjesëmarrësve, për proçedurat dhe rezultatet e ankandit.

		TOTAL (Vjetor + Mujor) 2015								
		AL-ME		AL-RS		AL-GR		TOTAL OST		
		imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
Vlera e Ofertave te Pjesëmarrësve	Euro	11,043,448	198,691	4,935,401	275,827	174,391	15,890,698	16,153,240	16,365,216	32,518,456
Vlera e Ofertave Fituese	Euro	4,623,279	64,856	1,739,151	74,469	35,662	6,493,594	6,398,092	6,632,919	13,031,011
Çmimi Mes i Ofertave Fituese	Eur/MWh	4.04	0.06	1.91	0.09	0.04	6.11	2.09	2.20	2.15
Numri Ofertave te Pjesëmarrësve	Nr.	201	96	603	213	110	436	914	745	1,659
Numri Ofertave Fituese	Nr.	66	50	196	121	68	115	330	286	616

Figura 61: Ankandevë Vjetor + Mujor, përperiudhën 1 Janar deri 31 Dhjetor 2015

- Ne ankandet mujore te zhvilluara nga OST-ja, nga 30 pjesëmarrësit e tregut te reregjistruar tek OT, kane marre pjese 14 subjekte.
- Ne ankandet mujore janë paraqitur dhe vlerësuar 1'659 oferta, me një total prej 15'458'036 MWh, me një vlere totale te ofertave 32'518'456 Euro.
- Kane rezultuar fituese ne ankand 616 oferta, me një total prej 6'610'33 MWh, me një vlere totale prej 13'031'011 Euro.

- Janë fituar pa kongjestion, me çmim 0.00 Euro/MWh, 46 oferta, me një total prej 400'386 MWh
- Çmimi max i ofertave të paraqitura është 40 Euro/MWh, çmimi max i ankandit ka rezultuar 16.03 Euro/MWh
- Çmimi minimal i ofertave të paraqitura është 0.01 Euro/MWh (sa lejojnë rregullat përkatëse të alokimit), çmimi minimal i ankandit ka rezultuar 0.00 Euro/MWh (kur nuk rezulton kongjestion në ankand)
- Ankandet mujore duke filluar nga muaji Maj 2015 për drejtimin me Malin e Zi janë zhvilluar nga zyra rajonale e ankandëve të kapaciteteve CAO.

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar nga komisioni përkatës i OST-se, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, si edhe udhëzimet apo vendimet përkatëse të ERE-s.

Vlen të theksojmë në këtë kontekst se nuk ka pasur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

Duke vlerësuar se implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjellëndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë, OT vijon kontaktet, takimet dhe konsultimet e herëpashershme me Pjesëmarrësit e Tregut.

Është realizuar rregullisht dhe në përputhje me afatet përkatëse detyruese informimi periodik i OST tek ERE për ankandet e zhvilluara të ATC si dhe publikimi i rezultateve sipas kërkesave në faqen e internetit të OST sh.a.

- Aktualisht në mungesë të Softit të operimit të Tregut, për zhvillimin e ankandëve Ditore është përdorur nga OST platforma elektronike NOVITA.
- Për muajin Maj 2015 e në vijim, edhe alokimi Ditor i kapaciteteve në interkonjeksion për kufirin me Malin e Zi është zhvilluar në SEE CAO
- Në përputhje me vendimin nr. 61 datë 07/07/2014 të ERE-s, janë hedhur nga OT në ankand ditor kapacitetet e pa alokuara në ankandin vjetor, kapaciteti i pa alokuara në ankandin mujor të radhës si edhe kapacitetet “e lira”, të cilat nuk janë nominuar në (D-2) nga Pjesëmarrësit e Tregut.

- Ne total, janë alokuar me kongestion ne ankandet ditor, te zhvilluar nga OST, 20'776 MW (498'624 MWh) me njëçmim mesatar rreth 0.065 Euro/MWh dhe vlera vjetore e ATC te alokuara ne ankandet ditore te OST është 32'604 Euro.
- Nga alokimi ATC Ditore ne SEE CAO, vlera vjetore për OST është 4'898 Euro.
- Pra, ne total, vlera vjetore e alokimit Ditor te ATC për OST është 37'502 Euro

Disbalancat

Në zbatim të Rregullave të Tregut për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu, në bazë orare. Çdo 10 ditë janë informuar nga OST sh.a Pjesëmarrësit e Tregut për disbalancat e kryera në mënyrë që të planifikojnë kompensimet përkatëse. Janë vlerësuar disbalancat e palëve në bazë mujore, të cilat më pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut.

Në grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje në total e volumeve të devijimeve brenda intervalit prej $\pm 2\%$ të pjesëmarrësve të tregut, për periudhën janar – dhjetor 2015. Disbalancat në këto kufi nuk penalizohen në vlera monetare, por kompensohen në energji nga pjesëmarrësit e tregut.

Penalizimet për devijimet që kanë shkaktuar Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2015, jashtë intervalit $\pm 2\%$ në MWh, përlllogariten e faturohen sipas Rregullave të Tregut të miratuara me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s.




Figura 62: Disbalancat brenda dhe jashtë zonës $\pm 2\%$

* Disbalancat, të llogaritura për çdo orë të një muaji, grupohen në disbalanca pozitive (kur energjia e matur është më e madhe se energjia e programuar) dhe si disbalance negative (kur energjia e matur është më e vogël se energjia e programuar), dhe ju faturohen pjesëmarrësve të tregut që kanë përgjegjësinë për këto disbalanca, sipas çmimit përkatës.

Regjistri Pjesmarrësve të Tregut 2015		PRODHUES			P
		TREGTUES			T
		FURNIZUS I KUALIFIKUAR			FK
		FURNIZUES PUBLIK ME SHUMICE			FPSH
		FURNIZUES PUBLIK ME PAKICE			FPP
		SHPERNDARJE			SH
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	nr MPT	data e regjistrimit	Roli ne TEE
1	A&A Group	23X--150311-A-A2	54	10.MARS 15	T,FK
2	Albanian Energy Supplier		58	26.MAJ 15	T,FK
3	Albanian General Electricity	23X--150420-AGE8	45	30 TETOR 14	T
4	ALPIQ Energy Albania	23X--141204AEA-T	11	29 PRILL 11	T,FK
5	AXPO Albania	12XEGL----H----0	3	20 JANAR 11	T,FK
6	Ayen AS Energji	23X--150416-A--N	47	17 DHJETOR 14	T,FK,P
7	Ayen Energy Trading	23X--140426-AY-W	40	7 MAJ 14	T,FK
8	Danske Commodities Albania	23X--121120DCALG	21	31 TETOR 12	T,FK
9	Devoll Hydropower	23X--150409-DHP5	62	11 QERSHOR 15	T,FK
10	EFT Albania	23X--150302-EAL6	18	27 MAJ 11	T,FK
11	EMIKEL		56	16 PRILL 15	T
12	Energija doo Veternik	54X-EDOOV-15-020	68	30 DHJETOR 15	T,FK
13	Energji Ashta		20	25 MAJ 12	P
14	Energy Supply-AL	34X-0000000017-C	24	15MAJ 13	T,FK
15	Erdat Lura		32	17 SHTATOR 13	P
16	Future Energy AL	23X--150301-FE-3	50	6 MARS 15	T,FK
17	GAEA-Energjia Alternative e Gjelber	54X-GAEA11-1501R	66	12 KORRIK 15	T,FK
18	GEN-I Tirana	23X--120709GEN0	4	31 JANAR 11	T,FK
19	Gjo-Spa Power		33	17 SHTATOR 13	P
20	Green Energy Trading Albania	23X--150702GE--3	65	1 KORRIK 15	T
21	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA-----N	16	9 MAJ 11	T,FK
22	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X--130918APC-M	12	25 PRILL 11	P,T,FPSH
23	KURUM International	23X--131115KI--1	35	17 DHJETOR 13	T,FK
24	Le Trading Albania	23X--150309-LT-Y	49	16 SHKURT 15	T
25	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	52	10 MARS 15	T,FK
26	Operatori Shperndarjes Energjise Elektrik	23X--130503--CS-2	7	25 PRILL 11	SH,FPP
27	Roberto Oil	23X--150602-RO-6	60	22 MAJ 15	T,FK
28	Stravaj Energy		38	25 MAJ 14	P,T
29	WENERG		64	10 QERSHOR 15	P

Figura 63: Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2015

1.11.4 Monitorimi i KESH sh.a.

Gjatë vitit 2015, ERE ka kryer monitorime kryesisht lidhur me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike, realizimin e investimeve, analizimin e rezultateve të shoqërisë KESH sh.a, shërbimet ndihmëse si dhe analizimin e shpenzimeve dhe Cash Flow.

Nga monitorimet e transaksioneve që kanë të bëjnë me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike është vënë re se blerja dhe shitja energjisë elektrike është bërë duke iu referuar:

- ✓ Plotësimin të kërkesës për energji elektrike për klientët tariforë OSHEE sh.a, FPP;
- ✓ Parashikimin të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për çdo muaj;
- ✓ Parashikimin të prodhimit të HEC-eve të vegjël;
- ✓ Prurjeve të mëdha me synimin për të evituar shkarkimin e ujit pa prodhim të energjisë elektrike;
- ✓ Përfitimin ekonomik;

dhe në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin e Nr. 30, datë 23.03.2011, si dhe me “Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2011.

Planifikim-Realizimi i investimeve në KESH është monitoruar duke analizuar rezultatet e 9- mujorit të vitit 2015.

Me Vendimin Nr. 136, date 26.12.2014 , Enti rregullator i Energjisë miratoi Planin e Investimeve për vitin 2015 te kompanisë KESH sh.a ne vlerën totale prej 6,053,306,000 Leke nga ku 2,747,306,000 Leke janë investime me financim te huaj dhe pjesa tjetër janë me financimin e vete kompanisë.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë KESH sh.a, me Vendimin Nr. 7, date 31.03.2015 “Për miratimin e Ndryshimeve te programit Ekonomiko-Financiar te KESH sh.a kishte vendosur ndryshimin e Planit te Investimeve te miratuar nga ERE, duke e sjelle për miratim ne ERE me ane te shkresësNr. 353/1, date 24.04.2015.

Ne shtesën e propozuar kryesisht parashikohej dhe ndërmarrja e masave për vlerësimin e defektit në impiantin e ftohjes së TEC, nëpërmjet alokimit të fondit për shërbime konsulence për dizenjimin e detajuar të rivendosjes së sistemit ftohës, i cili do të mundësonte planifikimin e veprimeve që do të ndërmerren në të ardhmen për eliminimin e defektit dhe rivënien në punë të termocentralit.

Nga monitorimi dhe perpunimi i te dhenave per 9-mujorin 2015

- Janë shtyre ne vite, pershire dhe vitin 2015, 18 zëra investimi me vlere 981 500 000 leke ose 28 %
- Janë realizuar 27 zëra investimi me vlere 1 058 752 000 leke ose 30 %
- Janë ne proces 41 zëra investimi me vlere 1 485 500 000 leke ose 42 %
- Investimet me fonde te huaja janë parashikuar 2 669 806 000 leke

Ne muajin mars 2016 nga ana e KESH sha u derguan te dhenat operative lidhur me realizimin e investimeve per vitin 2015.

Me poshte po paraqesim te dhena lidhur me realizimin e investimeve per vitin 2015 .				
Rezultate operative te Investimeve per vitin 2015 (Deklaruar nga KESH mars 2016) 000/Leke				
Nr	EMERTIMI I GRUPIMEVE TE INVESTIMEVE	Te mbartura nga viti 2014	Plani 2015 KESH (KOSTO LOKALE+TE HUAJA)	Realizuar deri ne 31.12,2015
	HEC Fierzë		915,600	707,367
	HEC Koman		805,000	186,364
	HEC Vau i Dejës		1,138,500	239,297
	Projekti i Sigurise se Digave		2,669,806	1,047,925
	KESH Qendër		518,000	180,906
	TEC Vlora		148,252	-
	KESH Security		400	-
			6,195,558	2,361,859
	<i>Keto te dhena konsiderohen operative nga ERE, deri ne raportimin sipas rregullores se miratuar nga ERE dhe miratimin e bilancit te KESH sha per vitin 2016</i>	%	100	38
			Vlera e kapitalizuar 2015 (shtesa)	2,100,000

2. PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

2.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP deri në kufirin Turko-Grek.

Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane.

Dihet se territori ku do të merret kjo sasi gazi është nga me të mëdhatë e krahasuar me Evropën, Afrikën Veriore dhe Rusinë. Në pamjen e mëposhtme jepen rezervat që disponojnë këto rajone. (trilion M³)



Figura 64: World Energy Statistical Review 2014

Projekti fillimisht do të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.

Projekti TAP është zhvilluar nga kompania TAP AG. Aksionerët fillestarë të kompanisë kanë qenë: kompania zvicerane Axpo (42.5%), kompania norvegjeze Statoil (42.5%) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është

gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Shah Deniz që është kompania që shfrytëzon SD2.

Në 30 korrik 2013 struktura e aksionereve të TAP ndryshoi si vijon; BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%)

Ka pasur përsëri ndryshim aksioneresh për të cilin janë njoftuar të gjithë palët e interesuara përfshi edhe tre autoritetet kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Disa ndryshime në pronësinë e TAP AG - sidomos, dalje e përgjithshme e Total Gas Transport Ventures S.A.S. dhe E.ON (përmes Global Commodities SE), dalja e Statoil ASA si aksionerëve dhe hyrjen e Enagás Internacional SLU dhe SNAM S.p.A (Itali) Aksionerët aktualë paraqiten sipas tabelës mëposhtme:

Aksionerët	Aksionerët përpara ndryshimit të parashikuar në 23 Korrik 2013	Aksionerët aktualë Për 2015	Ndryshimi
AzTAP (më parë e njohur si SOCAR GAS Pipelines GmbH)	20%	20%	0%
BP Gas Marketing Ltd	20%	20%	0%
SNAM S.p.A(Itali)	0%	20%	+20%
Fluxys Europe BV	16%	19%	+3%
Enagás Internacional S.L.U	0%	16%	+16%
Axpo Holding AG	5%	5%	0%
Total Gas Transport Ventures SAS	10%	0%	-10%
E.ON,Global Commodities SE	9%	0%	-9%
Statoil ASA	20%	0%	-20%

Figura 65: Aksionerët aktualë TAP

2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG

Një nga problemet kryesore që ishte për zgjidhje gjate vitit 2015-te kishte të bënte me Certifikimin e TAP-AG nga Enti Rregullator i Energjisë, në kushtet kur nuk kishte dal Ligji i Ri të gazit dhe duhej të transpozohet "Paketa e Tretë e Energjisë". Si një nga ceshtjet me thelbesore për këtë ceshtje ishte miratimi i Rregullores për Certifikimin e OST të gazit natyror.

Pra: Gjate vitit 2015-te , ERE mori vendimin paraprak për Certifikimin e Gazsjellësit Trans Adriatik AG (TAP-AG), si Operator i Sistemit te Transmetimit për Gaz Natyror bazuar ne Rregulloren e Certifikimit te OST te gazit natyror".

Ky vendim është miratuar ne datën 31 Tetor 2015 mbështetur ne nenet 13, 37 dhe 38 te Ligjit Nr.102/2015, “ Për Gazin Natyror” si dhe nenit 11 te Rregullores se ERE, “Për Certifikimin e Operatoreve te Sistemit te Transmetimit”.

Vendimi paraprak është përgatitur ne bashkëpunim te ngushte me Autoritetet Rregullatore te Italisë dhe Greqisë te cilat kane nxjerre vendime te ngjashme për certifikimin e TAP-AG. Përsa trajtuam me larte, këto vendime janë ne përputhje te plote me Nenin 10-te, te Direktivës 2009/73/EC si dhe te Nenit 3, te Rregullores(EC)Nr.715/2009.

Aplikimi i Certifikimit u bazua ne modelin e pavarur te operatorit te transmetimit, ku TAP-i duhet te plotësonte te gjitha kushtet e vendosura ne Kapitullin IV te Direktivës se Gazit përveç nenit 22 te kësaj Direktive.

Gjithashtu, gjate vitit 2015-te, Shqipëria filloj punimet përndërtimin e gazsjellësit TAP-AG, me 03, Korrik 2015, nëpërmjet një ceremonie ku mori pjese edhe Kryeministri i vendit EDI RAMA. Faktikisht jemi vendi i pare nga tre vendet ku do te kaloje dhe do te ndërtohet ky Gazsjellës, qe po kryejmë punime ndihmese si përtrasenë ku do te kaloje tubacioni ashtu edhe përrrugët e reja e riparimin e disa rrugëve ekzistueseve apo nderimin e urave e punimeve te tjera te nevojshme përkëtë projekt.

Njëkohësisht duhet te bëjmë me dije se:

Ka filluar ardhja e tubacioneve ne Portin e Durrësit, po vazhdon transportimi i tyre ne vende te caktuara gjate trasesë, dhe shume shpejt ne Maj te 2016-tes do te filloj edhe shtrirja dhe montimi i këtij tubacioni.

2.2.1 Vendimi i Përrjashtimit të TAP AG-s

Vendimi i Përrjashtimit është i mbështetur ne paragrafin 4.5 te FJO i cili përrjashton TAP-AG nga dispozitat e pronësisë, si përrcaktohet ne nenin 9(1) te Direktivës se Gazit.

I gjithë investimi që do të kryhet përkëtë projekt do jete rreth 45 miliard dollarë duke përshtkruar gjashte shtete me njëgjatësi tubacioni 3500 km.



Figura 66: Projekti TAP

- ✚ TAP, ka një gjatësi rreth 878 kilometra.
- ✚ Gjurma e tij fillon në kufirin Turko-Grek, kalon nëpër territorin grek dhe hyn në Shqipëri në zonën e Bilishtit.
- ✚ Ai përshkon 204 kilometra në Shqipëri (nga Bilisht- Qendër në kufirin greko shqiptar deri në zonën bregdetare në Seman në veri të Fierit),
- ✚ Shtrihet 105 kilometra nëpër Detin Adriatik, del në Melendugno dhe vazhdon edhe 5 kilometra në territorin Italian.
- ✚ Në gjatësinë e shtrirjes së këtij projekti vlerësohet të jete deri në 1800 m në lartësinë e maleve në vendin tone
- ✚ Rreth 820m tubacioni do të kalojë në tabanin e detit Adriatik. Kjo e bën që ky projekt terrenin me të vështirë ta ketë në territorin tone.

Final Joint Opinion i qershorit 2013 përcaktonte se Vendimi Përrjashtues do të humbte efektin dhe vlefshmërinë e tij nëse ndërtimi nuk do të fillonte brenda 3 viteve (pra, brenda Qershorit 2016) dhe nëse nuk fillonte veprimtaria operationale brenda 6 viteve të ardhshme. Gjithsesi, Komisioni i BE-se do të mund të aprovonte një shtyrje në rastin e ndonjë vonese të shkaktuar nga pengesa madhore përtej fuqisë së TAP-it. (kjo bazuar në nenin 36.9 të Direktivës 79/2003/EC.

Në vendimin e Komisionit European të majit 2013 parashikohej se roli TAP-it është vetëm një nga elementet në vazhdën e investimeve që nevojiten të kryhen për të siguruar prodhimin e Gazit të Shah Deniz 2 dhe transportimin e gazit për në BE. Veçanërisht, vendimi parashikonte se TAP-i nuk ka asnjë influence mbi zhvillimin e

mëtejshëm të procesit; pra, asnjë influence mbi fushën e gazit të Shah Deniz 2, infrastrukturën e transportit nga Azerbajxhanipër në Gjeorgji, si dhe infrastrukturën e transportit përgjatë Turqisë.

Në kohën që është marrë Vendimi Përjashtues për TAP-in, duke patur parasysh edhe kërkesën për shtyrje nga Konsorciumi nëpërmjet TAP-it dhe të miratuar nga tre Autoritetet, Janari vitit 2020-s deri në Dhjetor të vitit 2020, është vlerësuar si periudha kohore kur gazi do të hyjë në sistemin transportit të TAP-it.

2.2.2 Data e Planifikuar e Fillimit të TAP-it (PCD).

Projekti TAP-AG ka një ecuri shume të mire i cili përputhet me grafikun e miratuar nga konsorciumi në lidhje me prodhimin e gazit nga vendburimi i Shah Denizit, por gjithashtu edhe veprimeve të mëtejshme deri në Maj 2016, ku është data finale përfillimin e ndërtimit të tubacionit në të tre shtetet ku do të kalojë ky tubacion.

Përsa i përket TAP-it, procedura për të përcaktuar PCD-n përshkruhet në Marrëveshjen për Përcaktimin e Tarifave (TDA) të korrikut 2013, ku palët që kanë rënë dakord janë BP Exploration (Shah Deniz) Limited (për llogari të South Gas Corridor), SOCAR dhe TAP AG. Në TDA është sanksionuar e drejta e SDC-se për të përcaktuar PCD brenda parametrevë të përcaktuara.

TAP-i nuk është një infrastrukturë ekzistuese, dhe si një projekt gazsjellësindërkufitar dhe i vetë qëndrueshëm ende për tu ndërtuar, TAP-i nuk do të marrë aktivitetet e OST-se, para datës në të cilëngazsjellësi TAP do të përfundojë dhe do të jetë në gjendje të marrë, transportoj dhe të dërgoj Gazin Natyror, ashtu si është përcaktuar në Commercial Operacioni Data (COD) në FJO.

Në gusht 2013, të tre Rregullatorët Kombëtare u njoftuan nëpërmjet një shkresë të hartuar nga TAP-i ku përmbledhej TDA-ja (Marrëveshja e Përcaktimit të Tarifave), përfshirë edhe parimet e 'funneling mechanism'. Procesi për të përcaktuar PCD është gjithashtu i përfshirë në versionin final të Kodit të Tarifës së TAP-it, i cili u miratua nga Rregullatorët Kombëtare në Nëntor të 2013-ës.

2.3 Gjendja aktuale e Projekti TAP dhe projekte të tjera në sektorin e gazit

Projekti TAP doli si një Projekt me Rëndësi Kombëtare në Dhjetor 2012, hartimi i një marrëveshjeje ndërqeveritare midis tre shteteve; Greqi, Itali dhe Shqipërisë u arrit të bëhej, në shkurt 2013. Qeveria shqiptare bëri një marrëveshje me TAP-in, Host Government Agreement, HGA në prill 2013 dhe një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) përmbështetjen e TAP & IAP në maj 2013.

Nga qeveria shqiptare u aprovua me 03 Maj 2013, Vlerësimi i impaktit social dhe ambiental, gjë e cila hapi rrugën për veprime të mëtejshme.

Projekti TAP-AG po shikohet si një projekt që krijon unazën (Ring) në Europë, kjo do të bëjë që të ketë diversitet furnizimi me Gaz Natyror por njëkohësisht lidhja në të ardhmen e afërt me Projektin IAP, do të bëjë vendin tonë një nyje lidhëse në drejtim të Malit të Zi, Kosovës, Maqedonisë dhe Kroacisë.

Në lidhje me projektin IAP, qeveria ka aplikuar tashmë për financime të projektit pranë Komisionit Europian, dhe po punohet ngushtësisht me qeveritë e dy shteteve të tjera ku kalon ky projekt, Mali i Zi dhe Kroacisë për sigurimin e këtyre fondeve e duke shkuar drejt realizimit të këtij projekti.

Njëkohësisht projekti IAP, duke kaluar në drejtim të veriut, përshkon në mënyrë gjatësore territoret e vendit tonë, dhe për rrjedhojë do të shërbejë si një magjistral, rrjet transmetimi i presionit të lartë, duke siguruar kështu një furnizim të qëndrueshëm afat gjatë me gaz.

Ky projekt do të bëjë lidhjen me projektin TAP-AG, nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi do të përfundojë në Kroaci, dhe nga ky projekt do të përfitojë, Kosova dhe Bosnja Hercegovina. Gjatësia e këtij tubacioni do të jetë 511 km, do të transportojë 5 bcm/vit dhe përfituesit nga kjo sasi gazi do të jetë; Shqipëria me 1bcm/vit, Mali i Zi me 0,5 bcm/vit, Bosnja dhe Hercegovina 1bcm.vit, Kroacia me 2.5 bcm/vit. Kosova do të marrë gaz nëpërmjet Shqipërisë.

Projekti TAP në vendin tonë tashmë ka hyrë në periudhën e implementimit të tij, ose në fazën e ekzekutimit, dhe pas tij do të kemi ndërlidhjen me projektin tjetër IAP.

Aktivitetet gjatë 2015 në lidhje me Projektin TAP.

Në 03 Korrik 2014, u bë inaugurimi i fillimit të punimeve të projektit TAP. Aktualisht është duke u punuar dhe konkretisht:

-Në 150 km rrugë të reja dhe riparime apo zgjerime të atyre ekzistuese

-Në ndërtimin e 52 urave të reja si dhe riparimin e disa të tjerave

-Po punohet në trasenë ku do të kalojë tubacioni me gjatësi 215 km

-Punime paraprake për një Stacion Kompresori në Fier dhe një Stacion Matjeje në Bilisht

- Tubacioni do te përshkojë ne 570 rruge dhe 440 përrenj, lumenj dhe kanale si dhe një hekurudhe
- Kane arritur tubacionet ne portin e Durrësit dhe po kryhet transporti i tyre, ka filluar puna ne stacionin e kompresorit ne Fier si dhe ka filluar rehabilitimi i disa rrugëve.

Aktivitetet te tjera gjatë 2015 ne lidhje me zhvillimet ne sektorin e gazit

Kemi një ecuri te kënaqshme ne lidhje me “Master Planin e Gazit Natyror për Shqipërinë dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare ne Fushën e Gazit Natyror”, Enti Rregullator i Energjisë ne këtë projekt është Pale e Interesuar dhe jemi shume aktive ne pjesëmarrjen e këtij projekti nëpërmjet debateve, mendimeve, dhe mbështetjen me te dhënat te cilat do te ndikojnë ne cilësinë e këtij projekti.

Ky projekt do te përfundojë ne Tetor 2016, me pas hapet rruga për zhvillime te mëtejshme deri ne ndërtimin e rrjetit te gazit, si i atij Transmetues ashtu edhe Shpërndarës. Synimi do te jete qe i gjithë ky rrjet transmetimi dhe shpërndarje, te përfundoj ne te njëjtën kohe kur edhe gazi nëpërmjet TAP-it te vije ne vendin tone.

2.2.4 Zgjatja e Periudhës së Përrjashtimit

Është shume e rëndësishme te cilësojmë “Zgjatjen e Periudhës se Përrjashtimit”, sepse : projekti TAP është një projekt unik dhe i vetë qëndrueshëm, është subjekt i një regjimi rregullator te gjere dhe te rrepte, ne përputhje me kushtet e përrjashtimit nga FJO dhe sepse ky projekt i ri i vetë qëndrueshëm, i financuar nga Aksionerët e tij, nuk mund te certifikohet ne te njëjtat kushte si një infrastrukture ekzistuese.

2.3 Zhvillime te tjera rreth projektit TAP

2.3.1 Rreth vendimeve të marra për projektin.

Viti 2015-te ka qene një vit ku puna për projektin TAP është intensifikuar se tepërmi dhe ku rezultatet kane qene konkrete dhe te dukshme. Ne jemi vendi i pare qe filluam punimet e TAP-it duke u krahasuar me dy vendet fqinje Italinë dhe Greqinë.

Enti Rregullator i Shqiperise se bashku me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, kane marre vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG. Këto vendime janë mare në përputhje të plote me Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit, 2009/73/EC, Rregullores (EC) N0.715/2009 , te Vendimit te këshillit

Ministrial No.D/2011/02/MC-EnC, si dhe ligjit “Për Gazin Natyror” Nr.102/2015, i cili tashme ka reflektuar te gjitha kërkesat e Bashkimit European.

2.3.2 Vendimet e mara gjate vitit 2015 për gazin natyror

Gjate vitit 2015 janë mare një sere vendimesh me rëndësi për zhvillimin e tregut te gazit natyror ne vendin tone. Nga vendimet me te rëndësishme kane qene: Miratimi i vendimit paraprak për certifikimin e TAP-AG si TSO dhe miratimi me pare i rregullores për certifikim ne përputhje me ligjin e ri te gazit natyror nr.102/2015. Dhe konkretisht vendimet te mara janë:

- ✓ -Vendimi Nr.25. date 11.02.2015. Përlicencimin e shoqërisë “Anio Oil& Gas” sh.a ne aktivitetin e tregtimit te gazit natyror përnjë afat pese vjeçar
- ✓ -Vendimi Nr.26. date 11.02.2015, Për miratimin e pagesës se aplikimit përlicencë ne sektorin e Gazit Natyror
- ✓ Vendimi Nr.43, date 07.04.2015, Për fillimin e procedurave përlicencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a ne aktivitetin e tregtimit te Gazit Natyror
- ✓ -Vendimi Nr.52, date 17.04.2015, Mbi zbatimin e ndryshimeve te kërkuara nga Komisioni European dhe Sekretariati i Komunitetit te Energjisëpër “Opinionin e Përbashkët” te Autoritetit Rregullator te Energjisë se Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë, te miratuara me Vendimin Nr.135, date 24.12.2014 te ERE-s
- ✓ Vendimi Nr.87, date 30.06.2015, Për refuzimin e kërkesëspërlicencim te shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a, ne aktivitetin e tregtimit te Gazit Natyror
- ✓ -Vendimi nr.90, date 15.07.2015, Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullores mbi procedurat e certifikimit te operatorit te sistemit te transmetimit te Gazit Natyror
- ✓ Vendimi Nr.100, date 05.08.2015, Për miratimin e rregullores për certifikimin e operatorit te sistemit te Transmetimit për Gazin Natyror
- ✓ -Vendimi Nr.101, date 05.08.2015, Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit te shoqërisë TAP-AG për Certifikimin si Operator i Pavarur i Transmetimit te Gazit natyror

- ✓ -Vendimi Nr.130, date 31.10.2015, Për Certifikimin Paraprak te shoqërisë TAP-AG si Operator i Sistemit te Transmetimit te Gazit Natyror
- ✓ Vendimi nr.129, date 31.10.2015, Mbi disa ndryshime ne Rregullat për certifikim e Operatorit te Sistemit te Transmetimit te Gazit Natyror
- ✓ Vendimi Nr.137, date 26.11.2015, Mbi fillimin e Procedurave përlicencimin e shoqërisë “Phoenix Petroleum “sh.a, ne aktivitetin e furnizimit te Gazit Natyror

2.3.3 Metodologjia e Tarifave te Gazit Natyror per TAP AG

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aeeg) aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga kompania TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për TAP përshkruan metodologjite e përdorura për përcaktimin e termave dhe kushteve të çmimeve që do të aplikohen për TAP do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit te detyrueshëm të palëve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave e propozuar nga TAP AG është transparente dhe jo diskriminuese. Kodi i Tarifave parashikon një zvogëlim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të riskut ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

Metodologjia e Tarifave ka pësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion. Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013.

Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifat; reflektimi në tarifë i kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuese; mekanizmi që tarifat të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesi i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

2.3.4 Problemet kryesore që dalin për zgjidhje në sektorin e Gazit Natyror

Me miratimin e ligjit të ri të gazit No.102/2015, “Për Gazin Natyror” vendi jone ka implementuar “Paketën e Treta të Energjisë” dhe është kështu që nga vendet e para se bashku me Serbinë dhe Malin e Zi që po aplikojnë këtë paketë, kur me pare nuk kishin arritur të implementonin “Paketën e Dytë të Energjisë”.

Në këto kushte del në mënyrë emergjente aplikimi i kësaj pakete e cila kërkon një angazhim total jo vetëm të Entit Rregullator të Energjisë, por edhe institucioneve të tjera që kanë lidhje me këtë problem.

Në problemet shumë emergjente janë:

1. Krijimi i OST-G.

Ajo duhet të certifikohet nga ERE, në përputhje me ligjin kombëtar të gazit natyror, sepse ajo do të jetë Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit në vendin tone.

Tashmë është e ditur që vendi ynë ka ratifikuar Traktatin e Krijimit të Komunitetit të Energjisë dhe është pale kontraktuese e detyruar të ndërmarrë të gjitha hapat për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ky Traktat.

Njëkohësisht në fund të muajit Tetor 2015, ka hyrë në fuqi ligji i ri i “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i cili në nenin 35 pika 6 të tij, përcakton se: *“Licenca për transmetimin e gazit natyror, e dhënë para miratimit të këtij ligji, që lejon shoqërinë e gazit natyror (në këtë rast Albpetrol sh.a) të kryejë dhe të përmbushë detyrat që lidhen me transmetimin e gazit natyror, konsiderohet si licencë e përkohshme, që autorizon ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit, por në çdo rast nuk mund të zgjasë më vonë se data 01 Qershor 2016.*

Institucionet po punojnë për përshtatjen sa me pare të OST-se të gazit (Albpetrol sh.a), në përputhje me Direktivën e gazit 2009/73/EC të Këshillit dhe Parlamentit Evropian date 13 Korrik 2009, të Rregullores (EC) nr. 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 13 Korrik 2009 dhe të ligjit të ri të gazit Nr. 102/2015.

Ky është një detyrim që vjen si rrjedhojë e:

- TAP-i tashmë ka filluar punimet e ndërtimit ne territorin e vendit tone. Brenda vitit 2019 ai do te këtë përfunduar ndërtimin e tij dhe do te jete i gatshëm për transportin e gazit drejt Italisë, por edhe për nevojat e vendit tone. Është ne te mire te vendit tone qe OST-ja e re e gazit te bëhet funksionale menjëherë pasi duhet te futet ne marrëdhënie kontraktuale me TAP-AG për punime ndihmese.
- Këto marrëdhënie TAP-AG ndërkohë po i ndërton me vendet fqinje si Greqia dhe Italia.
- Licenca ekzistuese (qe aktualisht e ka Alpetroli) përfundon me 30 Maj 2016 dhe kompania e re e krijuar do te licencohet nga ERE, por duhet që ajo më parë të Certifikohet si OST-G, proces i cili merr kohë dhe përmban procedura që zgjasin. Për me tepër mund te themi se:
 - a) Afati i fundit për te aplikuar ne ERE nga ana e OST-G është 30 maj 2016
 - b) Afati i fundit për ERE-n për te dhënë vendimin është katër muaj
 - c) Afati i fundit për Sekretariatin për ti dërguar ERE-s një Opinion për aplikantin është, katër muaj
 - d) Zgjatja e afatit për Sekretariatin për ti dërguar ERE-s një Opinion nëse ajo vendos te përfshijë Bordin Rregullator te KE-se, është dy muaj
 - e) Afati i fundit për ERE-n për te nxjerrë vendimin përfundimtar te certifikimi, duke përfshirë opinionin nga Sekretariati, është dy muaj
- Jo me vone se fillimi i operacioneve te TAP-it, do te behet një Testim i Tregut (MARKET TEST), për alokimin e kapaciteteve. Me pas do te kete testime tregu cdo dy vjet sipas FJO.

3. PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë

3.1 Çmimet dhe Tarifatat e Energjisë

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” përkatësisht në nenet 19, 20, 79, 83 dhe 85 ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara që realizohen në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë e miratuara nga Bordi i ERE-s.

3.1.1 Lenia në fuqi përperiudhën 1 Janar 2016-30 Qershor 2016 të tarifave ekzistuese dhe çmimet me pakice të energjisë elektrike .

Bazuar në nenin 20 të ligjit nr. 43/2015 ERE me vendimin Nr.156 datë 24.12.2015 la në fuqi tarifatat dhe çmimet ekzistuese të prodhimit, të furnizimit me shumicë, shërbimit të transmetimit, shpërndarjes dhe çmimet e furnizimit me pakice të energjisë elektrike të miratuara me vendimet nr. 139, 140, 141, 145, 146, 147, dhe 148 datë 26.12.2014 si dhe vendimin nr. Nr. 27 datë 16.02.2015 “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do të paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, deri në marrjen e vendimit të shfuqizimit të tij nga Bordi i ERE.

Marrja e këtij vendimi u kushtëzua nga:

- Hartimi i akteve nënligjore dhe rregullatore në përputhje me Ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk kishte përfunduar. Mungonin aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të ligjit të ri Nr. 43/2015 të cilat përcaktojnë qartë detyrat dhe funksionet e secilit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, si dhe detyrimet për ofrimin e shërbimit publik. Neni 108 i ligjit 43/2015 i ka lënë ERE-s dhe organeve përgjegjëse si Këshilli i Ministrave, MEI-it apo të licencuarve, një afat prej 12 muajsh për hartimin dhe miratimin e këtyre akteve.
- Procesi i mbylljes së detyrimeve të ndërsjella midis KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a nuk kishte përfunduar. Mbyllja e detyrimeve të ndërsjella është një problematikë e mbartur që nga viti 2012 për të cilën, referuar VKM nr. 126, datë 11.02.2015, filloi procesi i shuarjes me kompensim të detyrimeve të ndërsjella të shoqërive të sektorit energjetik. Ky është një proces kompleks që kërkon kohë për evidentimin, rakordimin, shlyerjen dhe kompensimin e tyre. Në vlerësimin e ERE-s, procesi i mbylljes së detyrimeve të ndërsjella është ngushtësisht i lidhur me procesin e axhustimit të tarifave dhe çmimeve për

periudhën paraardhëse e cila duhet të reflektohet në tarifën e periudhës pasardhëse.

- Shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a nuk paraqiten Planin e Investimeve për vitin 2016. ERE e konsideron planin e investimeve një komponent të rëndësishëm për përcaktimin e të ardhurave të kërkuara për aktivitetet e rregulluara. Për këtë arsye, aplikimi për Planin e Investimeve të kompanive të rregulluara normalisht i paraprin paraqitjes së kërkesave për rishikimin e tarifave.
- Shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE sh.a nuk paraqiten aplikimet për rishikimin e tarifave përkatëse për vitin 2016. Kjo lidhet ndërsa të tjera me përmbushjen e detyrimeve të ligjit të ri të sektorit e veçanërisht me hartimin e Modelit të Tregut të energjisë si dhe hartimit të akteve të tjera nënligjore dhe rregullatore. Ligji i Sektorit të Energjisë parashikon një periudhë tranzitore për të transferuar aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumice tek Furnizuesi Publik me Pakice, pjesë e OSHEE sh.a.

Ndodhur në këtë periudhë tranzitore, kryerja e një analize dhe vlerësimi për të ardhurat e kërkuara për vitin 2016 nga ana e kompanive publike, KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. ishte lidhur me llogaritjen e kostove të operimit për të përmbushur aktivitetin në përputhje me kriteret që përcakton ligji, si dhe përditësimin e tarifës për periudhat e mëparshme rregullatore. Ky përditësim ishte i pamundur të realizohej si pasojë e situatës financiare të trashëguar, e reflektuar kjo tek marrëdhëniet e ndërsjella midis tre operatoreve.

- Ministria e Energjisë dhe Industrisë si dhe tre kompanitë publike u shprehën pro shtrirjes së efektit të tarifave dhe çmimeve aktuale deri në 30 Qershor 2016.
- U konstatua një situatë e përmirësuar e sektorit që shërbeu si indikator i mjaftueshmërisë së tarifave dhe çmimeve të vitit 2015, të cilat janë të mjaftueshme për kryerjen e një aktiviteti normal për të tre kompanitë publike për 6-mujorin e parë të vitit 2016.

Ky konstatim i bërë nga ERE në periudhën e marrjes së vendimit rezultoi i saktë nisur nga raportimet me të fundit të kompanive KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. në lidhje me pasqyrat financiare të vitit 2015 (të pa audituara). Në vijim paraqesim të ardhurat e kërkuara të miratuara nga ERE si dhe ato të realizuara në fakt për vitin 2015:

KESH sh.a. Te ardhura te kerkuara/realizuara per vitin 2015	Miratuar nga ERE			Realizuar nga KESH sh.a. (Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve)
	Aktiviteti i Gjenerimit	Aktiviteti i Furnizimit me Shumice	Total KESH sh.a.	
<i>Shpenzime Operative (OPEX)</i>	1,749	42	1,791	1,724
<i>Amortizimi i vitit</i>	1,026		1,026	1,954
<i>Shpenzime per blerje energjie</i>		9,057	9,057	10,542
<i>Sherbimi i borxhit per TEC Vlore</i>	1,531		1,531	
<i>Shpenzime per interesa</i>		1,772	1,772	1,769
<i>Axhustimi i te ardhurave te periudhes se meparshme rregullatore</i>			(2,030)	
<i>Te ardhurat nga shitja e energjise me cmime tregu</i>		(2,030)		
<i>Fitmi perpara taksave</i>	687	69	756	3,308
TOTAL	4,993	8,909	13,902	19,296

Tabela 67: Te ardhurat 2015 KESHsh.a. (Burimi KESH sh.a, ERE)

OST sh.a. Te ardhura te kerkuara/realizuara per vitin 2015	Miratuar nga ERE	Realizuar nga OST sh.a. (Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve)
<i>Shpenzime Operative (OPEX)</i>	2,283	1,985
<i>Amortizimi i vitit</i>	1,625	1,718
<i>Axhustimi i te ardhurave nga alokimi i kapaciteteve</i>	(900)	
<i>Shpenzime financiare-neto</i>		119
<i>Fitmi perpara taksave</i>	1,086	2,764
TOTAL	3,008	6,585

Tabela 68: Te ardhurat 2015 OST sh.a (Burimi OST sh.a, ERE)

OSHEE sh.a. Te ardhura te kerkuara/realizuara per vitin 2015	Miratuar nga ERE			Realizuar nga OSHEE sh.a. (Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve)
	Aktiviteti i Shperndarjes	Aktiviteti i Furnizimit me Pakice	Total OSHEE sh.a.	
<i>Shpenzime Operative (OPEX)</i>	7,883	2,069	9,952	8,526
<i>Amortizimi i vitit</i>	3,331		3,331	2,102
<i>Kosto e blerjes se energjise per humbje</i>	9,323		9,323	13,004
<i>Kosto e blerjes se energjise nga FPSH</i>		13,632	13,632	13,378
<i>Kosto e transmetimit te energjise per FPP&Humbjet</i>	787	2,954	3,741	3,969
<i>Shpenzime per Borxhin e Kcq/Provigjione</i>		4,497	4,497	(1,525)
<i>Shuma vjetore per shlyerje detyrimi ndaj CEZ a.s. (marreshja qeveritare)</i>		3,433	3,433	
<i>Shpenzime financiare-neto</i>				1,366
<i>Te ardhura nga lidhjet e reja dhe energjia reaktive</i>	(652)		(652)	
<i>Te ardhura te jashtezakonshme</i>				(3,874)
<i>Fitmi perpara taksave</i>	1,084	300	1,384	17,605
TOTAL	21,757	26,884	48,641	54,552

Tabela 69: Te ardhurat 2015 OSHEE sh.a(Burimi OSHEE sh.a, ERE)

Theksojme se te ardhurat dhe shpenzimet e tre kompanive publike për vitin 2015 do të jenë objekt i një analize të detajuar në procesin e rishikimit të tarifave dhe cmimeve për vitin 2016.

3.1.2 Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri ne 15 MW.

Për këtë kategori prodhuesish përcaktimi i tarifës se prodhuesve te energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2016 kushtëzohej nga publikimi i raportit vjetor te bursës se Hungarisë siç parashikuar ne VKM Nr. 1033, datë 16.12.2015 i cili përcaktoi "Metodologjinë e llogaritjes së tarifave fikse të energjisë, që do t'i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet". Për këtë arsye, ERE me vendimin e saj nr. 156 te datës 24.12.2015, la ne fuqi tarifën ekzistuese te miratuar me vendimin e Bordit te ERE-s, nr.27 date 16.02.2015. Fuqia juridike e këtij vendimi zgjati deri ne date 16.02.2016. Pas publikimit te raportit vjetor te bursës se Hungarisë ne përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 1033, datë 16.12.2015 , ERE procedoi me përcaktimin e tarifave fikse të energjisë që do t'i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, për vitin 2016 sipas metodologjisë te përcaktuar ne VKM te sipërcituar:

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1033 Datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë që do t'i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”, përcaktoi formulën për llogaritëse te çmimit te shitjes së energjisë së prodhuar nga prodhuesit e vegjël ku element kryesor është çmimi mesatar i bursës hungareze:

“Çmimi i shitjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X koeficientin 1.24 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

$$Pu=42.92/1000*1.24*139.95=7.448 \text{ leke /kWh}$$

Çmimi 7.448 leke/kWh i miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s nr. 13 date 16.02.2016 do te jete çmimi me te cilin prodhuesit e energjisë nga hidrocentralet do te shesin energjinë e prodhuar prej tyre përgjatë vitit 2016.

Ky cmim rezultoi i përafërt me atë te vitit 2015 (7.636 leke/kWh), duke mos krijuar luhatje te mëdha te kostove për Furnizuesin Publik me Shumice, kosto e cila është e transferueshme tek konsumatorët tarifore.

Shoqata AREA nëpërmjet padisë së ngritur në Gjykatën Administrative të shkallës së Parë Tiranë ka kërkuar :

- Kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimi të ERE nr. 156 datë 24.12.2015 “Mbi lënien ne fuqi të vendimeve nr. 139; 140 ; 141; 145; 146; 147; 148 datë 26.12.2014 si dhe të vendimit nr. 27 datë 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 Janar-30 Qershor 2016”;
- Detyrimin e ERE-s si Organ Administrativ kompetent, për të nxjerrë aktin normativ për përcaktimin e tarifave fikse të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të nenit 15 të Ligjit 138/2013 “Për burimet e Energjisë së rinovueshme”
- “Marrjen e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të zbatimit të vendimit nr. 156 të ERE”

AREA ne padinë drejtuar gjykatës Administrative te shkalles se pare Tirane, nder te tjera shprehet se Vendimi nr. 156 datë 24.12.2015 “Mbi lënien ne fuqi të vendimeve nr. 139; 140 ; 141; 145; 146; 147; 148 datë 26.12.2014 si dhe të vendimit nr. 27 datë 16.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE për periudhën 1 Janar-30 Qershor 2016” është marre ne kundërshtim me kuadrin ligjor ne fuqi dhe cenon te drejtat e prodhuesve te vegjël te energjisë elektrike te parashikuara nga Ligji për Burimet e Rinovueshme dhe nga kontratat koncesionare mes te licencuarve dhe Ministrisë përgjegjëse për energjinë.

Aktualisht lidhur me këtë padi gjykata pranoi kërkesën e ERE për shpalljen e mos juridiksionit dhe si te tille kjo çështje është kaluar për shqyrtim ne Gjykatën e Apelit Administrativ.


Me vendimin nr. 13 date 16.02.2016, nder te tjera ERE ka përcaktuar se me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 27 date 16.02.2015 i Bordit të Komisionerëve të ERE, “Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2015, që do t'i paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet.

ERE ka hapur procedurën për miratimin e “Metodologjisë se përcaktimit te Çmimi te shitjes së energjisë elektrike për prodhuesit e energjisë nga hidrocentralet” e cila pritet te përfundojë gjate muajit mars 2016 dhe do te jete e aplikueshme për vitin 2017, nëse rishikimi i Ligjit 138/2013” për Burimet e Rinovueshme “ nuk do te parashikoje ndryshime te formulës për përlogaritjen e kësaj tarife.

Me gjithë ankesave te përsëritura te kësaj shoqate te prodhuesve te vegjël nga hidrocentralet, duket se tarifa nxitëse e përcaktuar sipas metrologjisë te miratuar me VKM nr., 126 date 11.12.2015 si dhe VKM nr.1033 date 16,12,2015 , është e

mjaftueshme, pasi kompanitë pergjithesisht kane pasur rezultat financiar pozitiv për periudhën ushtrimore.


Grafiku në vijim paraqet ecurinë e te ardhurave e realizuara nga shitja e energjisë elektrike për PVE-të dhe HEC Ashta në vite.



Grafiku 70: Të ardhurat nga HEC-et e Vegjël dhe HEC Ashta (Burimi: KESH sh.a.)

Vërehet se te ardhurat kane qene ne nivel te qendrueshem pergjate vitit 2015 krahasuar me vitin 2014 duke mos krijuar luhatje ne kostot e Furnizuesit Publik me Shumices. Kjo për faktin se me vendimin nr. 27 date 16.02.2015 ERE miratoi një tarifë prej 7.636 leke/kWh për energjinë e prodhuar nga hidrocentralet me fuqi deri 15 MW e cila rezulton e perafert me mesataren e ponderuar te realizuar ne vitin 2014 sic verehet ne grafikun 74. Me këtë vendim, për here te pare u unifikua metodologjia e llogaritjes se tarifave për te dy kategoritë e prodhuesve (hidrocentralet ekzistuese dhe hidrocentralet e reja me koncesion deri ne 15 MW). Për llogaritjen e kësaj tarife merret për reference çmimi i tregut te energjisë (Bursa e Hungarisë) plus një incentive prej 24 % mbi këtëçmim.


Grafiku ne vijim paraqet ecurinë e çmimeve te miratuara për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2004-2016.



Grafiku 71: Ecuria e çmimeve për HEC-et private

Pavarësisht faktit që të ardhurat nga shitja e energjisë nga hidrocentralet e vegjël për vitin 2015 nuk patën rritje, duhet theksuar fakti se ato përbejnë/mbeten një kosto e konsiderueshme për KESH sh.a. që kishte detyrimin për blerjen e energjisë nga kjo kategori prodhuesish.


Grafiku në vijim paraqet strukturën e miratuar të kostove të KESH sh.a. në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë për vitin 2015.




Grafiku 72: Struktura e miratuar e kostove të KESH sh.a. si F.P.Sh. për vitin 2015 (Burimi i te dhënave ERE)

Kategoria e konsumatoreve	Çmimi i miratuar (Leke/kWh)		Çmimi i realizuar (Leke/kWh)	
	Aktive	Ne Pik	Aktive	Ne Pik
Konsumatore ne 35 kV	9.50	10.93	9.40	10.84
Furra buke dhe prodhim mielli ne 20/10/6 kV	7.10	8.17	7.10	8.17
Konsumatore ne 20/10/6 kV	11.00	12.65	10.53	12.32
Furra buke dhe prodhim mielli ne 20/10/6 kV Matja ne TU	7.60	8.74	7.60	8.74
Konsumatore ne 20/10/6 kV Matja ne TU	14.00	16.10	13.94	16.10
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0.4 kV	7.60	8.74	7.58	8.74
Konsumatore ne 0.4 kV	14.00	16.10	13.84	15.97
Familjare	9.50		9.52	
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambientet e perbashketa (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.50		9.37	
Cmimi mesatar	10.7		11.22	

Tabela 73: Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015 (Burimi: OSHEE sh.a., ERE)




Grafiku 74: Struktura e çmimit mesatar të shitjes me pakicë e miratuar nga ERE 2015




Grafiku 75: Struktura e realizuar e çmimit mesatar të shitjes me pakicë për 2015

Në grafikun e figurës në vijim është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-2015:



Grafiku 76: Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2015

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe jo familjarë




Grafiku 77: Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE)


3.1.3 Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2015

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore.

Në grafikun e figurës 7-7 janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët jo familjarë, për vendet e ERRA-s, në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjare për vendet e rajonit është 11.69 lekë/kWh.



Grafiku 78: Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit (Burimi: ERA)



Grafiku 79: Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit (Burimi: ERA)

Në grafikun e Figurës 7-8 janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, për të gjitha vendet e ERRA-s në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 10.91 lekë/kWh.

3.2 Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar, ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2015 dhe proceset gjyqesore të ndjekura nga ERE

Një pjesë e veprimtarisë së ERE-s është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike. Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” gjatë vitit 2015 janë filluar procedurat për miratimin e akteve rregulatore në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me mjaft rëndësi .

ERE vlerëson me mjaft rëndësi plotësimin e këtij ligji me aktet e tjera nënligjore një pjesë e konsiderueshme të cilave është përgjegjësi e ERE dhe duhet të miratohen brenda afateve të përcaktuara në ligj (kryesisht brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit) të cilat do të plotësonin kështu kuadrin rregullator si një element kyç për funksionimin e sektorit të energjisë elektrike, duke patur parasysh që plotësimi i ligjit për sektorin e energjisë elektrike me kuadrin rregullator të parashikuar në ligj janë bazë për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet pjesëtarëve të tregut që ushtrojnë veprimtari në këtë sektor, duke mundësuar krijimin e një tregu konkurrues, eficient që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend me qëllimin final integrimin e tij në tregun rajonal.

Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore nga ana e ERE-s, është bërë në çdo rast duke marrë parasysh; së pari tu krijojë palëve të treta mundësi njohje me përmbajtjen e dokumenteve, mundësinë për dëgjimin e palëve të interesuara nëpërmjet dërgimit të opinioneve apo komenteve të ndryshme apo edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentet në proces përpunimi nga ERE, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen e elektronike të ERE-s. Nëpërmjet këtij procesi ERE ka synuar marrjen e komenteve dhe njohjen me këndvështrimin e palëve të treta për rregullimin e tregut të energjisë elektrike përmes akteve nënligjore që ERE miraton. Po ashtu edhe finalizimi i procesit garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun.

Në çdo rast para miratimit të akteve nënligjore rregulatore ERE ka kërkuar opinionin e institucioneve brenda dhe jashtë vendit të tilla si Ministria e Energjisë

dhe Industrisë, Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Vjene, USAID etj.

Gjatë vitit 2015, ERE shënon 31 vendimmarrje në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin e ri “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nr. 43/2015. Dy prej tyre janë finalizuar me miratimin e Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror dhe Rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Pesë prej tyre kanë qenë vendimmarrje në lidhje me miratimin e marrëveshjeve të shit-blerjes së energjisë elektrike, shërbimeve ndihmëse dhe balancimit, shërbimin e transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike ndërmjet : KESH sh.a/FPSH, OST sh.a dhe OSHEE sh.a./FPP.

Në proces shqyrtimi nga ERE, por edhe në pritje apo përpunim të komenteve nga palët e interesuara apo edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Vjene , janë 14 aktet rregullatore si më poshtë për të cilat kanë filluar procedurat për hartimin gjatë vitit 2015:

- Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, rinovimit dhe heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike.
- Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s.
- Licenca e prodhimit të energjisë elektrike.
- Licenca e tregtimit të energjisë elektrike.
- Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit të energjisë elektrike.
- Rregullorja e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. të shoqëritë e licencuara për tregtimin e energjisë elektrike.
- Rregullorja për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre.
- Licenca për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Licenca për veprimtarinë e operatorit të tregut të energjisë elektrike.
- Licenca për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit.

- Kodi i Rrjetit të Transmetimit.
- Rregullorja e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të transmetimit.
- Rregullat e menaxhimit të kapacitetit ndërkufitar.

Ndër vendimmarrjet më të shpeshta të ERE-s gjatë këtij viti kanë qenë edhe ato në lidhje me ndryshimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike për çështje që kanë lidhje me disbalancat e energjisë elektrike si dhe vendimmarrjet në lidhje me miratimin e Rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) versioni 1.2 dhe 1.3.

3.3 Proceset gjyqësore në të cilat ERE ka qenë palë gjatë vitit 2016

3.3.1 ERE ne cilesine e pales se trete

ERE është thërritur në cilësinë e personit të tretë si palë me të cilin palët paditëse kanë të përbashkët çështjen që kanë paraqitur në gjykatë. Janë 15 proceset gjyqësore në të cilat ERE është thërritur për të ndihmuar palët ndërgjyqëse dhe gjykatën në zgjidhjen e konflikteve të cilat në të gjitha rastet janë shqyrtuar më herët administrativisht pranë sektorit për mbrojtjen e konsumatorit në ERE. Kjo konform Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i cili në nenet 2, gërma “ç” i cili përcakton se: “objektivi i ligjit nder te tjera është dhe rregullimi veprimtarisë në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike”, dhe neni 18, pika 1, gërma “e”; përcakton se “garantimi i standardeve në përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe siguri i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave, lidhur me ndryshimin e furnizuesit “neni 24, “ zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Këto procese janë iniciuar përgjatë viteve 2014-2015 dhe një pjesë e tyre kanë përfunduar gjykimin në Gjykatën e shkallës së parë, duke u pranuar padia e Palës paditëse, konsumator i energjisë elektrike. Eshtë për t'u theksuar se ERE në të gjitha rastet, përgjatë shqyrtimit të këtyre proceseve gjyqësore, është kujdesur të prioritarizojë interesin e konsumatorëve, duke i asistuar ata në mbrojtjen e të drejtave përpara gjykatave kompetente. Nga ana tjetër, ERE, është kujdesur që mbrojtja e

interesit te konsumatoreve te mos bjere ndesh me ligjislacionin ne fuqi, por as te cenoje interesat e te licencuarve, pale e paditur ne keto procese. Theksojme se nder 15 proceset gjyqesore te shqyrtuara nga Gjykata pergjate vitit 2015 , OSHEE sh.a. ka qene pala e paditur dhe e goditur gjyqesisht per shqyrtimin e zbatueshmerise se legjislacionit ne fuqi.

3.3.2 ERE pale e paditur

ERE është palë e paditur në 11 procese gjyqësore. Sjellim në vëmendje se në 6 prej tyre, ERE është e paditur nga ish CEZ Shpërndarje në lidhje me vendimmarrje të saj të cilat datojnë në vitet 2010-2011, e për rrjedhojë vetë objekti i kërkimit i cili tashmë pretendohet nga pala zëvendësuese paditëse OSHEE sh.a., ka humbur aktualitetin. Bëhet fjalë për vendimmarrjet e ERE në lidhje me klauzola të Kontratave e furnizimit për klientët familjarë në vitet 2011-2012, apo marrëveshje të subjekteve të licencuara OSHEE-OST, etj., të cilat pikërisht për shkak të vendimmarrjeve të reja, zëvendësuese, të pa goditura gjyqesisht me tej, në vitet në vijim, kanë humbur aktualitetin. Shpallja nul e këtyre vendimmarrjeve nuk prodhon asnjë efekt mbi palët, pikërisht për shkaqet sipërcituara. Të gjashta këto gjykime, kanë përfunduar shqyrtimin e tyre ne gjykatën e shkallës së pare, e disa prej tyre edhe në gjykatën e apelit, pas rrëzimit të padive nga gjykatat kompetente.

Janë 4 procese gjyqësore të tjera të cilat janë ngritur e shqyrtuar ne gjykatat kompetente, 2 prej tyre në gjykatën Administrative te Apelit, me të njëjtin objekt të padisë, kundërshtimin e vendimeve nr. 143 dhe nr. 144, datë 26.12.2014 të ERE. Gjykata e Apelit administrativ është shprehur me vendim të formës së prerë të kolegjit të kësaj Gjykate, duke Rrezuar paditë me këtë objekt. Për rrjedhojë, pavarësisht rekursit në Gjykatën e lartë, këto vendime të kolegjit të gjykatës së apelit administrative, janë përfundimtare, e shtrijnë efektin e tyre, mbi çdo proces aktual apo të ardhshëm me të njëjtin objekt gjykimi, e palë ndërgjyqëse. Gjithashtu edhe dy proceset e tjera gjyqesore te ngritura nga pala e paditur te licencuarit per prodhimin e energjise elektrike, Albanian Green Energy sh.p.k. dhe Balkan Green Energy sh.p.k. per kundërshtimin e vendimit nr. 143 datë 26.12.2014 , kane perfunduar duke u rrezuar padite paleve, e duke legjitimuar kesisoj edhe nje here perputhshmerine me legjislacionin ne fuqi te vendimmarrjeve te ERE.

1. Procesi gjyqësor në Gjykatën Admin. e Apelit, çështja nr.36 **Shoqëria “C & S Construction” & AREA vs ERE** me objekt: Shfuqizimin pjesërisht te vendimit nr.144, dt.26.12.2014 te ERE

2. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 31005-03032-86-2015 me palë paditëse **OSHEE sh.a**, e paditur ERE dhe palë e tretë KESH sh.a, Avokatura e Shtetit, me objekt padie Deklarimin e pavlefshmërisë dhe anulimin e pjesshëm të vendimit nr. 134 date 17.09.2012”
3. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 10382, me palë paditëse **CEZ Shpërndarje sh.a**, të paditur ERE dhe me objekt padie: Anulim vendimi nr. 128 date 11/09/2012. Për procedimin administrativ të vendosjes së gjobës së CEZ Shpërndarje sh.a.
4. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 5496, me palë paditëse **CEZ Shpërndarje sh.a**, të paditur ERE dhe pale e trete Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, Certified Solution Corporator sh.p.k ose CSC sh.p.k dhe me objekt : Pavlefshmëri vendimi nr. 62 date 22.07.2011 nr. 73 datë 09.08.2011. Kontrata e verifikimit të shërbimit të matësave.
5. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 5472, me palë paditëse **CEZ Shpërndarje sh.a** dhe të paditur ERE me objekt: Pavlefshmëri dhe anulim i pjesshëm vendimi nr. 110 date 21.10.2011. Rregullat e cilësisë së shërbimit, shpërndarjes dhe shitjes së energjisë
6. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 10625, me palë të paditur **CEZ Shpërndarje sh.a** të paditur **ERE** dhe palë të tretë OST dhe me objekt: Anulim vendimi nr. 102 date 19/07/2012. Marrëveshja e transmetimit OST – CEZ.
7. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 31103-03033-86-2015, me palë paditëse **OSHEE sh.a**, të paditur ERE dhe palë e tretë KESH sh.a
8. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 6305 me palë paditëse **Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a**, të paditur ERE dhe objekt padie: Pavlefshmëri vendimi nr. 1 date 10.01.2013. Për miratimin e rregullores për emërimin e administratorit të CEZ Shpërndarje sh.a
9. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative Tiranë për çështjen me nr. 7413 me palë paditëse **shoqëria GEN-I sh.p.k**, të paditur ERE dhe pale e trete: CEZ Shpërndarje sha me objekt padie: Anulim vendimi nr. 78 date 22/10/2010 detyrim pagim demi.
10. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, me palë paditëse **Albanian Green Energy** dhe të paditur ERE dhe KESH sh.a, me Objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. 143 dt. 26.12.2014 të ERE
11. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, me nr. 31103-03503-86-2015 Akti, me palë paditëse **Ballkan Green Energy** dhe të paditur ERE

dhe KESH sh.a, me Objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë së vendimit me nr. 144 dt. 26.12.2014 te ERE

12. Procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse **Grigor Zoraqi** dhe palë të paditur ERE etj.

3.4 Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i atribuon Entit Rregullator të Energjisë përgjegjësinë në drejtim të zbatimit të masave me efektive për garantimin e mbrojtësive të klientëve të energjisë elektrike, për të pasur tarifa dhe cmime që reflektojnë kostot e drejta dhe të argumentuara për njëshërbim furnizimit të energjisë elektrike të pandërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së furnizimit. Organizimi i veprimtarisë së ERE-s, është i orientuar nder të tjera dhe në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe klientëve të energjisë elektrike konform nenit 24 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” gjithashtu dhe ndërmjet të licencuarve dhe klientëve të gazit natyror, sipas nenit 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Gazin Natyror”. Roli i ERE-s në veprimtarinë e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë vitit 2015 kryesisht ka konsistuar në monitorimin e zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të tilla si: Ligji Nr. 9072, date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (i shfuqizuar tashme); Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Kontratave të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jo familjarë (etj.).

Vlen të theksojmë faktin se Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në nenet 108 dhe 110 të tij, për aktet nënligjore dhe dispozitat kalimtare përcakton se: aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë në sektorin e energjisë të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 43/2015, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me afate dhe kërkesat e vendosura nga ligj.

Në ushtrim të funksioneve dhe detyrave të tij, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit ka administruar të dhënat lidhur me ankesat e klientëve të paraqitura në ERE, gjatë vitit 2015 dhe ka evidentuar se ky numër është i konsiderueshëm, rreth 58% më i madh se në vitin 2014. E shprehur kjo në shifra, gjatë vitit 2014 janë paraqitur dhe trajtuar 2225 ankesa, ndërsa për vitin 2015 janë paraqitur dhe trajtuar 3519 ankesa. Përveç ankesave të paraqitura, ERE në zbatim të përgjegjësisë dhe objektivave të saj ka ofruar asistencë dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve

dhe konsultime verbale dhe me e-mail e telefon për të gjithë klientët e energjisë elektrike. Ndërgjegjësimi i klientëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike ka rritur ndjeshëm numrin e ankesave të trajtuara nga ERE.

Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar kryesisht në shkeljen e dy akteve nënligjore të tilla si: “Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë” të miratuar me Vendimin ERE-s me Nr. 108 dhe “Kushtet e përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Jo Familjarë të miratuar me vendimin e ERE-s Nr. 109, date 21.10.2011, në të cilat përcaktojnë detyrimet reciproke të palëve në kontrate. ERE në reference të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i shfuqizuar tashme, Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe mbështetur në aktet nënligjore, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia dërguar shoqërisë “OSHEE” sh.a. së bashku me udhëzimet përkatëse.


Figura 80: Tabela për ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2015

OBJEKTI ⇒	ENERGJI E PAMATUR	DEM EKONOMIK	FATURIM AFORFE	MBIFATURIM	KEQFATURIM	FATURIM FIKTIV	KONTRATE FIKTIVE	MOSKREDITIM PAGESASH	MUKT	KERKESË PER LIDHJE TE RE	NDRYSHIM TARIFIMI	TE NDRYSHIME	TOTALI
MUJ													
JANAR	143	30	58	109	8	24	10	19	25	5	5	11	447
SHKURT	336	44	184	329	22	63	32	33	54	2	5	11	1115
MARS	225	42	117	167	20	35	27	9	40	6	10	9	707
PRILL	77	11	30	61	7	18	11	3	16	3	3	4	244
MAJ	106	13	23	41	1	12	9	4	18	3	10	8	248
QERSHOR	50	1	14	32	0	7	2	3	16	1	2	5	133
KORRIK	41	2	12	15	1	5	2	1	9	2	3	6	99
GUSHT	39	7	10	26	0	3	8	6	18	3	1	3	124
SHTATOR	38	4	10	22	1	1	5	0	4	0	2	9	96
TETOR	35	9	15	45	0	4	8	1	6	2	4	7	136
NETOR	36	9	11	12	2	3	6	1	8	1	0	1	90
DHJETOR	35	2	5	16	1	2	6	5	1	4	0	3	80
Σ	1161	174	489	875	63	177	126	85	215	32	45	77	3519
												TOTALI =	3519

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2015 janë trajtuar nga ERE, në total rreth 3519 ankesa. Nga të dhënat e administruara nga Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit vihet re se ankesat me objekt “energjinë e pamatur” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “mbi faturimin” dhe “faturimin aforfe”.

Si më sipër paraqitur konstatohen rreth 1161 ankesa për “energji të pamatur”; rreth 875 ankesa për “mbi faturim” dhe 489 për “faturim aforfe” të energjisë elektrike.

Figura 81: Grafiku për ankesat e trajtuara nga ERE gjate vitit 2015



3.4.1 Ankesat për “Energji te pamatur“

Nga analiza e treguesve statistikore konstatohet se spektrin me te madhe te ankesave e zënë ankesat për “energji te pamatur“ ne masën 1161 ankesa ose 33% e totalit. Vihet re se ne këto ankesa përfshijnë faturime nen emërtimin “energji e pamatur“ përgjatëperiudhës se viteve 2011-2012. Këto faturime kane ardhur si pasoje e kontrolleve te ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatëperiudhës se lartpërmendur, ku vihet re se procesverbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve te paautorizuara ne sistemin e matjes janë kryer jo ne prezencën e klientit, si dhe ne bokse kolektive te matësave te energjisë elektrike. Gjate kësaj periudhe është konstatuar dhe fenomeni i dublimit apo triplikimit te faturimit nen emërtimin “energji e pamatur“, pra për te njëjtin procesverbal është lëshuar me shume se një fature qe përmban “energji te pamatur“.

Pavarësisht trajtimit te një pjese te konsiderueshme te këtyre faturimeve nga shoqëria “OSHEE“ sh.a. vijon te ketë ende ankesa te pazgjidhura lidhur me këtë problematike.

Vlen te theksohet se gjate vitit 2015, shoqëria “OSHEE“ sh.a., ne zbatim te Vendimit Nr. 90 te Bordit te ERE-s, date 15.11.2010 “Mbi Dënimin me gjobe te Cez-Shperndarje sh.a për shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj te vendimeve te ERE-se”, i cili ne piken 2 te tij përcakton se: “Te gjitha faturimet e kryera nga ana e CEZ Shpërndarje Sh.a. ndaj klientëve familjare dhe jo familjare, me emërtimin “Dem Ekonomik” apo “Energji e Pamatur” pas hyrjes ne fuqi te Ligjit

Nr. 9997, date 22.09.2008, janë te paligjshme”, anuloi rreth 51 000 faturime në emërtimin “dem ekonomik” dhe “energji e pamatur” të bëra gjatë periudhës Tetor 2008 –Prill 2011. Ky informacion ka rezultuar nga monitorimi i kompanisë “OSHEE” sh.a.

Me zbatimin e vendimit të lartpërmendurështetë konstatuar, gjatë trajtimit të ankesave nga ERE, dhe një fenomen tjetër mjaft problematik. Kështu janë evidentuar shumë procesverbale të cilat datojnë para periudhës Prill 2011 dhe hedhja e tyre në sistemin e faturimit është bërë pas muajit Prill 2011, duke i shmangur këto faturime nga përcaktimi i bërë në Vendimin Nr. 90, date 15.11.2010 të Bordit të ERE-s. Në të gjitha rastet ERE ka kërkuar trajtimin e këtyre ankesave mbështetur në procesverbalin e mbajtur, për konstatimin e “Energjisë së pamatur” apo “Dëmit Ekonomik”.

3.4.2 Ankesat për “keq faturim” të energjisë elektrike.

Me strukturën e re të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike gjatë vitit 2015, duke hequr sistemin tarifor me dy blloqe konsumi dhe implementuar njëçmim unik të energjisë elektrike për klientët familjare, janë reduktuar në mënyrë drastike ankesat lidhur me keq faturimin e energjisë elektrike. Këto ankesa në vitet e mëparshme lindnin si rezultat i mos përfitimit të tarifave të miratuar nga ERE (përkatësisht për fashat 300 kWh dhe mbi 300kWh) për klientët familjare e furnizimit me energji elektrike. Gjatë këtij viti, ankesat e paraqitura në ERE me objekt keq faturimin e energjisë elektrike që ka rezultuar nga vitet e 2011-2014, zënë 1% të totalit të ankesave.

3.4.3 Ankesat përmbi faturimin e energjisë elektrike

Mbi faturimi i energjisë elektrike vazhdon të gjeneroj ankesa. Këto ankesa vijnë kryesisht për shkak të mosrespektimit të nenit 7 të “Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jo familjare” Ndeshen raste kur leximi i matësit nuk përkon me hedhjen në sistem të faturimit të energjisë elektrike.

Ankesat e regjistruara në ERE me objekt “mbi faturimin” e energjisë elektrike për vitin 2015 janë 875 ankesa, ose rreth 25% e totalit të ankesave. Këto ankesa që janë shkaktuar edhe nga problematika të ndryshme si: mosrakordimi i gjendjes së hedhur në sistem me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësive të rinj në sistem. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga “OSHEE” sh.a, verifikimin e praktikave dhe procedurave lidhur me faturimet e kryera së bashku me korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara për trajtimin e ankesave. Janë evidentuar gjithashtu raste kur pas mbi faturimit të këtyre klientëve, nga ana e shoqërisë nuk është lëshuar fature

korrektive, por klienti është faturuar me konsum 0 kWh për muajt në vazhdim dhe është emetuar nga kompania “OSHEE”sh.a, tarife shërbimi.

3.4.4 Ankesat për “faturim aforfe”.

Ankesat e paraqitura në ERE me objekt “faturimin aforfe “te energjisë elektrike kanë zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm edhe gjatë vitit 2015. Janë paraqitur dhe trajtuar rreth 498 raste ose 14% e totalit të ankesave, shifër kjo e madhe në krahasim me vitin 2014, kur ankesat me objekt “faturim aforfe” ishin rreth 259. Problematike vazhdojnë të mbeten faturimet aforfe të energjisë elektrike për periudhën Janar 2007 – Prill 2010, lidhur me sasinë e energjisë elektrike të faturuar aforfe të përcaktuara në Vendimet e Bordit të ERE-s si dhe me afatin final të aplikimit të këtij faturimi bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.104, datë 22.12.2009 “Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për klientët familjare pa matës të energjisë elektrike”. Janë konstatuar ankesa nga klientët e furnizimit me energji elektrike, lidhur me faturimin aforfe për periudhën Janar 2014 e në vazhdim. Ka patur ankesa nga klientë, të cilët edhe pse kanë qenë të pajisur me matës të energjisë elektrike, përsëri janë faturuar aforfe në kundërshtim me Vendimin e Bordit të ERE –s Nr. 146, datë 24.12.2013 ”Mbi kërkesën e kompanisë “Cez-Shpërndarje” sha, në administrim të përkohshëm, për vendosjen e faturimit aforfe”. Gjithashtu përklientët familjare me matës të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik, për të cilët Vendimi Nr. 146, datë 24.12.2013 i Bordit të ERE-s, pika 2 e tij, përcakton qarte që “për konsumatorët me matës të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik faturimi aforfe sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi aplikohet përnjë periudhe jo më shumë se 2 (dy) muaj”.

Gjatë vitit 2015 janë vendosur gjithashtu faturime aforfe mbi sasinë e energjisë elektrike të përcaktuara nga ERE dhe në tejkalim të afatit të përcaktuar në Vendimin e ERE-s Nr. 146, datë 24.12.2013.

Referuar ankesave të paraqitura, është vënë re se gjatë vitit 2015 kemi patur faturim aforfe të energjisë elektrike përklientët familjare dhe jo familjare. Ky faturim konsiston në mos respektim të afatit dhe gjithashtu të vlerave të konsumit të energjisë elektrike të përcaktuara në Vendimin e ERE-s Nr. 146, datë 24.12.2013.

3.4.5 Ankesat për “ndryshim në tarifimin e çmimit” të energjisë elektrike.

Mbas miratimit të çmimit të energjisë elektrike me Vendimin e Bordit të ERE-s me Nr. 148, datë 26.12.2014, janë administruar gjatë vitit 2015, një sere ankesash, rreth 45, lidhur me konsumatorë, të cilët ankohen se në faturat e muajit shkurt e në vijim janë tarifuar me çmimin 14 leke/kWh, që u korrespondon klientëve jo-familjare në 0.4 kV, ndërkohë që çmimi për konsumatorët në 35 kV dhe 20/10/6

kV sipas Vendimit Nr. 148 date 26.12.2014 te ERE-s është përkatësisht 9.5 leke/kWh dhe 11 leke/kWh. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe për faturimin e konsumit të energjisë në pik.

Për të sqaruar këtë problem ERE, në mbështetje të nenit 31 pikat 1 dhe 2 dhe nenit 32 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të saj, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 21, datë 18.03.2009 i ndryshuar, organizoi dy seanca dëgjimore.

Nga prezantimi i problemit nga ana e secilit konsumator të pranishëm në këto seanca u konstatua që të gjithë konsumatorët kanë të përbashkët faktin që janë të lidhur në TM ndërkohë që pika e matjes është pas transformimit pra në TU.

ERE për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare problematikave të herë pas herëshme në lidhje me këtë çështje, njohu kompaninë "OSHEE" sh.a me interpretimin dhe qëndrimin e saj, duke i kërkuar kompanisë:

- Të aplikohen tarifat përkatëse për grupin e konsumatorëve të lidhur në TM në zbatim të Vendimit të ERE-s Nr. 148, date 26.12.2014
- Të kryhen nga OSHEE sh.a, kompensimet në faturat e muajve të ardhshëm për vlerën e shtuar që rezulton nga aplikimi i tarifave të TU në faturat e muajit shkurt e në vazhdim.
- Në lidhje me grupin e konsumatorëve të cilat janë të lidhur në kabina nga të cilat furnizohen dhe klientë të tjerë, kanë konsum të ulët dhe nuk kanë mundësi të s'potojnë sistemin e matjes sepse nuk plotësojnë kushtet teknike, të vazhdohet të faturohen me çmimin në TU.

Vlen të përmendim faktin se klientë të ndryshëm të furnizimit me energji elektrike, në kushtet kur shoqëria "OSHEE" sh.a, nuk i ka zbatuar rekomandimet dhe udhëzimet e ERE-s të shprehura në shkresën Nr.508 Prot, date 14.07.2015, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor-Tirane, për zgjidhjen e çështjes në rrugë gjyqësore. ERE është përfshirë në këto procese gjyqësore me cilësinë e personit të trete.

3.4.6 Ankesat për "ndërprerjen" e energjisë elektrike.

Njoftimi i klientëve të energjisë elektrike lidhur me debinë e tyre ndaj shoqërisë "OSHEE" sh.a, bëhet me ane të faturës mujore të energjisë elektrike. Problematike lidhur me ndërprerjet e energjisë elektrike gjatë vitit 2015 nga ana e shoqërisë "OSHEE" sh.a, ka konsistuar kryesisht tek klientët që kanë qene në proces ankimi për fatura të ndryshme të energjisë elektrike dhe janë përballur me

ndërprerjen e energjisë elektrike pa patur njëpërgjigje nga ana e “OSHEE“-se, dhe pa përfunduar procedura ankimore.

3.4.7 Ankesa për “kolaudimin e matësive” të energjisë elektrike.

Kërkesat e paraqitura pranë ERE-s, nga ana e klientëve të furnizimit me energji elektrike, lidhur me kolaudimin e matësive të energjisë elektrike për vitin 2015 kanë qenë minimale. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka plotësuar kryesisht kërkesat e klientëve për testimin e saktësisë së matësive të energjisë elektrike, duke i përcjellë këto kërkesa pranë subjekteve të autorizuar për verifikimin e matësive të energjisë elektrike, nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM). Enti Rregullator i Energjisë, për të gjitha kërkesat e paraqitura, i ka kërkuar “OSHEE“-se, trajtimin e këtyre kërkesave konform procedurave përkatëse.

3.4.8 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.

Ankesat e paraqitura pranë ERE-s lidhur me këtë problematikë kanë qenë rreth 215 ose 6% e totalit. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësive të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre. Faturimi i tyre është bërë bazuar në procesverbalet e mbajtur nga ana e shoqërive të autorizuar për verifikimin e saktësisë së matësive të energjisë elektrike ashtu siç përcaktohet në pikën IV.9 të Kodit të Matjes. Megjithatë, duhet vënë në dukje se mos zëvendësimi i këtyre matësive në afat ka sjellë ngarkimin e konsumatorëve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, në kundërshtim me Kontratën për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jo familjarë, nëni 8, pika 2, ku përcaktohet se “nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësive të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero”.

3.4.9 Ankesat mbi “kontratat fiktive” dhe “faturimin fiktiv”.

Gjate vitit 2015 janë konstatuar 126 ankesa lidhur me kontratat fiktive dhe 177 ankesa për faturim fiktiv nga ana e shoqërisë “OSHEE“ sh.a. Këto ankesa lidhen kryesisht me kontratat e furnizimit me energji elektrike të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, me kontratat të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve, kontratat provizore të hapura gjate viteve të mëparshme, faturime fiktive për kontratat të cilat janë të shkëputura nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike ose për objekte të cilat nuk ekzistojnë më. Duhet përmendur se problemet kryesore lidhur me kontratat dhe faturimin fiktiv vijnë nga zonat me ndërtime informale, objektet e të cilave kanë qenë ose janë në proces legalizimi nga ana e ALUIZNI-t. Gjate vitit 2015, nga ana e shoqërisë “OSHEE“ sh.a, është dërmarrë një proces lidhur me kalimin e 100 mijë kontratave provizore të furnizimit me energji elektrike

ne kontrata definitive. Prej 100 mijë kontratave provizore, 87 mijë i përkasin klientëve familjare dhe 13 mijë atyre jo familjarë.

3.4.10 Ankesat për “lidhje të re të kontratës së energjisë elektrike”.

Te drejtënpër te patur një kontratë të furnizimit me energji elektrike e ka çdo subjekti cili nuk është debitor ndaj Furnizuesit, dhe që ka një pikë lidhje të miratuar me rrjetin e shpërndarjes të energjisë elektrike. Kjo sipas përcaktimeve të bëra në “Rregulloren për Lidhjet e Reja”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 22, datë 25.02.2012. Kërkesapër lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike, siçpërcaktohet në legjislacionin në fuqi, jo në të gjitha rastet ka gjetur zbatim nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a. Shpeshherë “OSHEE” sh.a. ka refuzuar kërkesën e aplikuesit për lidhje të re, të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike, duke e lidhur kontratën e furnizimit me energji elektrike me objektin, të cilin furnizon me energji elektrike dhe jo me subjektin siçpërcaktohet në nenin 4 të “Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike përKlientët Familjare dhe Jo familjare” miratuar me Vendimet Nr. 108 dhe 109, datë 21.10.2011 të Bordit të ERE-s si dhe në “Rregulloren e Lidhjeve të Reja”. Të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 22, datë 25.02.2012

Gjate vitit 2015, në ERE janë paraqitur dhe trajtuar rreth 32 ankesa për refuzimin e lidhjes së re të kontratës, që aplikuesve u është bërë nga shoqëria “OSHEE” sh.a, me argumentimin se objekti për të cilënkërkohet të lidhet kontrata është debitor. Nga ana e vetë shoqërisë “OSHEE” sh.a. është pranuar reduktimi i zgjidhjeve të kërkesave që kanë të bëjnë me lidhjet e reja në masën 50 % krahasuar me vitet 2012-2014, fakt i rrjedhur nga mungesa e matësve të energjisë elektrike dhe materialeve të nevojshme për realizimin e tyre.

3.4.11 Ankesa mbi “mos kreditimin e pagesave” të faturave të energjisë elektrike.

Fenomeni i mos kreditimit të pagesave të faturave të energjisë elektrike të klientëve të furnizimit me energji elektrike vazhdon të konstatohet dhe gjate vitit 2015, në të cilin janë paraqitur 85 ankesa pranë ERE-s. Objekti i këtyre ankesave lidhet me mos kreditimin e pagesave për faturat e viteve të mëparshme, ku kanë rezultuar problematike pagesat e kryera si në arkat e shoqërisë “OSHEE” sh.a dhe në ato të kryera në poste apo banke. Klientët e energjisë elektrike, megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e faturave të energjisë elektrike, rezultojnë debitorë dhe ndëshkohen me ndërprerjen e padrejtë të furnizimit me energji elektrike. Procedura e ndjekur për këta klientë, ka qenë verifikimi librezës së energjisë elektrike, ekstrakteve të nxjerra nga posta dhe mandateve të arkëtimit të bankave, skanimin

ose fotokopjimin e tyre dhe përcjelljen e tyre pranë OSHEE-se, për të marrë masat e nevojshme për kreditimin e pagesave.

3.4.12 Trajtimi i ankesave të ardhura nga ERE, Avokati i Popullit, Kryeministria, MEI dhe Zyrat Qendrore nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a.

Sikurse vihet re dhe nga tabela Nr. 1, numri total i ankesave të ardhura nga ERE sipas kompanisë “OSHEE” sh.a, është e trajtuara sipas objekteve të veçantë të ankimit (një klient mund të ketë me shumë se një objekt ankese).

Nga monitorimet e bërapranëshoqërisë “OSHEE” sh.a. për ankesat e zgjidhura gjatë vitit 2015, janë marrë këto të dhëna:

Figura 82: Ankesat e paraqitura gjatë 2015

INSTITUCIONI	AVOKATI I POPULLIT	ERE	HO (OSHEE)	KRYEMINISTRIA	MEI
OBJEKTI I ANKESËS					
Faturim Afrofe	19	78	3	0	0
Mbifaturim	30	110	9	1	0
Faturim Dem Ekonomik	24	1,568	633	66	37
Faturim me Kryqezim Matesi	1	7	25	0	2
Faturim 2 kontrata	4	166	107	11	17
Faturim - ceshtje të tjera	3	23	0	0	0
Faturim - Te tjera	92	1,901	1124	119	116
Pezullim, Mbyllje, Saktësim Kontrate	3	9	117	1	3
Ndryshim mbajtësi Kontrate	1	8	215	2	5
Kreditim Kanale pagese	0	5	0	0	0
Kreditim të tjera	3	20	9	3	3
Faturim aplikim tarifimi	6	31	157	3	4
TOTALI	186	3,926	2399	206	187
TOTALI I ANKESAVE					6904

Ne tabelën Nr. 85 janë paraqitur ankesat e administruara nga shoqëria “OSHEE” sh.a, nga të gjitha burimet e ankimit të lartpërmendura. Sikurse evidentohet ankesat e administruara nga OSHEE sh.a, janë në bazë të objektit të ankimit, (rreth 3926) ndërkohë që ERE i administron këto të dhëna duke mbajtur në konsideratë numrin e subjekteve ankimes (rreth 3519 ankimes).

Problematika kryesore lidhur me ankesat e dërguara nga ERE për verifikim dhe trajtim shoqërisë “OSHEE” sh.a, mbetet mos respektimi i afateve për trajtimin

e ankesave siç përcaktohet në “Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjare dhe Jo familjare” dhe “Rregulloren e trajtimit të ankesave”.

Tabela 83: Ankesat e zgjidhura gjatë vitit 2015

INSTITUCIONI	AVOKATI I POPULLIT	ERE	HO (OSHEE)	KRYEMINISTRIA	MEI
OBJEKTI I ANKESËS					
Faturim Afrofe	19	21	3	0	0
Mbifaturim	29	24	9	1	0
Faturim Dem Ekonomik	23	1,136	633	58	33
Faturim me Kryqezim Matesi	1	5	25	0	2
Faturim 2 kontrata	3	109	107	9	15
Faturim - ceshtje të tjera	3	-	0	0	0
Faturim - Te tjera	87	1,584	1124	96	95
Pezullim, Mbyllje, Saktësim Kontrate	3	8	117	1	3
Ndryshim mbajtësi Kontrate	1	8	215	2	5
Kreditim Kanale pagese	0	2	0	0	0
Kreditim të tjera	2	20	9	3	3
Faturim aplikim tarifimi	6	25	157	3	4
TOTALI	177	2,942	2399	173	160
TOTALI I ANKESAVE					5851

Ne tabelën 86, jepen ankesat e zgjidhura nga kompania “OSHEE”sh.a, ku gjatë vitit 2015 janë arkivuar rreth 6904 ankesa të klientëve të energjisë elektrike dhe janë zgjidhur prej saj rreth 5851 ankesa. Pra për vitin 2015 “OSHEE”sh.a, ka zgjidhur rreth 84.7% të ankesave të administruar nga të gjitha burimet e ankimit të lartpërmendura. Megjithatë konstatohet se megjithëse është dhënë zgjidhje ankesave në tejkallim të afatave të përcaktuara në “Rregulloren e trajtimit të ankesave”.

Nga informacioni i kompanisë rezulton se nga 3926 ankesat të ERE-s janë zgjidhur rreth 2942 ankesa ose 75% e tyre.

3.4.13 Ankesat e paraqitura në OSHEE gjatë vitit 2015

Kërkesë/ankesat depozituara në qendrat e Kujdesit Ndaj Klientit nga ana e klientëve të energjisë elektrike përbejnë burimin kryesor të ankesave të paraqitura në OSHEE. Tipologjia e tyre kategorizohet dhe ndahet në kërkesë/ankesa që lidhen me aktivitetin e furnizimit me energji elektrike, me aktivitetin e shpërndarjes, me të drejtën e informimit dhe me cilësinë e shërbimit. Gjatë vitit 2015 në zyrat e Kujdesit Ndaj Klientit (KNK)te tegjithë rajoneve janë depozituar rreth 121 mijë kërkesa/ankesa për faturimin e energjisë elektrike dhe 63 mijë për probleme teknik

përnjë total prej 184 mijë kërkesë/ankesave. Ne total numri i klientëve të furnizuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a është rreth 1.2 milion, nga të cilët rreth 1.04 milion janë familjar, 153 mijë privat dhe 11 mijë bëjnë pjesë në kategoritë buxhetore dhe jo-buxhetore.

Figura 84: Kërkesë/ankesat e depozituara në OSHEE lidhur me faturimin e energjisë elektrike përgjatë vitit 2015

VITI/PARAQ		RAJONI												Grand Total	
2015		BE	BU	DU	EL	FI	GJ	KR	KU	SH	TR	VL			
KOD 2	KOD 3	KOD 4	Kod											Grand Total	
F	Faturimi	F1	Faturim Afrore	58	255	771	142	49	87	67	20	245	788	109	2,591
		F2	Mbifaturim	541	309	1,599	510	343	360	458	51	269	2,050	445	6,935
		F3	Faturim Dën Ekonomik	98	2,067	988	78	86	51	14	419	508	1,808	123	6,240
		F4	Faturim në Kryeqendrën Matrit	3	17	134	11	14	2	3	9	19	199	78	489
		F5	Faturim 2 kështjela	17	22	187	28	25	45	13	6	29	743	155	1,270
		F6	Faturim - aplikim tarifim	465	53	427	720	282	121	502	14	177	767	80	3,608
		F7	Faturim - cështje të tjera	510	82	620	677	221	146	500	16	276	1,310	173	4,531
		F9	Faturim - Te tjera	827	1,093	2,908	1,824	702	712	994	271	760	7,328	1,220	18,639
F Total				2,519	3,898	7,634	3,990	1,722	1,524	2,551	806	2,283	14,993	2,383	44,303
B	Kreditimi	B1	Kreditim Kanale Paguesh	516	564	986	844	227	427	170	17	284	1,540	362	5,937
		B9	Kreditim Tjera	765	1,483	1,665	2,127	1,086	564	1,487	34	375	2,378	642	12,606
B Total				1,281	2,047	2,651	2,971	1,313	991	1,657	51	659	3,918	1,004	18,543
K	Ndryshime Kontrate	K1	Kontrata-Pezullim, Mbyllje, shtesim	1,420	1,821	4,341	2,325	1,302	2,213	2,383	196	2,693	7,677	2,124	28,495
		K2	Kontrata - Ndryshim në llogaritje Kontrate	2,042	1,424	4,692	2,507	1,297	1,420	2,235	150	2,218	9,122	1,895	29,002
		K5	Kontrata - Ndryshim në llogaritje Kontrate Kontrata Qeraj, Spjeguarje	8	6	128	15	9	38	41	2	24	540	1	812
K Total				3,470	3,251	9,161	4,847	2,608	3,671	4,659	348	4,935	17,339	4,020	58,309
Grand Total				7,270	9,196	19,446	11,808	5,643	6,186	8,867	1,205	7,877	36,250	7,407	121,155

Figura 85: Kërkesë/ankesat e zgjidhura nga OSHEE lidhur me faturimin e energjisë elektrike përgjatë vitit 2015

VITI/PARAQ		RAJONI												Grand Total	
2015		BE	BU	DU	EL	FI	GJ	KR	KU	SH	TR	VL			
KOD 2	KOD 3	KOD 4	Kod											Grand Total	
F	Faturimi	F1	Faturim Afrore	48	242	506	186	32	76	59	18	218	527	187	2,881
		F2	Mbifaturim	492	277	1,391	493	289	313	413	46	226	1,597	494	5,851
		F3	Faturim Dën Ekonomik	93	2,851	871	75	88	58	13	416	491	1,445	118	5,723
		F4	Faturim në Kryeqendrën Matrit	3	17	183	11	11	2	3	9	18	153	77	486
		F5	Faturim 2 kështjela	15	20	151	24	23	43	11	5	28	486	158	1,868
		F6	Faturim - aplikim tarifim	465	53	424	728	281	128	582	14	177	755	88	3,931
		F7	Faturim - cështje të tjera	494	77	543	658	289	148	491	13	233	1,867	178	4,115
		F9	Faturim - Te tjera	826	1,073	2,822	1,889	693	785	987	268	734	6,978	1,289	18,184
F Total				2,436	3,810	6,813	3,836	1,618	1,449	2,479	789	2,137	13,148	2,345	40,889
B	Kreditimi	B1	Kreditim Kanale Paguesh	464	587	913	781	287	368	162	17	243	1,488	385	5,467
		B9	Kreditim Tjera	744	1,481	1,462	2,124	1,885	564	1,484	34	373	2,374	642	12,589
B Total				1,208	1,988	2,375	2,907	1,292	934	1,646	51	636	3,862	947	18,056
K	Ndryshime Kontrate	K1	Kontrata-Pezullim, Mbyllje, shtesim	1,323	1,795	3,969	2,239	1,223	2,168	2,332	198	2,417	7,243	2,117	27,248
		K2	Kontrata - Ndryshim në llogaritje Kontrate	1,967	1,428	4,465	2,582	1,243	1,489	2,231	148	2,184	9,828	1,888	28,485
		K5	Kontrata - Ndryshim në llogaritje Kontrate Kontrata Qeraj, Spjeguarje	1	6	81	15	7	18	48	1	18	413	1	593
K Total				3,291	3,221	8,495	4,756	2,493	3,687	4,623	339	4,611	16,704	4,006	56,316
Grand Total				6,955	9,019	17,883	11,498	5,403	5,960	8,748	1,179	7,584	33,714	7,298	115,241
				96%	98%	92%	97%	96%	96%	93%	98%	96%	93%	93%	92%


Sikurse vihet re nga tabela 91, treguesit e cilësisë së shërbimitjanë brenda parametrave të përcaktuara nga “Rregullorja për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike“, miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s me Nr. 110, date 21.10.2011.

SAIDI - Koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjespër klient

SAIFI- Koeficienti i ndërprerjevepër klient.

Dinamika e vlerave të SAIDI dhe SAIFI të matur në TM, në mënyrë kronologjike janë pasqyruar në grafikun me poshtë.


Figura 89: Treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në tension të mesëm gjatë vitit 2015.



$$\text{SAIFI} = \frac{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE TE PREKUR}}{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE}}$$

$$\text{SAIDI} = \frac{\text{KOHA TOT E NDERPRERJEVE}}{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE}}$$

Figura 90: Treguesit e vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike në tension të lartë gjatë vitit 2015



$$\text{SAIFI} = \frac{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE TE PREKUR}}{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE}}$$

$$\text{SAIDI} = \frac{\text{KOHA TOT E NDERPRERJEVE}}{\text{NUMRI TOT I KLIENTEVE}}$$

3.5.1 Marrëdhëniet me Publikun, Median e Shkruar dhe Vizive

ERE te zbatim te detyrave qe burojnë nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, kryesisht te nenit 19, pika “f” dhe “gj”, i ka dhënë një rëndësi dhe prioritet të veçantë komunikimit me publikun e gjerë. Transparenca e komunikimit është garantuar nëpërmjet instrumenteve te tille si: publikime të informacioneve që kanë të bëjnë me nivelin e shërbimeve nga pjesëmarrësit në sektorin e energjisë, dhe seancave e mbledhje publike. Komunikimi i informacioni është realizuar përmes , mbajtjes sistematikisht në kontakt nga drejtues të ERE, dhe vënies në dispozicion të të dhënave të kërkuara nga gazetarët që mbulojnë sektorin energjistik, në respekt kjo të ligjit për të drejtën e informimit. Transparenca për publikun ka bere qe, ERE te përgjigjet pozitivisht dhe në kohë kërkesave të vazhdueshme të medias për sqarime rreth çështjeve të ndryshme, sidomos ndaj problematikave të kompanisë “OSHEE”sh.a, por edhe ndaj zhvillimeve të projektit TAP. Për informimin e palëve të treta ka funksionuar aksesin në rrjet dhe komunikimin nëpërmjet faqes së web-it, duke ofruar një pasqyrë më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Kjo faqe siguron aksesin dhe plotësimin online të formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit, informacion i përditësuar mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, kushtet e

licencimit, të gjitha vendimmarrjet e ERE, regjistrimin e të licencuarve, informacion të detajuar mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik.

3.5.2 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.

Komunikimi me pjesëtarët e tregut të energjisë është një ndër prioritetet dhe detyrimet kryesore të ERE-s, që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë. Në këtë këndvështrim me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, të konsumatorëve dhe investitorëve ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Konsultimeve dhe takimeve me operatorët e tregut të energjisë elektrike, përpunimi dhe dhënia në kohë e informacionit të kërkuar nga subjektet, ka qenë një formë tjetër e komunikimit mes ERE-s dhe subjekteve të interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

3.5.3 Seancat Dëgjimore

Seancat dëgjimore ka qenë një modalitet i përdorur shpesh nga ERE-s, në respekt të parimet e ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe personave privatë, parimit të paanësisë dhe bashkëpunimit për një gjykim të drejtë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes të licencuarve dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve, gjithashtu dhe në procesin e hartimit të akteve nënligjore. Mbështetur dhe në parimin e transparencës së saj ERE, bazuar në “Rregulloren e Praktikës dhe Proçedurave”, ka organizuar një sërë seancash dëgjimore. Rreth 15 seanca dëgjimore janë zhvilluar për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave, duke bërë një grupim të problematikave të hasura. Në qëllim të tyre këto seanca kanë patur ballafaqimin e shqetësimeve të gjithë aktorëve të tregut, dhe konsumatorëve të energjisë. Në këtë kuadër janë dhënë udhëzime dhe rekomandime nga ana e ERE-s, të cilat janë të detyrueshme për pjesëmarrësit e tregut, për zgjidhjen e problemeve të konstatuara me konsumatorët apo në mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve dhe aktoreve të tjerë të tregut të energjisë elektrike. Janë organizuar gjithashtu seanca dëgjimore me aktorë kryesorë të tregut të energjisë të tillë si “KESH”, “OST” dhe “OSHEE” dhe subjekte të licencuar, të cilat kanë patur për objekt konsultimet për aktet rregullatore apo trajtimin e problematikave të ndryshme, të tilla si: diskutime të KESH-it mbi devijimet e programit të importit të energjisë elektrike, diskutime lidhur me propozimet e Komisionerit për të “Drejtën e Informimit” përndryshimet për rregulloren për “lidhjet e reja” me sistemin e shpërndarjes; fleksibilitetin nga kontrata e importit të energjisë elektrike të shoqërisë “OSHEE” sh.a. Janë zhvilluar gjithashtu dhe seanca lidhur me ankesat e drejtuara OSHEE-se, mbi mosnjohjen nga ana e

KESH-it te energjisë se prodhuar nga HEC- Hurdhas dhe refuzimin e faturave përkatëse; mbi miratimin e barrësimit e licencave te prodhimit dhe tregtimit te energjisë elektrike; faturimet dhe aktrakordimeve përsasinë e energjisë elektrike te blere nga KESH për muajin Maj 2015 dhe kërkesat ankimore për zgjidhjen e mosmarrëveshjevendërmjet KESH dhe OSHEE-se, përfaturën e penaliteteve.

Rreth 4 seanca dëgjimore kanë patur si subjekte konsumatorë të energjisë elektrike, konsumatorë familjarë dhe jo familjare, të cilët janë ankuar kryesisht për çmimin e energjisë elektrike ne kundërshtim me Vendimin e Bordit Nr. 148, date 26.12.2014; faturim të parregullt; faturim për matje jashtë kushteve teknike; refuzimi për “lidhje te re” me sistemin e shpërndarjes.

Lidhur me këto seanca ERE, në zbatim të një procedurë transparente, duke evidentuar dhe analizuar problematikat e vërejtura iu ka bërë të ditur të interesuarve qëndrimin e saj duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse. Theksojmë faktin se ka patur një mungese vullneti nga kompania “OSHEE” sha, për te zbatuar rekomandimet e ERE-s, dhe konkretisht ato lidhur me zbatimin e Vendimit te Bordit te ERE-s Nr.148, date 26.12.2014 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015”.

Mos zbatimi i këtyreudhëzimeve dhe rekomandimeve te ERE, për disa subjekt ka derivuar deri ne konflikte gjyqësorendërmjet subjekteve te cenuar nga ndryshimi i çmimit dhe kompanisë “OSHEE” sha. Ne këto konflikte gjyqësore ERËështëpërfshire me cilësinë e personit te trete.

3.5.4 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit

Faqja zyrtare e Web-it të ERE-s, është zhvilluar duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Një prioritet kryesor ka qene dhe mbetet azhornimi sistematik i faqes së Internetit, duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacion primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, regjistrin e të licensuarëve, kushtet e licencimit, publikimi ne faqen e tij te internetit te tedhënavekatër mujorepër funksionimin e tregut te energjisë elektrike. Informacion të detajuar për klientët e energjisë elektrike, mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, broshure informuese për mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesimi dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit.

Edhe gjate vitit 2015, faqja e web-it të ERE-s ka vazhduar të ofrojë informacione mbi mbledhjet e Bordit, vendimet përkatëse si dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal. Ka vazhduar puna me intensitet për

përkthehen në gjuhën Angleze dhe publikimin në faqen zyrtare të ERE-s të të gjitha vendimet e Bordit si dhe çdo informacion tjetër, i cili lidhet me veprimtarinë e ERE-s.

3.6 Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s

Një rëndësi të veçantë edhe gjatë vitit 2015 ju kushtua marrëdhënieve ndërinstitucionale brenda vendit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale. Për vitin 2015 nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë është punuar shumë që ERE të përfaqësohet denjësisht në arenën ndërkombëtare dhe në forcimin e rolit të saj pranë institucioneve ku ajo aderon.

Kryesisht ERE ka ndarë informacione dhe qëndrime me Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Sipërmarrjes, Ministrinë e Integritit, Autoritetin e Konkurrencës si dhe institucione të tjera të cilat operojnë në Republikën e Shqipërisë veprimtaria e të cilëve lidhet në një masë të caktuar me çështje të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Gjatë vitit 2015 janë trajtuar një sere korrespondencash tematikat e të cilave kane konsistuar në interpretimin ligjor, hartim i kuadrit nënligjor referuar dy ligjeve të reja të cilat janë miratuar në fundmi nga Parlamenti, propozime për kuadrim rregullator nga subjektet e licensuara, kërkesë për vendimmarrje nga ERE, kërkesë për opinionin e ERE, zgjidhje mosmarrëveshesh ndërmjet të licencuarve, publikim i vendimeve në Qendrën e Botimeve Zyrtare.

3.6.1 Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë

Gjatë vitit 2015 sikurse dhe në vitet e kaluara ERE ka vazhduar të bashkëpunojë me Kuvendin në kuadër të seancave të zhvilluara nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese në kuadër të shqyrtimit të projektligjeve për sektorin e energjisë elektrike dhe të sektorit të gazit natyror. Nga ana e tij Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dy ligje shumë të rëndësishme për sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

Miratimi i këtyre ligjeve ka si qëllim krijimin e kuadrit ligjor në këto sektor, me objektiv krijimin dhe funksionimin e efektshëm dhe konkurrues të tregut të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror. Këto ligje vendosin Entin Rregullator të Energjisë

përballë përgjegjësisë për implementimin në kohe të synimeve të përcaktuara përmes tyre në kuadër të përmbushjes së angazhimeve që Shqipëria ka marrë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe harmonizimin më të plotë të legjislacionit të sektorit të energjisë elektrike me direktivat dhe rregulloret e BE-së, kryesisht ato të paketës së tretë legjislative të sektorit të energjisë.

3.6.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI)

Si në vitet paraardhëse ashtu edhe gjatë vitit 2015 ERE ka bashkëpunuar dhe bashkërenduar një pjesë të punës së saj me MEI-n për zgjidhjen e shumë problemeve dhe sfidave të ndryshme të ndeshura gjatë procesit të rregullimit të sektorit të energjisë në Shqipëri.

ERE ka kontribuar qoftë përmes propozimeve të dala prej saj apo përmes dhënies së opinionëve të ndryshme të propozuara, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Grupet ndërinstitucionale të Punës për rishikimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, Ligjit për Sektorin e Gazit (Direktiva e 3-te), të Ligjit të Energjive të Rinovueshme dhe projektet e ardhshme në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Gazit.

Disa nga çështjet e trajtuara në kuadër të bashkëpunimit me MEI-n kanë konsistuar në lidhje me:

- ✚ Përgatitje informacioni MEI-it mbi çmimin/njësipër vitin 2015,
- ✚ Mbi operimin e energjisë elektrike të HEC Lanabregas,
- ✚ Mbi problemet e përsëritura në linjën e nënstacionit 35kv të Maliqit, .
- ✚ Për krijimin e Grupit të Punës për trajtimin e problemeve për HEC-Kalivaç
- ✚ Mbi vështirësitë në përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrikelidhur me draftin e Rregullores mbi procedurat për certifikimin e OST në sektorin e gazit natyror dhe atë të energjisë elektrike.
- ✚ Mbi implementimin e Ligjit nr.138/2013 ‘Për Burimet e Rinovueshme’.
- ✚ Mbi hartimin e planit kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë elektrike
- ✚ Lidhur me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

- ✚ Lidhur me prokurimin e shërbimeve ndihmese dhe te energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve ne sistemin e transmetimit

ERE do të vazhdojë ta vlerësojë dhe do ta ketë një ndër përparësitë e saj bashkëpunimin me MEI-n. Gjithashtu ERE ka qenë anëtare e rregullt e Grupit të punës të ngritur nga ana e MEI-t për Plotësimin e Pyetësorit të BE-së mbi Kapitullin e Energjisë dhe është ftuar rregullisht si anëtare në grupet e ndryshme të punës të ngritura nga ana e MEI-t. Gjithashtu gjatë vitit 2015 është zhvilluar takimi midis prodhuesve privatë dhe Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë mbi problematiken e sektorit, perspektivën e tregut të energjisë elektrike dhe format e bashkëpunimit

3.6.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritimit

Gjate këtij viti ERE ka bashkëpunuar me Ministrinë e Integritimit në lidhje me Raportimin Vijues në kuadër të Nen komitetit Transporti, Energjia dhe Zhvillimi Rajonal dhe ka përgatitur raportimin vjetor në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit për takimin e përvitshëm ne Bruksel.

3.6.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës

Përgjatë vitit 2015 ERE ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës ne kuadër të shkëmbimit të informacionit si dhe ne kuadër të nën komitetit BE-Shqipëri ‘Tregu i Brendshëm dhe konkurrenca, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit’, mbi vendime me te drejta te veçanta te marra nga ERE. Po ashtu ne kuadër të hartimit të akteve nënligjore ne sektorin e energjisë elektrike dhe atë te gazit natyror ERE ka kërkuar ne çdo rast opinionin e Autoritetit te Konkurrencës dhe me konkretisht:

- ✚ Mbi draftin e Rregullores për Certifikimin OST për gazin.
- ✚ Mbi draftin e Rregullores mbi procedurat për certifikimin e OST te energjisë elektrike.
- ✚ Lidhur me një ndryshim ne Rregullat e Tregut te Energjisë Elektrike.
- ✚ Ne lidhje me ‘Përrjashtimin e Marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a dhe OSHEE sh.a’.
- ✚ Rregullores se SEE CAO

Gjate vitit 2015 ERE ka informuar AK ne lidhje me kërkesat e ndryshme te paraqitura nga ky i fundit ne kuadër te hetimeve te ndërmarrja nga AK te tille si hetimi mbi çmimet e aplikuara nga OSHEE klientët e lidhur ne TM .

ERE e ka bazuar marrëdhënien e saj me institucionin e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet ERE-s dhe Autoritetit të Konkurrencës që prej datës 17.01.2007.

Siç evidentuar edhe me lart ERE ka informuar Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ky institucion në lidhje me sektorin e energjisë elektrike. Nga ana e saj ERE i ka dërguar të gjitha aktet e saj nënligjore Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e një mendimi përpara miratimit të tyre, si dhe ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga ky institucion.

3.7 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Prioritet i ERE-s është investimi për një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit dhe Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Kjo është një ndër arsyet për të cilat mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në organizimin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me institucionet e tjera për organizimin e aktiviteve ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Për vitin 2015 ERE ka punuar me një intensitet të lartë për realizimin e bashkëpunimeve sa me frytdhënëse në dobi të sektorit te energjisë të vendit. Duke vendosur këto prioritete, ERE ka punuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë se Vjenës ECRB, MEDREG, ERRA, USAID, NARUC, IGU, Florence School of Regulation etj. Por në forcimin e rolit të ERE-s dhe harmonizimin e kuadrit Rregullator, janë mbajtur gjithashtu marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore si motra. Duke realizuar takime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të lidhura me energjinë.

3.7.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare

- ✚ ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, në konferencën e përvitshme të Investimeve të ERRA-s takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.
- ✚ ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike dhe që prej Nëntorit 2014 Kryetari i ERE-s Petrit Ahmeti, është zëvendës president i Rregullatorëve të Mesdheut. Gjithashtu Komisioneri Maksim Shuli është nën kryetar i grupit të punës së Gazit të MEDREG. Kjo tregon angazhimin e ERE-s në arenën ndërkombëtare dhe siguron një përfaqësim për tu shënuar te vendit.

Stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës për konsumatorin, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qenë dhe draftues i materialeve të grupeve të punës.

Perfaqes të niveleve të larta në ERE kanë marrë pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të MEDREG, takimet e komiteteve drejtues të MEDREG si dhe në takimet e presidencës të MEDREG. Gjithashtu ERE në Dhjetor të 2015 ka mirëpritur në Tiranë takim të radhës të Asamblesë së Përgjithshme të MEDREG. Kjo shoqatë e mbështetur nga Komisioni Europian është një mundësi e vlefshme në drejtim të njohjes së mundësive, harmonizimit të kuadrit rregullator dhe potencialeve energjetike të Vendeve të Mesdheut. Por në të njëjtën kohë jep mundësinë e vendosjes së një klime mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të rregullatorëve të këtyre vendeve për çështje të ndryshme të interesit ndërmjet tyre.

Për vitin 2015 ERE ka mbajtur një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët afatgjatë të përkrahur nga USAID dhe NARUC, ku janë përfshirë përfaqësuesit e rregullatorëve të rajonit dhe kompanitë e sistemit të shpërndarjes dhe të shitjes me pakicë të rajonit. Ndër projektet kryesore që ERE ka marrë pjesë është ai i hartimit të udhëzimeve të përbashkëtapërkompanitë e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për vendet e Evropës juglindore. Gjithashtu ky projekt ka sjellë rezultate pozitive në koordinimin e operatorëve të shpërndarjes të rajonit të Ballkanit.

- ✚ ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2015 ka marrë pjesë aktive në Forumet e Energjisë së Athinës, Forumin e Gazit në

Lubjanë dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës. Gjithashtu ERE ka marrë pjesë aktive duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit e Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Gjithashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jone i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës si dhe jemi ndihmuar nga Sekretariati i Vjenës ne draftimin e akteve sekondare ne kuadër te ligjeve te reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, gazit natyror, platforma e gazit si dhe forumet e organizuara nga Sekretariati i Vjenës si është forumi i ligjit apo forumi i Athinës, takimet e Bordit Rregullator te ECRB. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit e Vjenës për sa i përket implementimit te paketës se trete legislative ne kuadër te legjislacionin sekondar i cili është ne proces draftimin dhe miratimi nga Bordi, për sa i përket procesit te certifikimit si një koncept i ri ne implementimin e ligjit te ri te energjisë elektrike dhe te gazit si dhe për sa i përket krijimit te bursës se energjisë ne Shqipëri. Vlen të theksohet që ERE ka marrë pjesë edhe në workshopet e organizuara nga ana e Sekretariatit për sigurinë e furnizimit, energjitë e rinovueshme apo statistikat. Përfaqësuesit e Sekretariatit të Vjenës e kanë përkrahur në mënyrë aktive ERE-n për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë vitit 2015.

Institucioni jonë është munduar të përfitoj sa më shumë nga këto aktivitete dhe nga eksperiencia e rregullatorëve të bashkimit European, për harmonizimin e legjislacionit, praktikave dhe procedurave me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët rajonal të energjisë, transparent, konkurrues, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

3.7.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2015 kanë pasur si qëllim të forcojnë kapacitetin institucional të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të suksesshme në dobi dhe përmirësim të sektorit energjistik të vendit. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet të ndërsjellat me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për tarifrat, legjislacionin dhe çështjen e tregut të përbashkët.

Gjatë vitit 2015 janë intensifikuar në mënyrë të mëtjshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (AEEG) dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP dhe për vitin që vjen do të planifikohen aktivitete për të përfituar nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe të energjisë elektrike. Gjithashtu gjatë këtij viti ERE ka mbajtur një bashkëpunim aktiv me institucionet rregullatore të rajonit e më gjerë, ku mund të përmendim Rregullatorët e Kosovës, Maqedonisë, Malit të zi, Turqisë, Francës etj.

3.7.3 Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2015 ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçante pjesëmarrjes në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare. Interesi i Institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat evropiane dhe botërore në sektorin energjistik, gjithashtu dhe zhvillimet më të fundit dhe me gjerë në shkallë botërore duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare. Ndër aktivitetet më të rëndësishme mund të përmendim Konferencat Evropiane dhe të Evropës Juglindore për Energjitikë të rinovueshme, Asambletë të Përgjithshme të MEDREG, takimet e Presidencës së MEDREG, takimet e grupeve të punës së MEDREG dhe takimeve bilaterale në kuadër të hartimit të dokumenteve (raporte benchmark mbi sektorin e energjisë elektrike të rajonit të Mesdheut, Peer review), Forumi Botëror i Energjisë, workshopet e organizuara nga Florence School of Regulation, Konferencat e organizuara për çështjet e gazit, si dhe në workshopet e organizuara mbi rolin e rregullatorëve në çështjet e energjive të rinovueshme, efikasitetit të energjisë, mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurisë së furnizimit.

Kapitulli VI

Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

1. Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 9072 datë 02.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ne vijim ligji nr.43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike", ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “ Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akte te tjera ligjore.

Janë zbatuar të gjitha afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve te tjera nen ligjore.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit dhe licensimit, që ERE ka vendosur për të licënsuarit. Për vitin 2015 arketimet nga pagesat e rregullimit janë realizuar në masën 86.5%.

Bilanci i shpenzimeve të kryera nga ERE, si pjesë e përmbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar një punë normale të institucionit, si edhe më parë kanë konsistuar në përmbushjen e nevojave më të domosdoshme që ka pasur ERE gjatë vitit, kurse me kryesorët mund të përmendim:

Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nuk është debitor.

Pagesat për Konsulencë

Publikimet për informim të opinionit publik

Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

Tarifat e primit te sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, si dhe taksat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Gjithashtu janë kryer procedurat e prokurimeve në kuadër të blerjeve të vogla (si pjesë e Komisionit të blerjeve Vogla) në zbatim të legjislacionit të prokurimeve elektronike për fondet publike.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2015 është audituar nga një ekspert kontabël i regjistruar dhe i licencuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në vijim të këtij paragrafi paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël.

2. Raporti i Auditimit nga Eksperti Kontabël për Vitin 2015

Ludmilla Paluka
Ekspert Kontabel i Regjistruar
Licenca Nr 161, date 25.01.2007
Cel.0692036339

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Kryetarit te Entit Regullator te Energjise,

Z. Petrit AHMETI

Bazuar ne Legjislacionin perkates, me keni caktuar per te audituar pasqyrat financiare bashkalidhur te **Entit Regullator te Energjise** per vitin ushtrimor mbyllur me 31.12.2015.

Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe te Raportimit Financiar.

ERE eshte nje Ent Publik jo buxhetor dhe jofitimprures.

Ne perputhje me Dispozitat Ligjore qe regullojne funksionimin e ERE-s, kontabiliteti i saj pasqyron administrimin e fondeve te realizuara nga operatoret e sektorit energjistik mbi bazen e tarifave te percaktuara me ligj. Perdorimi i ketyre fondeve realizohet nepermjet hartimit, ndjekjes dhe realizimit te buxhetit te miratuar me Vendim te Bordit i Komisionereve te ERE-s.

Pergjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia e Audituesit eshte te shprehi nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne misionin e auditimit. Une kam kryer auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto Standarte kerkojne qe te respektohen kerkesat etike dhe te planifikohet dhe kryehet auditimi per te arritur sigurine e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale .

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidencen e nevojshme te auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshire ketu vleresimin e rreziqeve te anomalise materiale ne pasqyrat financiare, te cilat mund te vijne si pasoje e mashtrimit apo gabimit.

Ludmilla Paluka
Ekspert Kontabel i Regjistruar
Licenca Nr 161, date 25.01.2007
Cel.0692036339

Ne vlersimin e ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem te entitetit qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellim qe te percaktoje procedura auditimi qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellime te shprehjes se nje opinioni mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Nje auditim perfshin gjithashtu, vlersimin e pershtatmerise se politikave kontabel te perdorura, te arsyeshmerise se cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si edhe vlersimin per paraqitjen e pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te sherbyer si baze per opinionin tone te auditimit.

Opinionit i audituesit

Sipas opinionit tim, pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te drejte ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te **Entit Regullator te Energjise** ne date 31.12.2015, ne pajtim me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Ludmilla Paluka



Tirane me 30 Mars 2016

Emertimi dhe Forma ligjore	Ent Publik
NIPT -i	K 51717024 I
Adresa e Selise	Bul "Bajram Curri" Rr "Viktor Efimiu" Godina KESH Tirane
Data e krijimit	_____
Nr. i Regjistrit Tregetar	_____
Veprimtaria Kryesore	_____ _____ _____

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 te Permirosuar dhe Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2015

Pasqyra Financiare jane individuale	_____	po
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara	_____	po
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne	_____	Lek
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne	_____	po (te plote)
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga	01.01.2015
	Deri	31.12.2015
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	_____	31.03.2016

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	A K T I V E T	Shenimet	2015	2014
	Aktivitet Afatshkurtra			
	▶ Aktivitet monetare	1	67,459,093	78,244,586
	1 Banka		67,459,093	78,244,586
	2 Arka		0	0
	▶ Investime	2	0	0
	1 Në tituj pronësie të njëjësive ekonomike brenda grupit	2.1		
	2 Aksionet e veta	2.2		
	3 Të tjera Financiare	2.3		
	▶ Të drejta të arkëtueshme	3	15,717,915	4,600,828
	1 Kërkesa të arkëtueshme (punonjes)	3.1	102,615	163,828
	2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	3.2		
	3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	3.3		
	4 Të tjera pagesa rregullimi	3.4	15,615,300	4,437,000
	5 Kapitali nënshkruar i papaguar	3.5		
	▶ Inventarët	4	4,410,424	3,289,320
	1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	4.1		
	2 Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	4.2		
	3 Produkte të gatshme	4.3		
	4 Mallra	4.4	4,410,424	3,289,320
	5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	4.5		
	6 AAGJM të mbajtura për shitje	4.6		
	7 Parapagime për inventar	4.7		
	▶ Shpenzime të shtyra	5		
	▶ Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	6		
I	TOTALI AKTIVEVE AFATSHKURTRA		87,587,432	86,134,734
	Aktivitet Afatgjata			
	▶ Aktive financiare	7	0	0
	1 Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit	7.1		
	2 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit	7.2		
	3 Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.3		
	4 Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	7.4		
	5 Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata	7.5		
	6 Tituj të tjerë të huadhënies	7.6		
	▶ Aktivitet materiale	8	4,777,452	14,484,779
	1 Toka dhe ndërtesa	8.1	0	7,470,010
	2 Impiante dhe makineri	8.2	2,360,268	2,950,335
	3 Të tjera Instalime dhe pajisje	8.3	2,417,184	4,064,434
	4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces	8.4		
	▶ Aktivitet biologjike	9		
	▶ Aktive jo materiale:	10	0	0
	1 Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngja	10.1		
	2 Emri i Mirë	10.2		
	3 Parapagime për AAJM	10.3		
	▶ Aktive tatimore të shtyra	11		
	▶ Kapitali i nënshkruar i papaguar	12		
II	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		4,777,452	14,484,779
	AKTIVE TOTALE		92,364,885	100,619,513

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Balanci)

Nr	DETYRIMET DHE KAPITALI	Shenimet	2015	2014
▶	Detyrime afatshkurtra:	13	3,901,692	3,382,589
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	13.1		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	13.2		
3	<i>Arkëtime në avancë për porosi</i>	13.3		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	13.4	0	574,732
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>	13.5		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>	13.6		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	13.7		
8	<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>	13.8	3,841,497	1,059,298
9	<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>	13.9	0	1,686,384
10	<i>Të tjera të pagueshme</i>	13.10	60,195	62,175
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	14		
▶	Të ardhura të shtyra	15		
▶	Provizione	16		
	Totali i Detyrimeve afatshkurtera		3,901,692	3,382,589
▶	Detyrime afatgjata:	17	0	0
1	<i>Titujt e huamarrjes</i>	17.1		
2	<i>Detyrime ndaj institucioneve të kredisë</i>	17.2		
3	<i>Arkëtimet në avancë për porosi</i>	17.3		
4	<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>	17.4		
5	<i>Dëftesa të pagueshme</i>	17.5		
6	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike brenda grupit</i>	17.6		
7	<i>Të pagueshme ndaj njësisve ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse</i>	17.7		
8	<i>Të tjera të pagueshme</i>	17.8		
▶	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	18		
▶	Të ardhura të shtyra	19		4,437,000
▶	Provizione:	20	0	0
1	<i>Provizione për pensionet</i>	20.1		
2	<i>Provizione të tjera</i>	20.2		
▶	Detyrime tatimore të shtyra	21		
	Totali i Detyrimeve afatgjata		0	4,437,000
	DETYRIMET TOTALE		3,901,692	7,819,589
▶	Kapitali dhe Rezervat	22	88,463,193	92,799,924
▶	Kapitali i Nënshkruar	23		
▶	Primi i lidhur me kapitalin	24		
▶	Rezerva rivlerësimi	25		
▶	Rezerva të tjera	26	0	0
1	<i>Rezerva ligjore</i>	26.1		
2	<i>Rezerva statutore</i>	26.2		
3	<i>Rezerva të tjera</i>	26.3		
▶	Fitimi i pashpërndarë	27		
▶	Fitim / Humbja e Vitit	28		
	Totali i Kapitalit		88,463,193	92,799,924
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		92,364,885	100,619,513

Pasqyra e Performancës
(Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)

Formati 1 – Shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Shenimet	2015	2014
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	29	94,209,650	122,180,540
▶	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	30	1,229,112	1,410,588
▶	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	31		
▶	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	32		
▶	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33	0	0
	1 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	33.1		
	2 Të tjera shpenzime	33.2		
▶	Shpenzime të personelit	34	-64,944,563	-49,499,709
	1 Paga dhe shpërblime	34.1	-58,280,469	-44,251,135
	2 Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	34.2	-6,664,093	-5,248,574
▶	Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale	35	0	0
▶	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	36	-1,919,055	-2,806,464
▶	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	37	-30,300,971	-28,648,876
▶	Të ardhura të tjera	38	51,187	48,752
	1 Të ardhura nga interesi	38.1	39,062	18,406
	2 Të ardhura nga kursi kembimit	38.2	7,425	4,646
	3 Të ardhura tjera	38.3	4,700	25,700
▶	Zhvierësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra	39		
▶	Shpenzime financiare	40	0	0
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)	40.1		
	2 Shpenzime të tjera financiare	40.2		
▶	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet	41		
▶	Fitimi/Humbja para tatimit	42	-1,674,639	42,684,831
▶	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	43	0	0
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	43.1		
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë	43.2		
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve	43.3		
▶	Fitimi/Humbja e vitit	44	-1,674,639	42,684,831
▶	Fitimi/Humbja për:	45		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	45.1		
	Interesat jo-kontrolluese	45.2		

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

Nr	Pershkrimi i Elementeve	2015	2014	
▶	Fitimi/Humbja e vitit	46	-1,674,639	42,684,831
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	46.1		
	Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja	46.2		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	46.3		
	Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje	46.4		
	Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	46.5		
▶	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	47	0	0
▶	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	48	-1,674,639	42,684,831
▶	Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:	49		
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë	49.1		
	Interesat jo-kontrolluese	49.2		

